



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### J u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **24 nëntor 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 tetor 2022;
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për miratimin e Raportit të Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit të performancës dhe grantit të bazuar në performancë për vitin 2021;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me aktivitetet për implementim të reformës në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i kërkesës së Klubit të Hendbollit “Vushtria” (femrat) për përkrahje financiare;
9. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>Kuvendin e komunës</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Melihate Basholli Latifi</b> <i>Melihate Basholli Latifi</i>
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	<b>Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Sekretarisë së kuvendit</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 11.11.2022</b>

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **11 nëntor 2022** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të bëhet një informatë më e detajuar dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për Raportin e Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të ndryshohet ky propozim – vendim dhe të hartohet një propozim – vendim tjetër që parasheh kompensimin e komisioneve të themeluara nga kuvendi i komunës dhe të prodhojë efekt juridik nga data 01.01.2022 deri në hartimin e Rregullores për*

*komitetet e kuvendit dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i kërkesës së Klubit të Hendbollit “Vushtrria” – femrat për përkrahje financiare.

*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*

*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E –VIII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 TETOR 2022**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Faton Hyseni, Fatmire Cecelia, Gentiana Rama, Gresa Muli, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mentor Hasani, Mensur Kasumi, Nurie Halili, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehulli, Spasoje Stefanoviq, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Munguan:** Galip Avdiu, Mensur Kastrati dhe Refik Maloku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallën e kuvendit, ka kuorum të mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit:** propozoi deri në seancën e muajit të ardhshëm, të analizoni aspektin legjislativë dhe të përgatitni propozimet për themelimin e komiteteve të tjera të kuvendit me përbërje nga anëtarët e kuvendit, ashtu siç e parasheh ligji dhe siç e kanë praktike komunat e tjera, bazuar në ligj si një praktik e mirë dhe si një mundësi që secili kuvendar të jep kontributin e tij profesional dhe të ndihen pjesë e rëndësishme e përfaqësimit qytetar, lexoi pjesën përkatëse të legjislacionit në fuqi, që buron nga ligji për vetëqeverisje lokale. Duke shtuar që përveç KPF-së dhe Komitetit për komunitete, kuvendi mund të themelojë edhe komitete të tjera sipas nevojës, e që mund të jenë komitetit për shërbime publike, për arsim për shëndetësi e të ngjashme.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** – tha, se deri në seancën e ardhshme do të konsultohemi me shefat e grupeve kuvendare për themelimin e këtyre komiteteve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha, se përkrahi parafolësin por sqaroi se disa komitete janë të formuara, kurse dy prej tyre paguhen kurse të tjerat jo dhe duhet të shikohet rregullorja e pagesave, propozoi që për seancën e radhës të përgatitet rregullorja për pagesën e komiteteve.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**- tha, se sipas ligjit komitetet në fjalë paguhen sikurse komitetet e përhershme dhe vetëm duhet të shikohet mundësia buxhetore. Por sipas tij Komuna e Vushtrrisë i ka mundësit për pagesën e këtyre komiteteve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha ,se sipas ligjit ne fuqi paguhen vetëm dy komitetet e përhershme ,ndërsa te tjerat jo dhe na mbetet ta aprovojmë rregulloren për pagesën e këtyre komiteteve.

**Leonora Gerguri, anëtare e kuvendit** – kërkoi nga qeveria komunale, të merret me trajtimin e geneve endacak, pasi paraqesin shqetësim veçanërisht për fëmijët që shkojnë në shkollë.

**Edona Gashi, anëtare e kuvendit** –kërkoj që pika e pestë e rendit të ditës të hiqet nga shqyrtimi pasi që nuk është përënditur si duhet.

**Shpëtim Zhegrova ,nënkryetar i komunës** –tha se pajtohet me dy parafolësit Sylejmanin dhe Ilmiun për formimin e këtyre komiteteve konsultative pasi ato ekzistojnë edhe në komuna te tjera. Tutje ai propozoi të futet ne rend te ditës formimi i komisionit për përgatitjen e rregullores deri ne fund te vitit ,për te startuar në vitin e ardhshëm. Ai kërkoi qe pika e 7 e rendit te ditës “Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit të performancës dhe grantit të bazuar në performancë për vitin 2021”, te largohet nga rendi i ditës ,pasi referuesi i kësaj pike të rendit të ditës ,Islam Latifi ndodhet jashtë vendit për punë zyrtare të komunës.

**Edona Gashi , anëtare e kuvendit** – shprehi shqetësimin lidhur me informatën për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022,ku kjo informatë i referohet, gjashtëmujorit të pare janar-qershor te vitit 2022 kurse brenda tekstit diskutohet për punën e ish kryetarit Xhafer Tahri për 2021. Ajo propozoi të korrigjohet kjo pjesë ,duke dyshuar që këto mbledhje nuk janë mbajtur fare dhe kërkoi te largohet nga rendi i ditës dhe të sjellët në seancës e ardhshme.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – tha, më datë 28 korrik te vitit 2022 ,kuvendi ka themeluar komisionin për përzgjedhjen e këshillave lokale me përbërje të: Blerina Shala, Bekim Zabërgja, Agron Perçuku, Ymer Haradinaj(anëtarë te kuvendit),Qemajl Hasani (anëtar i ekzekutivit) Isak Hyseni (shoqëria civile) dhe një anëtar nga fshati apo lagjja. Tutje tha se ne bazë te rregullores për formimin e këtyre këshillave është dashur të formohet edhe komisioni për ankesa. i cili do të shqyrtonte ankesat lidhur me zgjedhjet e këshillave lokale. Prandaj propozoi që të bëhet plotësim-ndryshimi i atij vendimi që të themelohet komisioni i ankesave.

**Shpëtim Zhegrova ,nënkryetar i komunës-** tha ,se rregulloren e cila do të përgatitet për pagesën e komiteteve se do te futet edhe pagesa e komisioneve komunale.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-** lidhur me formonin e komisionin e ankesave se duhet të formohet vendim i veçantë e jo ndryshim i vendimit për formonin e këshillave lokale.

**Behar Duraku, anëtar i kuvendit** –tha ,se neve si anëtarë te kuvendit na ka ardhur një email nga klubi i futsallit F.C. Vushtrria për financim te klubit. Ai kërkoi të futet ne rend të ditës kjo kërkesë.

**Shpëtim Zhegrova ,nënkryetar i komunës-**në bazë të ligjit në fuqi kryetari i komunës ka marr vendim për përkrahje e klubit në fjalë.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-** pasi ishin dy propozime për largimin e dy pikave te rendit te ditës nga rendi i ditës ,ajo kërkoi të hedhet ne votim për largimin ose jo te këtyre pikave te rendit te ditës.

**Me vota unanime pika e 7 e rendit te ditës u largu nga rendi i ditës (Raportit i menaxhimit të performancës dhe grantit të bazuar në performancë për vitin 2021).**

**Me 7 vota “për”, 17 vota “kundër” nuk u largua pika e 5 nga rendi i ditës.**

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 1 votë “kundër” dhe 1 votë “abstenim” aprovoi këtë:**

## **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 shtator 2022;
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022/2023;
4. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022;
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga taksa komunale për projektet investive të KEDS-it gjatë vitit 2022;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e rregullores për komitetet dhe komisionet e kuvendit;
11. Të ndryshme.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 shtator 2022;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendi-** lidhur me procesverbalin tha se një diskutim i tij nuk është përfshirë, kërkoj që diskutimi i tij të përfshihet në procesverbal. Kërkoj që ai diskutim të inkorporohet në procesverbal.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-** kërkoj që të plotësohet dhe korrigjohet tabela e planifikimit buxhetor, me emër të disa projekteve. Rr. Ramadan Imer që gjendet në fshatin Liqej dhe jo në fshatarin Akrashticë ,Rr.Jahir Bajrami.

**Kuvendi me 28 vota “për” miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar e kuvendit e datës 29 shtator 2022.**

**2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;**

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-** shprehu shqetësimin për vijën buxhetore tek investimet kapitale ,duke shtuar se vetëm 14% e gjithë buxhetit është shfrytëzuar dhe pjesa tjetër do të shkoj suficit. Shprehur më konkretisht kjo i bie se nga 5, 960.547 € të planifikuar për investime kapitale për vitin 2022 vetëm 831,372.073 € janë shpenzuar apo realizuar. Pjesa tjetër e totalit të buxhetit për investime kapitale që gjendet në procedurat administrative të prokurimit rrezikon të shkoj në

suficit dhe kjo është e tmerrshme dhe e bie komunën para një dështimi totale si asnjëherë më parë sidomos në kushtet e një krize aq të madhe ekonomike. Ai përmendi se instituti GAP janë emrat e komunave që kanë realizuar buxhetin 19% kurse ne si komunë edhe pas nënte muajve akoma e kemi 14%, dhe çka do të ndodh në muajt në vazhdim, ku do të mbetet fati i 5 milionë eurove. Në rrethana të tilla më e pakt që është dashur të ndodh do të duhej të kishte dorëheqje të përgjegjësve, apo shkarkim të ndonjë zyrtari në mungesë të performancës. Në fund kërkoi nga ekzekutivi që të jete me vigjilent në shpenzimin e buxhetit, sepse nuk ka komunë në Kosovë me buxhet kaq të vogël të realizuar.

**Leonora Gerguri, anëtare e kuvendit** –tha se tek shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, kur bëjmë një krahasim me vitin e kaluar del se 15000 euro janë më shumë këtë vite ,andaj pyeti kryetarin se çfarë benefite ka komuna nga këto udhëtime si dhe kërkoi raport për këto shpenzime, njëherazi tha se edhe shpenzimet e karburanteve janë rritur dhe diferenca del për 17000 euro, pavarësisht se çmimet e karburanteve janë ngritur ,por siç e dimë kryetari banon në qytet dhe nuk ka aq shpenzime të mëdha karburantesh ,por mos vallë këto shpenzime janë si rezultat se shume anëtar te qeverise komunale po i marrin veturat zyrtare ne shtëpi, kur dihet se ligji e precizon se vetëm kryetari mund të ketë veturën 24h në shërbime. Tek kodi 13620 furnizim me ushqim dhe pije figuron shuma prej 83000 euro ndërsa vitin e kaluar 12000 prandaj kërkoi të dijë se për çfarë shpenzime bëhet fjalë ,kurse kodi pasues për shërbime mjekësore janë 41000 euro me pak se vitin e kaluar ,po dëmtohen qytetarët pasi që edhe gjerat elementare po mungojnë ne QMF-të, mos valle po favorizohen institucionet private.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**- duke ju referuar parafolësës për shfrytëzimin e veturave nga ana e qeverise komunale tha se ,përveç kryetarit nuk e di që dikush tjetër e shfrytëzon veturën 24h , nuk di që dikush nga qeveria komunale e ka këtë benificion duke shtuar që kishe qenë mire që edhe drejtorëve t’iu mundësohet një benfit i tillë për kryerjen e detyrave nga drejtoritë. Mandej duke iu referuar parafolësit Sylejman Mehollit ,jemi ne dije se nuk jemi mire me buxhet por faji bije mbi të gjithë neve pa dallim ,sepse vitin e kaluar për inate politike nuk është votuar buxheti. Kurse sa i përket performances së dobët të realizimit të buxhetit, tha se buxheti është aprovuar me vonesë dhe dihet mire se 5 komuna kanë mbetur në mëshirën e qeverise duke përfshirë edhe komunën tonë, e cila nuk ka treguar nivelin e menduar. Pastaj tha se qeveria qendrore është e interesuar në bllokimin e proceseve jo për t’i ndihmuar në zhvillimin e komunave. Mandej tha se mandatin e kaluar ka pasur pagesa të faturave pa u përfunduar punët në projektet të ndryshëm, kjo me qëllim të ngritjes së realizimit të buxhetit, por në këtë rast ftoj qeverinë aktuale që mos të veprojnë asisoj sepse bënë shkelje ligjore. Në fund ceku se komuna gjegjësisht Drejtoria e Prokurimit është në vllugun e aktiviteteve për ta rritur nivelin e realizimit të buxhetit në investime kapitale, por megjithëkëtë është dëshpërues fakti se Qeveria e Kosovës nuk ka treguar gatishmëri për të ndihmuar komunat por më tepër ka pasur qaje bllokuese.

**Sylejman Mehollit, anëtar i kuvendit** - tha se i gjithë faji nuk është vetëm tek miratimi i buxhetit faji është edhe tek mënyra e realizimit. Ai ne rastin konkret ceku blerjen e një rëntgeni stomatologjik siç tha kërkesa është bere ne muajin maj sepse ende nuk është iniciuar nga prokurimi dhe ende jemi pa atë rëntgen. Në fund ai i kërkoi qeverisë komunale që mos ta humb këtë grant qeveritar pasi që me patjetër i duhet qytetit të Vushtrrisë.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**- duke iu referuar parafolësit Sylejman Melohllit, tha se të gjithë asamblistët e dinë sa i përket buxhetit se si ka rrjedhur dhe i dimë arsyet. Mehollit, i uroi të gjitha

të mirat për këto vërejtje theksoi që duhet të nisemi nga parimi duke u nisur nga vetja së pari, sepse me ardhjen e kësaj, qeveria është dëmtuar afro 45 euro nga parafolësi. Bashkëshortja e tij znj. Qendresa Imeri punon në shkollën SH.M.U - 1, e cila siç theksoi ai ka qenë në listën e pagave në shkollën e mesme profesionale, dhe dallimi mes shkollës së mesme të ulët dhe shkollës së mesme të lartë është 45 euro, në këtë rrjedhë nëse e kalkulojmë këtë të hyrë për një vit del se familja Mehollit e ka dëmtuar buxhetin e komunës për rreth 450 €, ndërsa për dy vite afër 1000 €. Lidhur me këtë parashitje pyetje për parafolësin Mehollit? Si është e mundur në të njëjtën kohë të punoni në dy vende, në të njëjtin orar, në institutin për Covid në Mitrovicë dhe në shkollën private "Vicianë", me këtë pyetje se a është shkelje e ligjit në të njëjtin orar t'i shfrytëzoni dy vende pune.

**Sylejman Mehollit, anëtar i kuvendit**- duke i referuar parafolësit, vlerësoi se të dilet në foltoren e kuvendit kur diskutohet për realizime buxhetore dhe të flitet për pagat e individëve me emër, kjo fletë shumë për kualitetin e asamblistëve, kur ende nuk është kuptuar përmbledhja e shpenzimeve buxhetore të komunës. Tutje ai i drejtua drejtoreshës se arsimit se i është përmendur bashkëshortja shumë herë në lidhje me vendin e punës, kurse shtoi se çdo dispozitë ligjore e keni në kompetencë ta zbatoni karshi ligjit. Ai nuk përzihet në çështjen e bashkëshortes së saj sepse ajo është e pavarur, ai nuk merret me pazare sikurse dikush që bënë pazare me anëtarë të familjes. Mandej tha se nuk bënë pazare për asgjë sikurse të tjetër dhe se nuk lëshohet në debate të tilla, pasi është kulturë profesionale për çka diskutoj. Ai theksoi se ligji e mundëson punën primare dhe sekondare dhe mund t'ua sjellë nenet përkatëse. Shkollat profesionale të mjekësisë duhet të kenë mjekë, sepse nxënësit nuk mund të mësojnë lëndë të mjekësisë pa mjekë, dhe asnjë mjek nuk e lë punën e mjekut për punën në arsim.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** – theksoi, se nuk e ka cekur shkollën private "Vicianë", në të njëjtën kohë nuk mund të punohet në dy shkolla. Ligji të jep të drejtën të punosh në honorar me 1/3. Ai theksoi se gjatë mandatit parafolësi ka punësuar bashkëshorten, ka marre serën, ndërsa për tri vite sa ka qenë në mandat, ka shfrytëzuar buxhetin e shtetit në mënyrë jo të ligjshme dhe jo të hijshme dhe pyeti z.Mehollin se po ta kishin më gjatë pushtetin çfarë?

**Sylejman Mehollit, anëtar i kuvendit**- tha, këto janë disa tendenca të ulëta që i kanë celulën nga fshati prej nga vini, por janë të dobëta dhe shtoj se raporton çdo vit në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe për çdo angazhim ka mbulesën ligjore dhe i paguan tatim shtetit.

**Andan Lahu, anëtar i kuvendit** – tha se sa u përket diskutimeve të dy parafolësve për gjuhë jo parlamentare, kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që si gardiane për mbarëvajtjen e mbledhjes së kuvendit të zbatoj rregulloren e punës të kuvendit. Më tej u shpreh për raportin buxhetor dhe iu referuara parafolësit nga radhët e PDK-së, aq bukur dhe aq me emocion diskutoi krejt ndryshe nga qëndrimet e PDK-së para një viti. Kur dëgjohen qëndrimet e PDK-së para një viti lidhur me buxhetin dhe raportet buxhetore janë sikur nata me ditë me atë çka dëgjuam sot nga parafolësi Azemi. Buxheti vitin e kaluar nuk është votuar për arsye puro politike, buxheti i kësaj qeverie në fillim të vitit është 90% i ngjashëm me buxhetin e vitit të kaluar. LDK ka votuar në mënyrë unanime buxhetin dhe nuk i gëzohet mosrealizimit të buxhetit dhe dështimit të komunës, pavarësisht se kush udhëheq.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës**- theksoi që sa i përket votimit të buxhetit PDK ka bërë gabim që nuk ka votuar buxhetin vitin e kaluar. Anëtarët e kuvendit kanë dhënë propozime për buxhetin edhe gjatë qeverisjes së LDK-së. Për realizimin e buxhetit tek investimet kapitale as anëtarët e qeverisë nuk janë të kënaqur me realizimin e buxhetit, duke shtuar se ka qenë i vështirë



realizimi i buxhetit për shkak se shumë kompani janë në gjendje të rëndë, kurse sa i përket investimeve kapitale në nivel vendi është në të njëjtin nivel po thuajse ne te gjitha komunat. Tek realizimi i buxhetit ne komunën tonë, mund të jetë 54% në përgjithësi, mirëpo tek investimet kapitale ka ngecje ne shumicën e komunave sikurse ne komunën tonë. Ka pasur ndërprerje të kontratave për shkak të ngritjes së çmimeve dhe në këtë rast komuna nuk ka dashur të dëmtohen kompanitë dhe kontratat janë ndërprerë në mënyrë te dyanshme. Alokimi i mjeteve ka filluar në muajin maj dhe secila procedurë e prokurimit merr kohë dy muaj. Për realizimin e buxhetit sa i përket investimeve kapitale tha se do të jetë më mirë se vitin e kaluar, kurse për shpenzimet e derivateve tha se nafta është 70 deri ne 80 centë me shtrenjtë sesa vitin e kaluar. Kështu që përveç kryetarit të komunës askush nuk e përdor veturën zyrtare 24h. Asnjë nga drejtorët nuk e përdor veturën 24h. Sa i përket shpenzimeve për zyrtarët është me rëndësi të punohet dhe është shumë me rëndësi që korrupsioni është ndërprerë në komunën tonë.

**Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit**-tha, sa i përket mos aprovimit të buxhetit ka qene gabim pa marr parasysh arsyeve te subjekteve politike. Këtë vit buxheti është votuar ne mënyrë unanime për shkak së qeverisja komunale ka përfshire te gjitha projektet pa dallime partiake, për interesin e përgjithshëm qytetar. Ndërsa për mos zbatim te buxhetit theksoi se nuk është e vetmja qe buxheti është votuar vone ,por arsyeja kryesor është mos funksionimi i organit shqyrtues të prokurimit ne nivel qendror për 1 vit e një muaj, një ditë është shume mosfunksionimi i këtij organi. Andaj bëri thirrje për drejtorinë e prokurimit që të angazhohet maksimalisht në mënyrë që mjetet mos të kthehen suficit.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**- tha, se LDK nuk ka pasur asnjë marrëveshje por e ka votuar buxhetin për qytetarët e jo për qeverinë (pushtetin). Andaj vërtetohet që 11 kërkesat për projekte të LDK-se për buxhetin nuk janë marr parasysh

**Albanez Tahiraj, Drejtor i Prokurimit** – tha se sa i përket rëntgenit të dhëmbëve nuk është e vërtet që nuk është iniciuar procedura e prokurimit. Pritet të shpallet fituesi dhe nënshkrimi i kontratës.

**Edona Gashi, anëtare e kuvendit**- tha ,se në raportin nëntë mujorit ka hasur e një sërë parregullsish ndaj shpresoj qe janë gabime teknike. Më tutje shtoi se tek tabela shpenzimet, mallrat dhe subvencionet mungon tabela e subvencioneve, ndërsa tek tabela e kategorive ekonomike figuron shuma 585,717.67 euro për subvencione kërkoi te bashkëngjitet. Tek tabela e investimeve kapitale qe është e detajuar për secilën drejtori mungojnë projektet e planifikuara dhe të realizuara e drejtorisë për planifikim urban dhe mjedis dhe disa nga projektet e drejtorisë se shëndetësisë. Tek tabela qe është përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit tha se nuk pajtohet me komentin qe është dhënë sipas saj përveç qe është jo mire i kuptueshëm ka mundësi te jete nga viti i kaluar del se 259.000 euro janë realizuar me tepër se qe janë planifikuar ,ndërsa del se janë realizuar 11000 euro më pak se vitin e kaluar.

**Sylejman Mehulli ,anëtar i kuvendit**- theksoi se lidhur me çështjen e rëntgenit të dhëmbit ndihet i gëzuar që drejtorja e prokurimit është në fazën finale.

**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit** – tha, se ne tabelën e pare vërehet se nuk ka pëlqime sanitare për këtë vit. Ndërsa shtoi se tek planifikimi buxhetor ,tek gjobat inspektionet këtë vit janë planifikuar 750 euro ndërsa vitin e kaluar ka qene 8000 euro te realizuara. Me tutje tha se është një planifikim jo i mire i buxhetit ne mënyrë qe te dal realizimi me i madhe. Shprehu shqetësim për realizmin e buxhetit në tri drejtoritë Pylltari 13%,planifikim urban 18% ,kulture rini dhe sport 34%. Me tutje

theksoi se ka shifra dalluese ne raport me vitin e kaluar tek shpenzimet mallrat dhe subvencionet, furnizimi me pije, dreka jo zyrtare 83242 euro kur i shtohen edhe 23000 euro dreka zyrtare del afro 106.000 euro. Kërkoj sqarim në lidhje me këto shpenzime.

**Bujar Pllana drejtor i Drejtorisë së Inspektiveve-** informoj anëtarët e kuvendit se nga shtatori i vitit 2021 inspektori për pëlqime sanitare ka kaluar në Agjencionit e Ushqimit dhe Veterinës dhe me nuk janë në kuadër të komunës pëlqimet sanitare. Tutje shtoi se kjo është arsyeja që nuk janë planifikuar ne buxhet pëlqimet sanitare .

**Isuf Jashari drejtor i financave** – dha sqarime në lidhur me të hyrat dhe shpenzimet lidhur me raportin nëntë mujor. Tutje tha se gjendja e realizimit të buxhetit është shqetësuese, por kjo gjendje do të ndryshoj për të mirë.

**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-** pyeti, pse është gjithë këto shpenzime për pije dhe dreka zyrtare. Si dhe përmendi një projekt në drejtorinë e bujqësisë që ka të bëjë me serrën, pyeti se çfarë ngritje e serës mund të bëhet me 2 euro.

**Remzi Ahmeti, drejtor për gjeodezi dhe kadastër-** duke iu referuar pyetjes se Nasuf Aliut , tha se vitin e kaluar ishte kohë pandemie dhe nuk ishin në funksion çerdhet kurse tani ne këto shpenzime hyjnë edhe ushqimi i çerdheve.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-** tha, se arsyeja kryesore për mosrealizim të buxhetit është ndërrimi i shpeshtë i drejtorëve. Kurse e kritikoi kryetarin për prurjet e reja si staf mbështetës në komunë.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit: me 12 vota “për”, 15 vota “kundër” dhe 2 abstenime nuk e aprovoj raportin nëntë mujor për të hyrat dhe shpenzimet.**

**3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022/2023;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendi-**i rekomandoj DKA-së gjegjësisht kryetarit të komunës që rishikoj mundësinë që shkollat të pajisen me aparatet fotokopjuese. Më tej propozoi që mësimdhënësve tu paguhet kujdestaria e klasës dhe kujdestaria e ditës, pastaj të bëhet ndërrimi i tabelave të zeza shënuese aty ku janë të dëmtuara. Të fillohet me trajnimin e stafit arsimorë për të filluar me furnizim me tabela digjitale. Të shikohet mundësia që nxënësit të furnizohen me kiflet prej nivelit para fillor deri në klasën e nëntë. Pastaj propozoi që mësimdhënësit të paguhen për orët shtesë që mbajnë jashtë kontratës që kanë dhe të rishikohet se në cilat lëndë ka mbi normë. Mandej propozoi që mësimdhënësit të pajisen me uniforma ashtu që uniformat ti siguroj komuna përmes procedurave të tenderimit, mandej shkollat të pajisen me laboratorë dhe kabinete të krijohen kushte të konkretizimit. Të rishikohet mundësia e ndërtimit të fushave sportive për ato shkolla që posedojnë këto shkolla. Drejtorisë Komunale të Arsimit të ofrohen kushte të punë duke iu ofruar në dispozicion së paku dy automjete në shërbim të zyrtarëve. Të bëhet rrënim i shkollave të vjetra ose të ndërmerren masa për renovimin e tyre aty ku ekziston mundësia.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se nga informatat që i ka marrë nga stafi managjues në Sh.M.P. “Bahri Haxha” në listat e pagave për muajin shtator ekzistoj tre mësimdhënës në listë e

që nuk punojnë në shkollën profesionale “Bahri Haxha” fjala është për Astrit Jasharin, Qëndresa Imeri dhe Zylfije Ymeri-Krasniqi, këta mësimdhënës kanë mbetur në listë nga qeverisja e kaluar që e kishte kritikuar për mos punë, kërkoj që për këta mësimdhënës që kanë marr më tepër mjete financiare të zbatohet ligji që ti kthejnë ato mjete. Për më keq është një mësimdhënës që punon në shkollën profesionale “Bahri Haxha” ndërsa pagën e merr në listën e pagë në shkollën e mesëm të ulët në fshatin Pasomë, fjala është për Avdush Zymberin. Nga takimet që ka pasur në teren ka marrë informacione se në disa shkolla ka mungesë të letrës siç është rasti me shkollën në fshatin Samadrexhë. Më tej pyeti se sa është numri i shkollave që kanë mungesë të gjeneratorëve dhe me lëndë djegëse, sepse viteve të kaluara kemi pasur shumë probleme me furnizim me lëndë djegës dhe me nxemje në objektet shkollore. Më tej kërkoi që të bëhet pagesa për mësimdhënësit që mbajnë orë jashtë normës së paraparë të tyre. Të organizohen më tepër trajnime për stafin arsimor si dhe bëhen përpjekje për mbulimin e shpenzimeve për nxënësit e shkollave të mesme. Pastaj tek faja 7 e kësaj informate thuhet se nga shtatori i vitit 2021 e deri në muajin gusht 2022 janë pranuar gjithsejtë 46 punëtor dhe janë larguar 41 punëtor, këtu sigurisht ka ndonjë gabim teknik por nëse kjo është e vërtet atëherë duhet të jepen sqarime. Tek testi i arritshmërisë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 kemi rënie nga 49.78% në 44.59 % dhe kjo është shumë shqetësuese. Sa i përket suksesit të shkëlqyeshëm të klasëve 1-5 po ashtu kemi rënie për 2.7%, tek klasët 6-9 sukcesi i shkëlqyeshëm po ashtu ka rënie për 0.73% dhe tek shkollat e mesme po ashtu kemi rënie të suksesit të shkëlqyeshme për 3.1 %. Duhet të kemi investime më të mëdha në rregullimin e oborreve të shkollave. Në fund pyeti se kush është staf në DKA dhe cila është përgatitje e tyre profesionale.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –tha se e ka lexuar në tërësi këtë informatë dhe vlerësoi se e përgëzon drejtoreshën e arsimit dhe stafin e saj për punën e mirë që janë duke bërë. Tutje shtoi se është evident fakti se ka të arritura në lëmin e arsimit në Vushtri, duke filluar nga organizimi i garave, që asnjëherë më parë nuk ka pasur kaq shumë organizime në këtë drejtim. Pastaj ka të arritura të konsiderueshme në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, në renovimin e objekteve, ndërtimi i shkollave të reja, fushave sportive, rrethojave të shkollave dhe laboratorëve. Në vazhdim ai duke ju referuar statistikave në informatë, ceku se kemi të arritura edhe për sa i përket suksesit të nxënësve si shkollat të mesme të ulëta e po ashtu edhe në shkollat e mesme të larta dhe këtyre sukseseve duhet të iu gëzohemi të gjithë. Kërkoj nga komuna që shkolla fillore “Nazmi Zhegrova” në Stanoc të Poshtëm të ketë kyçje në shërbimet e internetit në operatorin ipko sepse nga muaji mars kjo shkollë nuk ka qasje në rrjetin e internetit. Mandej kërkesa tjetër është që bëhet një aneks i objektit në shkollën “Nazmi Zhegrova” pasi që në fshatin Stanoc i Poshtëm është duke u rrit numri i banorëve dhe rrjedhimisht po rritet edhe numri i nxënësve. Në fund potencoi se kolektivi i shkollës fillore “Nazmi Zhegrova” në Stanoc të Poshtëm ka vërejtje të theksuara për sa i përket Draft-ligjit për pagat në koeficientet e mësimdhënësve për shkollat e mesme të ulëta në krahasim me shkollat e mesme të larta ku kërkoj që të kemi njëjtësim të këtyre koeficienteve dhe po ashtu kërkoj nga anëtarët e LVV-së në Vushtri që këtë kërkesë ta adresojnë në Ministrinë e Arsimit, pasi kjo ministri udhëhiqet nga ana kësaj partie politike.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-tha se kemi ngritje të rezultatit në testin e maturës të nxënësve të Shkollës së Mesme Profesionale “Bahri Haxha” ngritja është kualitative në rezultat nga viti 2022 ku kemi pas 39.53 % të kalueshmërisë, në vitin 2021 kemi 48.38 %, ndërsa në vitin 2022 72. 87 %, në këtë rast falënderoj të gjithë nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe stafin udhëheqës të shkollës për një punë të përbashkët ekipore e cila ka sjell këtë rezultat mjaftë të

favorshëm. Në fund ngrit një çështje të një shkolle në hyrjen e të cilës është vendosur një njoftim ku thuhet se <iu ndalohej prindërve hyrja në oborrin e shkollës dhe ndërtesën e shkollës>. Andaj rastet e tilla nuk i kontribuojnë bashkëpunimit në mes shkollë-nxënësve dhe prindërve, në këtë rast kërkoj nga DKA që ta urdhëroj drejtorin e asaj shkolle që ta heqë atë njoftim nga shkolla.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-duke ju referuar faqes 22 të informatës tek tabela krahasimore ku ceket se kemi rënie të suksesit shkëlqyeshëm në 2.7 %, ndërsa thuhet se në vitin 2021 shkëlqyeshëm kanë kaluar 958 nxënës për klasët nga 1-5, ndërsa në vitin 2022 1057 nxënës, pra është rritur numri i nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm nga 18 deri 22 %, kurse në përshkrim thuhet se kemi rënie në sukses, kjo sigurisht duhet të jetë ndonjë gabim. Mandej në faqen 25 kemi një lëshim që në titullin e tabelës për klasat e VI dhe IX suksesit i fund viti shkollor 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 për klasët VI dhe IX, pastaj në tabelë krahasimi nuk bëhen me vitin 2020 por për vitet 2021 dhe 2022 pra edhe në këtë rast kemi të bëjmë me ndonjë lëshim teknik. Në faqe 28 suksezi shkollor i fund vitit 2021 krahasuar me periudhën e vitit 2020 i klasëve të X dhe XII thuhet se tek suksezi shkëlqyeshëm kemi rënie të suksesit për 31 %, kurse krahasimi i vitit 2022 me vitin 2021 del që është rritur numri i nxënësve të shkëlqyeshëm nga 314 në vitin 2021 në 341 në vitin 2022. Situatë e njëjtë është edhe tek suksezi i nxënësve me sukses shumëmirë që në vitin 2021 kemi 479 nxënës me sukses shumëmirë ndërsa në vitin 2022 kemi 500 nxënës që i bie se kemi ngritje të këtij suksezi por që në përshkrim tekstual në informatë thuhet diçka tjetër. Përgjithësisht me përjashtim të këtyre gabimeve teknike është prezantuar një informatë e mirë, dhe i përgëzon të gjithë mësimdhënësit, DKA-në dhe nxënësit për suksesin e arritur në vitin shkollor. Në fund kërkoj nga të gjithë që të kemi një debat substancial dhe analitik sa i përket arsimit dhe cilësisë së tij në komunën tonë, duke lënë anash obstrukcionet politike.

**Miradije Maloku, drejtoreshë e DKA-së**-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me informatën për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022/2023, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Duke ju referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit z.Ymer Hardinaj për disa punëtor të arsimit që kanë marr pagë më tepër se sa iu ka takuar ceku se numri i këtyre punëtorëve është 15 e jo 3 siç u prezantua, ajo sqaroi se këtë gjendje e ka trashëguar dhe është në përpjekje për ta rregulluar, por kjo çështje ka të bëjë me ndryshime në sistem. Më tej ajo paraqiti statistika dhe të dhëna tjera të vlefshme lidhur me numrin e nxënësve dhe për klasët e kombinuar ku u zotua se do të bëjë përpjekje për zgjidhjen e problemeve sa i përket mësimin të kombinuar.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-falënderoj drejtoreshën për informatën korrekte që e ka prezantuar para kuvendit, duke ditur se udhëheqë njërin ndër dikasteret më të vështirë për tu menaxhuar, i dëshiroj punë të mbarë dhe suksese.

**4. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun;**

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-parashtrij pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, përse nuk e keni paguar shpërblimin e klubit të Hendbollit “Vushtrria F” që janë bërë kampion i Kosovës vitin e kaluar ashtu siç parashihet me Rregulloren Komunale për Dhënie dhe Dekorativë, ku parashihet se këtij klubi i takojnë rreth 5000 €.

**Medina Bunjaku, drejtoreshë e DKRS-ës**-tha se kjo ngjarje ka ndodhur në mandatin e kaluar dhe kjo qeveri nuk ka obligim ti përmbush kërkesat nga mandati i kaluar.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës**-tha se konform rregullores komunale, komuna ka obligim ti përmbush obligimet nga e k lura dhe konform buxhetit që kemi do ta përmbushim atë obligim.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022;

**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit**-tha se nuk ka informacione se kjo informatë a është hartuar në formë shabllon pasi që në këtë dokument përmendet emri i ish-kryetarit të komunës Xhafer Tahiri, kërkoj që kjo të korrigjohet pasi që është jo serioze të dilet në publik një dokument me kësi lloje gabimesh.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës**-tha se një gabim i tillë është trashëguar nga e kaluara dhe është përsëritur nga zyra e kryetarit të komunës i njëjti do të përmirësohet.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-njoftoi se në fillim të mbledhjes u kërkuar që kjo pikë të mos futet në rend të ditës, pasi që e njëjta duhet korrigjuar dhe më tej të procedohet.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-sqaroi se kjo pikë e rendit të ditës është e paraparë me planin e punës të kuvendit e njëjta duhet të korrigjohet dhe ashtu të procedohet.

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit**- propozoi Arlind Gogollin për anëtar të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës; nga radhët e PDK-së.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-deklaroi se grupi kuvendar i LDK-së nuk ka propozim për këtë komision.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se duhet pasur për bazë ligjshmërinë e këtij vendim, sepse në radhe e propozimeve për këtë komision kemi shërbyes civil që nuk dihet a është në rregull që ata të jenë pjesë e këtij komisioni. Për këtë komision nga radhët e LVV-së propozoi z.Refik Malokun.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës**-propozoi për anëtarë të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës z.Isak Hyenin nga radhët e shoqërisë civile.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit**-tha se është shqetësues fakti se shefi i grupit kuvendar të LDK-së z.Adnan Lahu heqë dorë nga propozimet për komisione komunale e që janë obligime ligjore, sepse anëtari i LDK-së z.Shkelzen Xhaferi në cilësinë e anëtarit të komisioneve të ndryshme nuk i ka kryer si duhet detyrat e tij.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet Komisioni vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, për ofrim të shërbimeve të transportit të mjeteve motorike me automerimangë në territorin e komunës.

2. Në përbërje të komisionit vlerësues caktohen:

**2.1.Arlind Gogolli, anëtar i Kuvendit (PDK);**

**2.2.Refik Maloku, anëtar i Kuvendit (LVV);**

**2.3.Benjamin Shala, ekzekutivi i komunës (DSHP);**

**2.4.Bajram Beqiri, ekzekutivi i komunës (përfaqësues nga DMSH);**

**2.5.Isak Hyseni, shoqëria civile në nivel komunal.**

3. Anëtarët e komisionit vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

4. Komisioni vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për shërbimin e transportit me automerimangë, në pronën e përfshirë në vendimin paraprak të Kuvendit të komunës.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

5.1 Komisioni vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për shërbimet e transportit me automerimangë në pronën e paluajtshme të komunës, e cila është dhënë në shfrytëzim, që nënkupton:

5.2. Njoftimin publik i cili zgjat 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit;

5.3. Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës dhe së paku në një të njërin nga mediat e shkruara dhe elektronike;

5.4. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e shërbimit me automerimangë, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit, arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave;

5.5. Pas pranimit të ofertave, Komisioni vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik;

5.6. Komisioni vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të shërbimeve të transportit me automerimangë;

5.7. Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës, si dhe të njëjtin iu dërgon palëve të përfshira në proces.

5.8. Komisioni vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automerimangë, ofertën e përzgjedhur e procedon tek Kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin.

5.9. Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

5.10. Komisioni, për punën e tij mban procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit vlerësues.

6. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

## **7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga taksa komunale për projektet investive të KEDS-it gjatë vitit 2022;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se kjo pikë e rendit të ditës është e elaboruar mirë e njëjta është konform rregullores dhe për të njëjtën kemi një interes si komunë për zhvillimin e infrastrukturës publike andaj kërkoj që ky propozim vendim të mbështet nga të gjitha grupet kuvendare.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se për lirim nga këto taksa komunale, nëse ekziston rregullorja komunale, atëherë ky propozim-vendim nuk është dashur të silllet fare në kuvend. Në të kundërtën nëse parashihet me rregullore, në emër të grupi të tij kërkoj që operator ekonomik KEDS të mos lirohet. Por që i njëjti ti kryen obligimet financiare për prerje të asfaltit, pasi që kjo kompani është profitabile.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës**-tha se sa i përket anës ligjore të kësaj pike të rendit të ditës, këtë mund ta vlerësoj zyra ligjore e komunë e cila është prezentë në këtë mbledhje të kuvendit dhe njoftoj se në takimin që kanë pasur me zyrtarët e KEDS- janë dakorduar që për vitet e ardhshme projektet që i zhvillon komuna, në infrastrukturë, atëherë KEDS-i ti paraprij me shtrimin e kabllove elektrike, andaj në këtë rrafsh kërkon që kjo pikë të mbështete pasi që është në interes të komunës të rritet bashkëpunim me KEDS-in për investime të reja.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-kërkoj që në propozim-vendim- të bëhet korrigjimi i toponimeve të bëhen sipas emërtimeve zyrtare. Për këtë vlerësoi se është mirë ti dërgohet një shkresë zyrtare KEDS-it, që tu kërkohet që të përmirësohen këto emërtime.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-tha se nëse ka ndonjë marrëveshje mes komunës dhe KEDS-it atëherë është mirë që ajo ti prezantohet kuvendit, në këtë kontekst shtoj se nëse KEDS investon në kthimin e rrugëve në gjendje e mëparshme, ky propozim-vendim duhet të përkrahët në mënyrë unanime nga kuvendi.

### **Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës Kuvendi pas votimit me 16 vota “për” 10 vota “kundër” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lirohet nga taksa komunale për prerje të asfaltit dhe demolim të kubëzave Divizioni i Shpërndarjes KEDS, i cili është duke i implementuar projektet me plan investiv 2021 në Komunën e Vushtrrisë si në vijim:

1.1. Projekti “TS Idrizi” fshati Dobërllukë, ndërtimi i rrjetit TM10 (20)kv dhe TU0.4Kv;

1.2. Projekti Dobërllukë (Banjska), zgjerim dhe përforsim i rrjetit distributiv;

1.3. Projekti, Stanoci 1 “Prekazët”, fshati Stanoc i Poshtëm, Komuna e Vushtrrisë zgjerim dhe përforsim i rrjetit distributiv;

1.4. Projekti Bregaj - Stanoc, fshati Stanoc i Epërm, Komuna e Vushtrrisë, zgjerim dhe përforsim i rrjetit distributiv.

2. Këto projekte kanë për qëllim riparimin e rrjetit elektrik dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike në komunën tonë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Inspektive.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së** – para se ta hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, po ju sqaroi se pikat që kanë ardhur para mbledhjes së KPF-së janë përgatitur sipas statutit të vjetër. Kështu që, ajo kërkoi nga sekretaria e kuvendit që vendimet të hartohen në harmoni me statutin e ri sepse tani statuti ka hi në fuqi. Prandaj, kjo pikë e rendit të ditës duhet të trajtohet sipas rregullave të statutit të ri, ku neni 17, paragrafi 11 parasheh që: “Vendimi për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore, merret me votat e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit të komunës. Votimi në të gjitha rastet bëhet në mënyrë të fshehtë”.

**Ali Januzi, anëtar i KK-së** – tha se sot me kënaqësi diskuton për këtë pikë të rendit të ditës. Është një gëzim dhe sukses i madh që prej vitit 1945 deri më sot, pra pas 77 viteve po diskutojmë për një figurë të madhe. Pra, fjala është për komandantin, Adem Voca, i cili veç ka hyrë në analet e historisë. Nuk mund të flas shumë për figurën e tij, pasi që nuk jam historian, por për të folur për të duhet një akademi e tërë të debatohet dhe të diskutohet dhe ta ngris aty ku e ka vendin, Adem Voca. Historia nuk fillon me ne, ajo është e gjatë dhe gjeneratat para neve kanë dhënë kontribut të madh për lirinë e këtij vendi. Kemi marrë një iniciativë për ndërtimin e lapidarit për Adem Vocën, në vendin ku e ka pasur shtëpinë dhe kullën (ku kulla e tij në vitin 1945 është rrafshuar). Ai trull nuk ka kontest dhe ai vend ka një histori të gjatë. Ne lagjja “Dautaj”, e kemi blerë atë vend, kur kanë dalë ata prej aty. Por, ato dokumente sistemi jugosllav i ka djeg dhe shkatërruar. Lapidari duhet të vendoset aty ku është bërë rezistenca nga Adem Voca. Prandaj, po e lus kuvendin dhe komunën që sa më shpejtë të fillojë ndërtimin e këtij lapidari. Kam biseduar me kryetarin e komunës dhe i thashë se nëse bëhet një lapidar shkel e shko, më mirë ta lëmë krejt këtë punë. Në fund tha se ashtu siç ka qenë figurë madhështore Adem Voca, kërkoj që me vota unanime kuvend ta votoj këtë lapidar me qëllim që ta nderoj historinë dhe figurën e Adem Vocës.

**Agron Përçuku, anëtar i KK-së** – e përshëndesim këtë iniciativë nga propozuesi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë. Por, kemi kërkuar në KPF nga hartuesi i këtij propozimi që kur bëhet fjalë tek prona (ku në kadastër figuron tokë bujqësore), kemi kërkuar që të bëhet ndërrimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Pra, ta votojmë me komplet dokumentacionin ashtu siç duhet.



**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për** – tha se pa marrë vendim kuvendi për caktim të lokacionit nuk mund të bëjmë shndërrimin e tokës bujqësore në ndërtimore, sepse nuk e dimë se a kalon a jo. Ai tha se ne do ta bëjmë shndërrimin pas aprovimit nga kuvendi.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkryetar i komunës** – tha se pas miratimit të vendimit nga kuvendi, pastaj shkon për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL. Por, kjo tokë është e klasës së katër dhe drejtorja nuk mund drejtpërdrejt ta bëjë shndërrimin e tokës bujqësore në ndërtimore (por vetëm nga klasa e pestë e tutje). Por, pasi është çështja për lapidar, besoj që edhe ministria do të has në mirëkuptim dhe do ta kthej të ligjshëm vendimin, në mënyrë që t'i vazhdojmë procedurat tjera.

**Ali Januzi, anëtar i anëtar i kuvendit-** nuk i di kategoritë e tokave, por ajo mund të jetë e klasës së gjashtë apo shtatë, sepse gjendet në breg dhe është e klasës më të dobët. Më tej njoftoi se ai lapidar po ndërtohet në oborrin e tij ku e kishte bërë rezistencën kundër armikut. Prona më vonë është blerë nga lagjja “Dautaj” dhe është mbete në shërbim të katundit, në këtë kontekst kërkoj që thjeshtëzohen procedurat dhe mos të shkaktohen probleme sepse bëhet fjalë për një figurë unike dhe madhështuare që ka luftuar për lirinë e këtij vendi.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së**– lexoj edhe një herë paragrafin 11 të nenit 17 të Statutit të komunës, i cili thotë: “Vendimi për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore, merret me votat e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit të komunës. Votimi në të gjitha rastet bëhet në mënyrë të fshehtë”.

Meqenëse e kemi votimin e fshehtë, ajo kërkoi themelimin e komisionit prej tre anëtarëve për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

**Ali Januzi, anëtar i anëtar i kuvendit-** pasi që nuk i njoh këto procedura, por të gjithë lapidarët që janë bërë që nga paslufta nuk kanë shkuar në këtë formë.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së**– sqaroi se tashmë statuti i ri i komunës ka hyrë në fuqi dhe ligjërisht kjo është procedura e votimit që parashihet, për votimin për ndërtimin e lapidarëve.

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-** propozoi znj. Nuri Halili nga radhët e PDK-së për anëtare të komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit lidhur me aprovimin e propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë.

**Alban Bajrmai, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi z.Agron Perçukun për anëtar të komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit lidhur me aprovimin e propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi z.Mek Selacin për anëtar të komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit lidhur me aprovimin e propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë.

*Kuvendi i komunës me shumicë votash themeloi komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit, lidhur me aprovimin e propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë. në këtë përbërje:*

*Nurie Halili, anëtare e kuvendit (PDK);*

*Agron Përçuku, anëtar i kuvendit- (LDK) dhe*

*Mek Selaci, anëtar i kuvendit- (LVV).*

*Komisioni, për mbarëvajtjen e procesit të votimit, lidhur me aprovimin e propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pas numërimit të votave konstatoi se nga 27 fletëvotime, 24 vota janë “për” dhe 3 vota “kundër” në ç’ rast konstatoj se aprovohet propozim-vendimi në fjalë.*

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e kuvendit**-konstatoj se miratohet propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit vendosi me sa vijon:*

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të patundshmërisë të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, kurse me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destinimit (kulturës) së kësaj parcele në elaboratin kadastral.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

## **9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit të ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.**

**Ymer Haradinaj, anëtar i KK-së** – tha se neni 10 i Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane parasheh që: “Kuvendi i komunës themelon komisionin e ankesave, i cili i shqyrton ankesat lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale; Komisioni i ankesave do të ketë 3 anëtarë, të cilët zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës; Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e komunës; Të gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor; Ankesat për parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten tek komisioni për ankesa brenda 3 ditëve të punës; Komisioni i ankesave është i obliguar që t’i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e parashtrimit të ankesës t’ju kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën; Vendimet e komisionit të ankesave janë përfundimtare në procedurën administrative dhe të obligueshme për palët; Komisioni i ankesave i raporton Kuvendit të komunës”.

Në ditën kur është themeluar komisioni, na është dërguar vendimi për themelim, mirëpo vendimi është i mangët, për shkak se në vendim ka pasur kërkesë dhe është aprovuar nga kuvendi i komunës që ky komision për punën e bërë do të kompensohet. Kurse, kur na është dërguar vendimi, nuk parashihet mënyra e kompensimit. Prandaj, ai kërkoi që të plotësohet ky vendim dhe të parashihet kompensimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, sepse është një punë shumë voluminoze, e cila po na merr shumë kohë.

Ai tha se si komision do ta sjellim në seancën e nëntorit raportin me shkrim, ku deri më tani i kemi zgjedhur 10 këshilla lokale, kurse në disa zona nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm. Ai tha se nga dita e shtunë do të fillojë zgjedhja e këshillave në qytet dhe i ftoi qytetarët që të marrin pjesë sa më masivisht, për zgjedhjen e këtyre këshillave, sepse janë shumë të rëndësishme.

Si komision, së bashkë me drejtoreshën e administratës i kanë përgatitur njoftimet dhe ato t'iu shpërndahen qytetarëve për t'u njoftuar për zgjedhjen e këtyre këshillave.

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-** propozoi z.Kushtrim Hysenin për anëtar të komisionit të ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.

**Alban Bajrami, anëtar i kuvendit-** propozoi znj.Edona Gashi për anëtare të komisionit të ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KK-së** – tha se ky komision po formohet jashtë afatit ligjor që e parasheh rregullorja. Por, sido që të jetë, komisionit i uroj punë të mbarë. Propozoj znj.Fatmire Cecelija për anëtare të këtij komisioni.

***Kuvendi i komunës me shumicë votash themeloi komisionin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale, në këtë përbërje: Kushtrim Hyseni, Edona Gashi dhe Fatmire Cecelia.***

**1.** Me këtë vendim formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave Lokale në Komunën e Vushtrrisë, në përbërjen si në vijim:

**1.1.Kushtrim Hyseni, anëtar i Kuvendit (PDK);**

**1.2.Edona Gashi, anëtare e Kuvendit (LDK);**

**1.3.Fatmire Cecelia, anëtare e Kuvendit (LVV).**

**2.** Komisioni i ankesave i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor duhet të kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën, lidhur me parregullsitë eventuale që janë shkaktuar gjatë procesit të zgjedhjes së këshillave lokale në Komunën e Vushtrrisë.

**3.** Vendimet e komisionit të ankesave janë përfundimtare në procedurën administrative dhe të obligueshme për palët.

**4.** Për punën e tij komisioni i raporton Kuvendit të komunës, ndërsa për funksionimin e tij komisioni zgjedh kryesuesin e tij nga radhët e veta.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit të cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**10.** Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e rregullores për komitetet e kuvendit.

**Nurie Halili, anëtare e kuvendit-** propozoi z.Ilmi Azemi për anëtar të komisionit për hartimin e rregullores për komitetet e kuvendit, nga radhët e PDK-së.

**Edona Gashi, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi Shkelzen Xhaferin për anëtar të këtij komisioni.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Sylejman Mehollin për anëtar të këtij komisioni.

*Kuvendi i komunës me shumicë votash themeloi komisionin për hartimin e rregullores për komitetet e kuvendit, në këtë përbërje: Ilmi Azemi, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Meholli, Ismet Gashi dhe Bastri Duraku.*

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Rregullores për funksionimin e komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në përbërjen si në vijim:

- 1.1. **Ilmi Azemi, anëtar i Kuvendit (PDK);**
- 1.2. **Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);**
- 1.3. **Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit (LVV);**
- 1.4. **Ismet Gashi, nga zyra ligjore e komunës dhe**
- 1.5. **Bastri Duraku, nga sekretaria e kuvendit.**

2. Komisioni i cekur në pikën një (1) të këtij vendimi, do të hartojë draftin e kësaj rregulloreje dhe të njëjtën do ta procedojë në kuvend për aprovim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit të cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora: 15:10.**

**Bastri Duraku**

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Procesmbajtës**

---

**Kryesuese e Kuvendit**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna Vushtrri  
Opstina Vucitrn - Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

DATË/A	03.11.2022
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës Znj. Melihate Basholli-Latifi
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
NGA/OD/FROM:	Drejtor i drejtorisë Fortuna Krasniqi-Spahi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal e cila ka të bëjë me Informatën lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal e cila përfshinë periudhën nga Janari i këtij viti, DUMM ju informon se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal i aprovuar me vendim nr.01Nr.126/17 të dt.04.05.2017 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë për periudhën 2016-2024, i cili është një plan strategjik multi-sektorial dhe përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare.

Vlerësimi i zbatimit të planit është bërë duke analizuar realizimin e aktiviteteve të parapara me plan dhe efekteve të arritura nga zbatimi i tyre në raport me arritjen e synimeve të planit si dhe Vizionin e Komunës.

Vizioni i Planit Zhvillimor Komunal është

- Vushtrria, qytet i lashtë me trashëgimi të pasur kulturore.
- Vend me toka bujqësore, atraktiv dhe dinamik në zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit.
- Vend i turizmit malor – rekreativ dhe kulturorë, në mjedis të pastër
- ekologjik.
- Vend me potencial të madh të popullsisë së re dhe të kualifikuar

Vizioni është pasuruar me një përfshirje të synimeve që kanë një radhitje sipas fushave tematike të: zhvillimit hapësinor dhe shfrytëzimit të tokës, zhvillimit ekonomik, përmirësimit të infrastrukturës teknike dhe shërbimeve publike, mbrojtjes së mjedisit dhe resurseve natyrore, promovimit të trashëgimisë kulturore. Në kuadër të fushave tematike janë të përfshira një sërë objektivash dhe me këtë raport është vlerësuar zbatueshmëria e objektivave.

Analiza dhe rezultatet e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal bazohen në këto fusha kryesore:

- Sa i përket **Planifikimit hapësinor dhe shfrytëzimit bazë të tokës DUMM** ka zbatuar Planin Zhvillimor Komunal në çdo kërkesë nga zyrtaret përgjegjës gjatë shqyrtimit të kërkesave të pranuar që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale, janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2016-2024 duke respektuar destinim e sipërfaqeve dhe ruajtjen e tokës bujqësore si dhe asetet e trashëgimisë kulturore.
- **Zhvillimi ekonomik dhe bujqësia**- Si katalizatorë për zhvillim ekonomik në komunën e Vushtrrisë është bujqësia po ashtu zhvillimi i zonave për tregti dhe prodhimtari, zhvillimi i zonave komerciale. Ndër projektet të cilat janë realizuar dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimit ekonomik janë: subvencionimi i fermerëve në mënyra të ndryshme, subvencionimi i bizneseve dhe bizneseve fillestare, etj.
- **Infrastruktura transporti dhe shërbimet** – Në PZHK parashihen aktivitete për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme andaj janë ndërmarrë masa për zhvillimin e projekteve të ndryshme për përmirësimin e infrastrukturës rrugore e cila rezulton me lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe shmangien nga bllokimi i trafikut. Ndër projektet janë: ndërtimi-asfaltimi i rrugëve lokale, funksionalizmi i trotuareve nëpër rrugë dhe nëpër zona tjera, ndriçimi publik nëpër rrugë, përmirësimi i infrastrukturës teknike ujësjellës-kanalizim etj.
- **Mjedisi, resurset natyrore, degradimi dhe fatkeqësitë natyrore:** Mbrojta e lumenjve, mbrojta e pyjeve, përmirësimin e gjendjes së mjedisit është ndër prioritetet e PZHK-së. Ndër projektet që kanë ndikim të drejtpërdrejt në mjedis janë: Rregullimi i shtratit të lumit Silnica, pastrimi i lumenjve dhe përrockave, mbjellja dhe ruajtja e gjelbërimit të ulët dhe të lartë në tërë territorin e komunës si dhe mbrojta e pyjeve me anë të inspektimeve.
- **Trashëgimia kulturore dhe turizmi** -Në PZHK është potencuar se aset tjetër i rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe ulje të papunësisë është trashëgimia kulturore dhe natyrore që posedon Vushtrria. Konstatim i përgjithshëm është që komuna është duke vazhduar t'u jep prioritet trashëgimisë kulturore, përmes vetëdijesimit dhe promovimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, e cila do të rrit zhvillimin e turizmit si dhe zhvillimit të turizmit malor ku si projekt i rëndësishëm konsiderojmë fillimin e ndërtimit të rr. Vesekoc-Sllakoc e cila lidhet me rrugët në malet e shalës.

Me respekt!





*Republika e Kosovës*



*Komuna Vushtrri*

*Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural*

<i>DATE:</i>	<i>04.11.2022</i>
<i>REFERENCË:</i>	<i>09.nr. 189/22</i>
<i>PËR:</i>	<i>KPF-në dhe KK-në</i>
<i>PËRMES:</i>	<i>Sekretarisë së Kuvendit Komunal në Vushtrri</i>
<i>NGA:</i>	<i>Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, drejtor Ergin Sunguri</i>
<i>TEMA:</i>	<i>Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë</i>

## Sektori për biznes

Qendra Komunale e Biznesit vepron në kuadër të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës - Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. QKB – ja funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare, kërkesa për ndryshim si dhe shërbime të tjera. Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Europian

Qendra komunale e biznesit është e orientuar drejt zhvillimit, që ofron arritjen e efikasitetit më të madh, me një cilësi më të lartë për të gjitha bizneset që operojnë në komunën tonë.

Po ashtu është punuar në mënyrë sistematike dhe në shërbim maksimal për ofrimin e kushteve bizneseve për kryerjen e shërbimeve të tyre në mënyrë efikase dhe të shpejtë. Qëllimi ynë është të ofrojmë një shërbim institucional të përgjithshëm dhe të krijojmë kulturë administrative tek biznesi.

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	Biznese të reja ( të regjistruara) individuale	91	
2.	Biznese të reja ( të regjistruara ) Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	168	
3.	Biznese të shuara	51	
4.	Ndërrime të logove të certifikatave	172	
5.	Ndryshime në bizneset ekzistuese		
	154		
6	Vërtetimet	8	
<b>Gjithsej</b>		<b>644</b>	



Siç shifet nga të dhënat e mësipërme, gjatë periudhë 01.01 – 30. 09.2022 numri i bizneseve të reja të regjistruara ( Biznese Individuale dhe Shoqëri me përgjithësi te Kufizuar ), në QKB është 259 biznese.

QKB – ja përveç raporteve javore dhe mujore të cilat i dorëzon në Agjencionin për regjistrimin e bizneseve të Kosovës, dorëzon edhe në drejtorin për inspektion dhe sektorin e taksave të drejtorisë së financave me qëllim që të përcillen regjistrimet e reja të bizneseve dhe shuarjet e bizneseve ekzistuese.

Përveq shërbimeve të lartshënuara, Sektori i Bizneseve i DEBZHR ka kryer edhe lëndë të tjera si:

- vazhdimin e lejeve për transportin autotaxi
- dhënja e vërtetimit për personat të cilët nuk kanë biznes të regjistruar.

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01 – 30.10. 2022

<b>Kodi</b>	<b>VEPRIMTARIT EKONOMIK</b>	<b>Bizneset prej 01.01-30.09.2022</b>	<b>%</b>
<b>I</b>	<b>2</b>		
<b>A</b>	<b>Bujqësia, Gjuetia dhe pylltaria</b>	<b>8</b>	<b>3.08</b>
<b>B</b>	<b>Peshkimi</b>		
<b>C</b>	<b>Industria e Minierave dhe Ekstraktuese</b>		
<b>D</b>	<b>Industria përpunuese</b>	<b>34</b>	<b>13.12</b>
<b>E</b>	<b>Furnizimi me energji elektrike dhe ujë</b>	<b>3</b>	<b>1.16</b>
<b>F</b>	<b>Ndërtimtaria</b>	<b>38</b>	<b>14.68</b>
<b>G</b>	<b>Tregtia me shumicë dhe pakice riparimi i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisëri</b>	<b>54</b>	<b>20.84</b>
<b>H</b>	<b>Hotelet dhe Restorantet</b>	<b>31</b>	<b>11.97</b>
<b>I</b>	<b>Transporti,depot dhe telekomunikacion</b>	<b>15</b>	<b>5.79</b>

<b>J</b>	<b>Aktivitetet Financiare</b>	<b>6</b>	<b>2.32</b>
<b>K</b>	<b>Pasurit e patundshme:dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit</b>	<b>31</b>	<b>11.97</b>
<b>N</b>	<b>Administrimi dhe Mbrojtja publike Mbrojtja e obligueshme sociale</b>	<b>6</b>	<b>2.32</b>
<b>M</b>	<b>Arsimi</b>	<b>4</b>	<b>1.54</b>
<b>O</b>	<b>Aktivitet tjera shoqërore dhe personale</b>	<b>29</b>	<b>11.3</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>259</b>	<b>100</b>

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme nga 259 bizneset e regjistruara për periudhën 01.01. deri më 30.09.2022 edhe më tutje dominon veprimtaria tregtare 22.80 % 54 biznese nga 259 biznese sa janë të regjistruara, pastaj ndërtimtaria me 38 biznese sa janë te regjistruara apo me 14.68 %, industria perpunuese me 34 biznese apo me 13.12 % ,bujqësia me 8 biznese apo 3.08 %etj.

Ndërsa në bazë të të dhënave te siguruar nga ATK – zyra regjionale ne Mitrovicë, gjithsej numri i të punësuarëve në komunën tonë – sektorin privat është;

- **Të vetëpunësuar 1210**
- **Të punësuar – dallon sipas muajve por qe mesatarja e te punesuarëve është 4805**

## **Objektivat e sektorit për zhvillim ekonomik – biznes janë:**

- afrimi i shërbimeve të avancuara për biznese
- zvogëlimi i numrit të bizneseve pasive
- bashkëpunimi më i ngushtë me biznese e sidomos me ato prodhuese të cilat mund të gjenerojnë vende të reja te punës.
- vizitat me të shpeshta nëpër biznese me qëllim që të njihen me mundësit e zgjerimit të bizneseve të tyre
- Drejtoria për Ekonomi është e hapur çdo here për bashkëpunim me shoqatat e ndryshme afariste por edhe për çfardo kërkesë që vjen nga ato.
- themelimi dhe bashkëpunimi dhe më i ngusht ne mes të shoqatës afariste dhe Drejtorisë për Ekonomi.
- Përkrahja më e madhe e bizneseve bujqësore etj.



**Republika e Kosovës**

**Komuna e Vushtrrisë**

Për: Komitetin për Politik dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës  
Propozues: Kryetari i Komunës G. D. D. D. D.  
Hartues: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit F. J. J. J. J.  
Çështja për shqyrtim: Propozim-Vendim për Raportin e Vlerësimit Vullnetar Lokal të Komunës së Vushtrrisë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2022 , merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij Raporti obligohen Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli

\_\_\_\_\_  
Kryesuese e Kuvendit

## A r s y e t i m


Komuna e Vushtrrisë me datën 17 dhjetor 2021 ka shpreh interesimin në Un-Habitat për mbështetje të hartimit të Raportit të Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) që do të shërben si një përshpejtues i fuqishëm në procesin e lokalizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në mënyrë që të realizohen OZHQ-të në nivel lokal, është e rëndësishme që njerëzit të jenë në qendër dhe të maksimizohet ndikimi i veprimeve komunale me politika që njëkohësisht ndikojnë në ndryshime sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Me datën 24.01.2022 Komuna e Vushtrrisë ka pranuarë shkresë me aprovimin për mbështetjen nga UN-Habitat-i me mbështetjen e Koordinatorës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe së bashku me agjencitë, fondet dhe programet e Ekipit të KB-së në Kosovë të cilët janë shprehur se janë të kënaqur të bashkëpunojnë me Komunën e Vushtrrisë në zhvillimin e raportit të parë të VVL-së në Kosovë. Duke vepruar kështu, bashkërisht do të sigurojmë koordinim efektiv qendror me Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kuvendit të Kosovës, Agjencinë e Statistikave dhe institucionet tjera në proces. Siç e dini, një proces i suksesshëm i raportit të VVL-së mbështetet në pronësinë institucionale, angazhimin gjithëpërfshirës të palëve të interesit dhe një bazë e fortë e të dhënave.

Ky dokument do t'i shërbejë komunës jo vetëm të vlerësoj performancën aktuale por edhe si pasqyrë për planifikimin dhe zhvillimin e politikave në vazhdim.

Andaj bazuar në raportin e hartuar nga ekipa komunanle dhe e mbështetur nga UN-Habitat-i me mbështetjen e Koordinatorës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në mënyrë që të realizohen OZHQ-të në nivel lokal, kërkojmë nga ju aprovimin e këtij propozim vendimi si në dispozitiv.

Të bashkangjitur gjeni Raporti i Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë.

Drejtoresha e drejtorisë  
  
Fortuna Krasniqi Spahiu



Komuna e Vushtrisë

DRAFTI FINAL - RAPORTI

# VLERËSIMI VULLNETAR LOKAL (VVL) I KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Tetor 2022



PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS

zbatuar nga:



mbështetur nga:



financuar nga:





## MOHIM PËRGJEGJËSIE

Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të asnjë vendi, territori, qyteti ose zone, ose të autoriteteve drejtuese të tyre e as për përcaktimin e kufijve apo vijave ndarëse të tyre. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanime Njerëzore, të Kombeve të Bashkuara dhe të Shteteve Anëtare të saj. Pjesë nga ky botim mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2022

Komuna e Vushtrrisë

Rr. "Isa Boletini" – nr. 10, 42000 Vushtrri, Kosovë <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat) Kosovë

Ndërtesa e Ministrive "Rilindja", kati i 10-të

10000 Prishtinë, Kosovë

[www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)

[www.unhabitat-kosovo.org](http://www.unhabitat-kosovo.org)

Figurat, tabelat dhe diagramet e përdorura në këtë raport janë pronë e UN-Habitat Kosova, përveç nëse paraqiten ndryshe. Lejohet riprodhimi i tyre me kusht që së bashku me fotografitë, hartat ose diagramet, të shtypet burimi.



#### Titulli i projektit:

Vlerësimi Vullnetar Lokal për Komunën e Vushtrrisë

#### Përfitues:

Komuna e Vushtrrisë

Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm/Kuvendi i Kosovës

#### Agjencia zbatuese:

Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës/UN-Habitat Kosova

## FALËNDERIM I VECANTË SHKON PËR KONTRIBUESIT KRYESORË NË HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMI VULLNETAR LOKAL

### AGJENCIA ZBATUESE

#### Ekipi i projektit nga UN-Habitat në Kosovë

Rong Yang (U.D. Shef i Zyrës), Omar Siddique (ish-Shef i Zyrës) Artan Rexhepi (Zyrtar i Menaxhimit të Programit), Katarina Palushaj (Menaxhere e Projektit dhe Udhëheqëse e Ekipit për Raportin e VL-së), Alma Paçarizi (Koordinatorë mbështetëse dhe Planere Urbane), Miredita Kosova (Asistente Administrative/Financiare), Adem Llabjani (Zyrtar për Logjistikë), Konsulentët e jashtëm: Iliriana Miftari (Eksperte e të Dhënave), Dardan Abazi (Specialist për Raport),

#### Ekipi komunal i projektit nga komuna e Vushtrrisë

Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës), Shpetim Zhegrova (Nënkryetar i Komunës), Melihate Basholli Latifi (Kryesuese e Kuvendit), Fortuna Krasniqi Spahiu (Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje e Mjedisit), Miradije Neziri Maloku (Drejtorja për Arsim), Islam Latifi (Drejtorja për Shërbime Publike), Agim Miftari (Drejtorja për Arsim), Ylber Maxhuni (Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë), Burim Rexhepi (Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport), Remzije Zekolli (Drejtorja për Administratë), Merita Rama Mulaku (Drejtorja për Buxhet dhe Financa), Tefik Maloku (Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Rabije Zahiti (Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural), Isa Latifi (Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit), Ahmet Shuku (Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit), Fitore Hyseni (Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale), Egzon Haradinaj (Drejtorja për Inspektime), Ramiz Maliqi (Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit).

#### Autorët e raportit të VL-së

#### KONTRIBUESIT

#### UN-Habitat në Kosovë

Katarina Palushaj, Alma Paçarizi, Iliriana Miftari, Dardan Abazi.

Besnike Koçani (Këshilltare për Planifikim Urban/Hapësinor), Blerina Boshnjaku (Planere Urbane/Hapësinore), Shkumbin Hasani (Këshilltar për Pjesëmarrje Qytetare), Erëza Bokshi (Praktikante për planifikim dhe zhvillim gjithëpërfshirës së qyteteve), Anni Wagenius (Praktikante për planifikim dhe zhvillim gjithëpërfshirës së qyteteve), Maria Natale Martino (Praktikante për Ndryshime Klimatike).

#### UN-Habitat në Nairobi

Martino Miraglia (Zyrtar për Vendbanime Njerëzore), Claudia Garcia (Interne për Lokalizim të OZHQ-ve), Francine Melchiorretto (Eksperte për Lokalizimin e OZHQ-ve).

#### Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Vlora Tuzi Nushi (UN WOMEN), Lorik Pustina (UNKT), Yllka Pllana (UNKT), Teuta Halimi (UNICEF), Svetlana Rakic (IOM), Milanka Bazdar (UNHCR), Arben Qirezi (UNKT), Arjeta Gjokolli (Unicef), Shpend Qamili, (UNKT), Umberto D'amato (DCO), Chiara Amato (UNKT).

Këshillimi për Zhvillim të Qëndrueshëm	Fatmire Mulhaxha Kollçaku (Kryesuese e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm/Parlamenti i Kosovës), Shqipe Krasniqi (Koordinatorë për Donatorë dhe OSHC-të/Parlamenti i Kosovës).
Agjencia e Statistikave të Kosovës	Ibrahim Rustemi (Drejtor i Departamentit për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim), Ilir Berisha (Zyrtar), Arta Salihu Morina (Zyrtar).
Kontribuesit e tjerë	Modest Gashi (Këshilltar për Planifikim Urban/Hapësinor), Fjollë Caka (Këshilltare për Planifikim Hapësinor/Urban), Kenan Beqiri (CBM), Arta Haxhaj (Komuna e Vushtrrisë), Shukrane Begu (Komuna e Vushtrrisë), Ergin Sunguri (Komuna e Vushtrrisë), Medina Bunjaku (Komuna e Vushtrrisë), Ekrem Merovci (Komuna e Vushtrrisë), Besarta Muzaqi (Komuna e Vushtrrisë), Hyrie Hoxha (Komuna e Vushtrrisë), Bujar Klinaku (Komuna e Vushtrrisë), Qemajl Hasani (Komuna e Vushtrrisë), Arber Hoxha (KVRL), Rinor Beqiri (ORDA), Blerim Ibrahim (Stand Out), Zenel Bunjaku (IADK), Isak Hyseni (Handikos), Vildane Mulaku (Martirët e Lirisë), Arianit Hajdari (Hareja), Lirim Kosumi (Hareja), Shkelqeca Trepca (The power of mind), Mergime Jashari (Ura sociale), Drita Dibrani (Këshilli), Jetush Ademi (Kalaja e Vushtrrisë), Selatin Emini (Romano Anglunipe), Bransilav Vuksanovic (OKZP), Dejan Milici (OKZP), Xhavit Mehmeti (FODEM), Agon Perquku (Asambleja Komunale e Vushtrrisë), Boban Bransilav (Shoqëri Civile). Bashkim Kovaqi (Drejtori i shkollës "Bahri Haxha").
Vullnetarët për mbledhjen e të dhënave në terren	Arlinda Halili, Shpëtim Fejka, Albiona Sylja, Samira Demiri, Arjeta Ferizi, Saranda Voca, Agnesa Ismajli, Elda Cecelia, Suela Zymeri, Enes Ballata, Egzon Rama.

## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	12
RRETH AGJENDËS 2030 DHE QËLLIMEVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM.....	13
1. HYRJE.....	15
1.1. PROFILI I KOMUNËS .....	15
1.2. NDËRLIDHJA E OZHQ-VE ME PRIORITETET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT .....	16
1.3. NDIKIMI I PANDEMISË SË COVID-19 DHE PLANI I RIMËKËMBJES SË QËNDRUESHME .....	18
1.4. PROCESI I WL-SË DHE LINJA KOHORE .....	22
2. METODOLOGJIA .....	24
1. Shtylla ekonomike .....	25
2. Shtylla mjedisore.....	25
3. Shtylla sociale.....	25
2.1. MBLEDHJA E TË DHËNAVE PARËSORE DHE DYTËSORE.....	29
3. LOKALIZIMI I OZHQ-VE NË KONTEKSTIN E VUSHTRRISË .....	31
3.1. DIMENSIONI EKONOMIK.....	31
OBJEKTIVI 1 - PA VARFËRI .....	31
OBJEKTIVI 2 – ZERO URI.....	35
OBJEKTIVI 8 – PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE.....	37
3.2. DIMENSIONI MJEDISOR.....	40
OBJEKTIVI 6 – UJË I PASTËR DHE KANALIZIME.....	40
OBJEKTIVI 7 – ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR .....	42
OBJEKTIVI 15 – JETA NË TOKË .....	45
3.3. DIMENSIONI SHOQËROR.....	47
OBJEKTIVI 4 - ARSIM CILËSOR .....	47
OBJEKTIVI 5 - BARAZI GJINORE .....	50
OBJEKTIVI 11 – QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME .....	53
3. REKOMANDIME DHE VEPRIME PAS VLERËSIMIT VULLNETAR LOKAL.....	56
4. SHTOJCAT .....	58

POPULLSIA NË 69.870  
VUSHTRRI  
POPULLSIA URBANE 26.964


DENDËSIA KOMUNALE 202/km<sup>2</sup>

SHKALLA E 55.47%  
PUNËSIMIT (2011)

MADHËSIA MESATARE 5,6  
E FAMILJEVE

KONTIGJENTI I PUNËS 47.88%

E NJOHUR PËR SI QYTETI ME  
TRASHËGIMINË  
KULTURORE MË TË  
VJETËR NË KOSOVË  
KOHA KUR U SHEKULLI I PARË P.K.  
THEMELUA VUSHTRRIA



## FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT



Është kënaqësi e madhe për mua si kryetar i Komunës së Vushtrrisë të shpreh mbështetjen time të plotë për zbatimin e Agjendës 2030 dhe të hap rrugën për matjen e progresit të OZHQ-ve në komunën tonë. Jam krenar që Vushtrria ka vëmendjen dhe mbështetjen e UN-Habitat Kosova, Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Qeverisë së Suedisë për hartimin e Vlerësimit Vullnetar Lokal të parë në Kosovë.

Ky raport pasqyron situatën aktuale dhe përfaqëson përkushtimin tonë për zbatimin e OZHQ-ve në mënyrë që të rrisim mirëqenien e qytetarëve dhe të vendosim zhvillimin e qëndrueshëm në qendër të qeverisjes sonë komunale. Si e tillë, komuna mori masa të menjëhershme për krijimin e një ekipi komunal të planifikimit (EKP) me

anëtarë nga të gjitha departamentet përkatëse (urbanizëm dhe mjedis, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, kulturë, rini dhe sport, financa, arsim, çështje gjinore etj.). EKP-ja ka punuar ngushtë me UN-Habitat në hartimin e këtij raporti dhe ka ofruar të dhëna nga secili sektor.

*"Në mes të përpjekjeve për rimëkëmbjen e COVID-19, OZHQ-të mund të ndihmojnë në përcaktimin e rrugës përpara duke udhëhequr planet e rimëkëmbjes lokale dhe duke përshpejtuar progresin drejt zbatimit të Agjendës."*

Jemi me fat që jemi komuna e parë që përpilon dhe publikon raportin e VVL-së në Kosovë. Ky raport nuk është thjesht një instrument për matjen e progresit tonë të OZHQ-ve deri më sot. Përkundrazi, raporti i VVL-së ka potencialin të jetë një pikë referimi për të integruar më tej OZHQ-të në politikat apo strategjitë e ardhshme të planifikimit, projektet kapitale dhe për identifikimin e sfidave dhe potencialeve tona si komunë. Prandaj, besoj se ky raport do të na shërbejë jashtëzakonisht mirë në politikat dhe strategjitë tona të planifikimit komunal duke i përafuar ato me mjedisin, kërkesat ekonomike dhe sociale. Po ashtu, raporti do të rrisë prezencën e komunës jashtë Kosovës dhe do ta vendos Vushtrrinë në hartën e komunave dhe qyteteve globale që janë të përkushtuara për zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

*"Qëndrueshmëria dhe zhvillimi gjithëpërfshirës janë në qendër të ndryshimeve dhe transformimeve të shpejta në Vushtri".*

Në këtë proces, ne jemi të interesuar të dëgjojmë zërin e të gjithëve. Jam i kënaqur që një qasje gjithëpërfshirëse ku askush nuk mbetet pas është në themelet e partneritetit tonë. Ky proces është një dëshmi se ne me të vërtetë do të konsiderojmë njohuritë e të gjithë aktorëve të përfshirë dhe do t'u japim atyre mundësinë për të zotëruar procesin

Sfidat e paprecedentë dhe vështirësitë financiare të shkaktuara nga pandemia kanë shkaktuar dëme për banorët e Vushtrrisë në të gjitha segmentet e popullsisë. Pandemia ekspozoi varfërinë e përhapur, sistemet e dobëta të kujdesit shëndetësor, mungesën e një sistemi arsimor modern dhe gjithëpërfshirës dhe masat e papërshtatshme të mbrojtjes sociale. Për më tepër, ajo çoi në rritjen e pabarazisë dhe cenueshmërisë, duke minuar progresin shumë vjeçar në zbutjen e varfërisë dhe adresimin e dobësive. Fëmijët nga familjet në nevojë u prekën veçanërisht nga ndërprerja e shkollës dhe kalimi në arsimin online, duke paraqitur një sfidë serioze për arritjen e OZHQ-së 4 (Arsim cilësor). Këta shembuj nxjerrin në pah nevojën urgjente për

veprim dhe përgjigjen tonë kolektive për të përmbushur nevojat themelore të njerëzve, për të mbrojtur planetin tonë dhe për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe më reziliente.

Raporti i WL-së ka përforcuar rëndësinë e punës së bashku me institucionet qendrore dhe shoqërinë civile për të sjellë ndryshime pozitive. Duke pasur parasysh kontekstin e Kosovës si një ekonomi në rritje që po kalon ndryshime të shpejta, kjo VWL shërben si një pikë hyrëse e rëndësishme për të demonstruar mënyrat përmes të cilave Kosova dhe proceset e nivelit lokal mund të përforcojnë reciprokisht njëra-tjetrën për të harmonizuar më mirë planet e raportimit dhe zhvillimit të Kosovës me Agjendën 2030 dhe për të katalizuar kështu burimet, kapacitetet dhe veprimet tona në mbështetje të arritjes së OZHQ-ve.

Përpyekja jonë e përbashkët ka ndihmuar shumë komunitetin në sistemimin e të dhënave dhe krijimin e një baze të dhënave të integruar të treguesve të zhvillimit të qëndrueshëm. Shpresoj që ky të jetë fillimi i një bashkëpunimi afatgjatë në zbatimin e OZHQ-ve deri në arritjen e plotë të tyre në vitin 2030. Zbatimi i kuadrit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm do të thotë përmirësim i mirëqenies dhe cilësisë së jetës së të gjithëve. Në fund të fundit, do të thotë nderim dhe zbatim i misionit të komunave të Kosovës, prandaj jam i nderuar që Komuna e Vushtrrisë është ndër të parat në Kosovë që ka kontribuar dhe udhëhequr rrugën në këtë drejtim.

## FJALËT PËRSHËNDETËSE SË PARTNERËVE

Jam e lumtur të jap kontributin tim në cilësinë e Kryesueses së Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm në këtë hap të rëndësishëm për Komunën e Vushtrrisë, dhe në përgjithësi për Kosovën drejt përbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Këto Objektiva të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara janë një synim global për një jetë më të mirë për të gjithë popujt anë e mbarë globit. Ato sigurojnë gjithëpërfshirje, synojnë eliminim të varfërisë, kujdes shëndetësor më të mirë për të gjithë, ruajtje të planetit tonë, si dhe barazi dhe zhvillim të mëtutjeshëm përmes inovacionit, ekonomisë qarkore dhe solucioneve tjera të qëndrueshme.

Kjo i bën Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm një zotim fisnik dhe moral. Si të tilla, ato vlejné për të gjitha shtetet njëjtë dhe nuk janë kërkesa vetëm për shtetet e pazhvilluara apo në zhvillim. Për këtë arsye të gjitha shtetet pa dallim nga niveli i zhvillimit shoqëror dhe ekonomik i kanë bërë këto Objektiva pjesë të politikave të tyre publike.

Edhe pse nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, Kosova ka qenë aktive dhe ka kontribuar në hartimin e këtyre Objektivave gjatë vitit 2015. Me qindra pjesëmarrës, zyrtar të institucioneve, anëtarë të shoqërisë civile, përfaqësues të bizneseve e të tjerë, janë angazhuar nëpër fokus grupe dhe takime të ndryshme për të dhënë kontributin e tyre në hartimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pra, të gjithë jemi hisedarë të barabartë në përbushjen e tyre.

Prandaj, të gjithë deputetët, ministrat, kryetarët e komunave, aktivistët e shoqërisë civile, afaristët dhe të tjerë duhet t'i përvetësojnë këto Objektiva dhe t'i bëjnë pjesë të përditshme të punës dhe jetës së tyre. Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, si organ koordinues në nivel kombëtar është duke bërë punë të vazhdueshme për të rritur punën e institucioneve dhe duke rritur vetëdijen e zyrtarëve institucional për të përfshirë Objektivat në nivel të

politikave. Është për t'u përshëndetur puna e Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila në procesin e hartimit të Strategjisë Zhvillimore të Kosovës 2022 – 2030 i ka bërë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm udhërrëfyes të këtij procesi.

Mbi të gjitha, janë komunat e Republikës së Kosovës të cilat e kanë një barrë të rëndësishme për përfshirjen dhe përbushjen e këtyre Objektivave. Rreth 60% të tyre bien nën përgjegjësi të nivelit lokal. Afër 100 nga 169 targete që janë udhërrëfyes për përbushjen e 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duhet përbushur nga komunat.

Rrjedhimisht, shpresojmë që puna e nisur nga komuna e Vushtrrisë, dhe disa komunave tjera të cilat kanë bërë lokalizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të shërbejë si shembull i mirë për të gjitha komunat tjera të Republikës së Kosovës. Komunat tjera duhet të vijojnë në hapat e komunës së Vushtrrisë e cila me hartimin e këtij raportit Vlerësimi Vullnetar Lokal që po hap një kapitull të ri për nivelin lokal në Kosovë drejt përbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU

Kryesuese e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm  
Kuvendi i Republikës së Kosovës

NENSHKRIMI

## FJALËT PËRSHËNDETËSE SË PARTNERËVE

Në përputhje me mandatin e UN-Habitat-it për të siguruar një "cilësi më të mirë të jetës për të gjithë në një botë të urbanizuar", UN-Habitat, në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbështeti komunën e Vushtrrisë në zhvillimin e raportit të parë të Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) në Kosovë.

VVL është hapi i parë në procesin e lokalizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në Vushtri/Vuitrn dhe, më gjerë, në Kosovë. VVL-të janë një mundësi për qeveritë vendore që të mbështesin agjendat e tyre të zhvillimit, të angazhojnë aktorë të ndryshëm dhe që qytetet të arrijnë politika gjithëpërfshirëse, transparencë më të madhe dhe të dhëna më të sakta në nivel lokal. VVL-të kanë potencialin për të mobilizuar burimet lokale duke forcuar koordinimin në shumë nivele lokale-kombëtare. Ato ofrojnë dëshmi për vendimmarrësit për të identifikuar boshllëqet e politikave, duke filluar një dialog për zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke lokalizuar OZHQ-të me shoqërinë civile dhe aktorët lokalë së bashku me një koordinim të zgjeruar ndërmjet departamenteve të qeverisë drejt adresimit të prioriteteve të komuniteteve lokale.

Zhvillimi i raporteve të VVL-së në Kosovë udhëhiqet nga tre qëllime kryesore. Qëllimi i parë dhe më i rëndësishëm është angazhimi i Kosovës si palë e interesit në adresimin e sfidave globale ekonomike, sociale dhe mjedisore në nivel lokal. Së dyti, është përmirësimi i ndikimit të kuptuarit të specifikave lokale dhe kombëtare në lidhje me çdo objektiv dhe tregues të OZHQ-ve. Së treti, promovimi i qëndrueshmërisë duke ndërmarrë veprime për arritjen e këtyre objektivave bazuar në treguesit dhe të dhënat e mbledhura në kuadër të OZHQ-ve dhe duke i përfshirë ato në kontekstin e planifikimit urban.

Përfitimet i punës së kryer deri më sot u kanë mundësuar qeverive vendore të monitorojnë dhe vërtetojnë progresin e bërë drejt zbatimit të OZHQ-ve në nivel

lokal dhe përfshirjen e gjetjeve në Planin Zhvillimor Komunal të ardhshëm. Përveç kësaj, ata kanë qenë në gjendje të raportojnë, vërtetojnë dhe gjenerojnë të dhëna, të komunikojnë gjetjet e studimeve të kryera dhe të zhvillojnë veprime të përbashkëta për të adresuar boshllëqet dhe sfidat me homologët kryesorë në të gjitha nivelet.

UN-Habitat beson fuqishëm në rolin e VVL-ve si një përshpejtues i procesit të lokalizimit të OZHQ-ve brenda Dekadës së Veprimit. Analizimi dhe planifikimi në përputhje me nevojat e territorit dhe komuniteteve, si dhe një dialog largpamës me sferën kombëtare dhe ndërkombëtare është mënyra për të zbatuar me sukses OZHQ-të deri në vitin 2030. UN-Habitat do të vazhdojë të mbështesë Vushtrrinë dhe qytetet e tjera në përpjekjet e tyre për të lokalizuar OZHQ-të dhe për të punuar me të gjithë palët e interesit në mbarë Kosovën për ta bërë Agjendën 2030 realitet për të gjithë.

## RONG YANG

U.D., Udhëheqës i Zyrës  
Programi i Kombeve të Bashkuara mbi Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat  
Kosovë)



## PARATHËNIE

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, me 17 Objektivat e saj të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) përfshin një angazhim global për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme në të cilën askush nuk mbetet pas. Ky angazhim njihet rëndësinë e veprimeve transformuese për të përshpejtuar përparimin në krijimin e qyteteve të sigurta, reziliente dhe me cilësi të lartë të jetesës për njerëzit, duke u bërë thirrje udhëheqësve dhe komunitetit që të përfshijnë njerëzit e lënë anash dhe të mbështesin veprimet lokale dhe inovacionin.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së lansoi Dekadën e Veprimit, një mobilizim global për të përshpejtuar zbatimin e OZHQ-ve, dhe identifikoj veprimin lokal si një nga nivelet më të rëndësishme të ndërhyrjes për arritjen e Objektivave. Në raportin e "Agjenda jonë e Përbashkët", u prezantuan Vlerësimet Vullnetare Lokale (VVL) u si një shembull pozitiv i 'gjithëpërfshirjes shumëpalëshe' në praktikë. Lokalizimi i OZHQ-ve i referohet procesit të zbatimit të OZHQ-ve në nivel lokal duke përmirësuar koordinimin ndërmjet niveleve të qeverisjes në përputhje me prioritetet e komuniteteve.

Në këtë proces, VVL-të janë bërë mjet i preferuar për qeveritë lokale dhe rajonale për të monitoruar dhe raportuar mbi arritjet e OZHQ-ve dhe kontributin e tyre në Agjendën 2030. Vlerësimet u mundësojnë qeverive lokale të krijojnë një pamje tërësore dhe koherente të progresit të tyre ekonomik, mjedisor dhe social. Poashtu, ndihmojnë administratat lokale të forcojnë lidhjet me shumë palë të interesuara dhe të nxisin së brendshmi bashkëpunimin ndërmjet departamenteve të ndryshme. Hartimi i VVL-ve kërkon disa hapa dhe ndërveprime me një sërë akterësh lokalë, nga komunitetet lokale, akademja, sektori privat, shoqëria civile dhe OJQ-të. Përtej të qenit një mjet i rëndësishëm raportimi, VVL-të kanë një rol të theksuar në përafrimin dhe zbatimin e OZHQ-ve.

VVL-të mundësojnë integrimin e të vlerësimeve të nivelit lokal në planet kryesore për veprim mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm. E veçanta e VVL-ve qëndron në fleksibilitetin, nuancën dhe njohuritë e synuara që i lejojnë ato të përshtaten me nevojat e komuniteteve. Qeveritë lokale nëpër botë, të angazhuara në procesin e VVL, vlerësojnë diversitetin dhe avokojnë për më shumë hapësira të përbashkëta për të shkëmbyer përvoja mbi sukseset dhe sfidat e identifikuara gjatë procesit. Lëvizja globale VVL po rritet me një ritëm inkurajues, me mbi 100 Vlerësime Vullnetare Lokale të botuara nga disa rajone të botës.




Tre vjet pas miratimit global të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Kuvendi i Kosovës i miratoi një rezolutë mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në vitin 2018, duke e bërë Kosovën të përkushtuar ndaj synimeve globale përmes Agjendës 2030. Në kuadër të Kornizës së OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025, Zyra e UN-Habitat në Kosovë në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka mbështetur Komunën e Vushtrrisë në përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Vullnetar Lokal, i cili nxjerr në pah fushat ku nevojiten veprimet më urgjente dhe u mundëson të marrin pjesë në diskutimin global mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Komuna e Vushtrrisë i bashkohet listës së gjatë të qyteteve, qytetzave dhe rajoneve që janë zotuar për avancimin e zbatimit të OZHQ-ve në nivel lokal. Vlerësimi Vullnetar Lokal i Vushtrrisë I hap rrugë qeverive lokale në Kosovë që të kuptojnë më mirë gjendjen e tyre aktuale në arritjen e Agjendës 2030, nxjerr në pah fushat ku nevojiten veprime më urgjente, dhe i lejon ata t'i bashkohen dialogut global për zhvillimin e qëndrueshëm.

## RRETH AGJENDËS 2030 DHE QËLLIMEVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Në shtator 2015, shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara miratuan Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm<sup>1</sup> si një plan veprimi për njerëzit, planetin, prosperitetin, paqen dhe partneritetet. 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe 169 objektiva u lansuan për të stimuluar veprimin global dhe për të adresuar çështjet urgjente si varfëria, uria, pabarazia dhe ndryshimet klimatike deri në vitin 2030. Këto objektiva hapin rrugën drejt një të ardhmeje më të mirë ku askush nuk do të mbetet pas, duke mbështetur gjithëpërfshirjen dhe drejtësinë për të gjithë. Agjenda 2030 zbatohet për të gjitha vendet dhe ekonomitë në zhvillim njësoj dhe jep konsiderata të barabarta për dimensionet ekonomike, mjedisore dhe sociale.

	Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj		Ulja e pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve
	Fund urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi të të ushqyerit si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme		Bëjini qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezilente dhe të qëndrueshme
	Siguroni jetë të shëndetshme dhe promovoni mirëqenien për të gjithë në të gjitha moshat		Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit
	Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë		Merrni masa urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e tij
	Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat		Ruani dhe përdorni në mënyrë të qëndrueshme oqeanet, detet dhe burimet detare për zhvillim të qëndrueshëm
	Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe shërbimeve sanitare për të gjithë		Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, luftimin e shkretëtirëzimit, për të ndaluar dhe përmbysur degradimin e tokës dhe për të ndaluar humbjen e biodiversitetit
	Sigurimi i aksesit në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë		Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet

<sup>1</sup> <https://sdgs.un.org/2030agenda>

	<p>Nxitja rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë</p>		<p>Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rigjallërimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm</p>
	<p>Ndërtimi i një infrastrukture cilësore, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit</p>		

Qytetet, qeveritë lokale dhe rajonale në mbarë botën po raportojnë për zbatimin e OZHQ-ve. Megjithatë, kontributi i tyre është kritik për gjurmimin zhvillimin dhe lokalizimin e progresit të OZHQ-ve në të gjitha nivelet, përkatësisht Vlerësimet Vullnetare Lokale (VVL). UN-Habitat dhe Qeveritë Lokale të Qyteteve të Bashkuara (UCLG) udhëheqin platformën globale të kërkimit mbi VVL-të<sup>2</sup>, e cila ofron mundësi për mësim, ngritje kapacitetesh dhe angazhim ndërkombëtar.

Nju Jorku ishte qyteti i parë në botë që raportoi mbi progresin e OZHQ-të në Kombet e Bashkuara në 2018. Që atëherë, kjo lëvizje globale është rritur në mënyrë eksponenciale. Më shumë se 100 qytete dhe/ose qeveri lokale i janë bashkuar kësaj nisme për përsheptimin e procesit të lokalizimit të OZHQ-ve, duke përfshirë edhe Komunën e Vushtrisë.

<sup>2</sup> <https://unhabitat.org/topics/voluntary-local-reviews>

## 1. HYRJE

### 1.1. PROFILI I KOMUNËS

E vendosur në rajonin verior të Kosovës, Vushtrria është një vendbanim urban i mesëm me një sipërfaqe totale prej 345 km<sup>2</sup> (ose 3.2% e territorit të Kosovës). Komuna kufizohet me Mitrovicën Jugore (në veri), Podujevën (lindje), Obiliqin (në jug), Drenasin (në jugperëndim) dhe Skenderajn (perëndim). Në vitin 2011, popullsia e Vushtrrisë llogaritet të jetë 104.000 banorë<sup>3</sup>, prej të cilëve mbi 39.000 që jetojnë në zonën urbane dhe më shumë se 60.000 në zonën rurale. Shqiptarët (92%), serbët dhe malazezët (7%) dhe të tjerët (1%) janë etnitë kryesore që gjenden në këtë zonë. Edhe pse këto të dhëna janë të parashikuara në Planin Zhvillimor Komunal, popullsia e llogaritur në bazë në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës është 62,925 banorë<sup>4</sup>, e cila gjithashtu merr parasysh emigrimin dhe lëvizjet e popullsisë. Megjithatë, regjistrimi i ardhshëm i popullsisë do të bëhet pikërisht gjatë vitit 2022-2023 ku do të jepen të dhëna të përditësuara.

Territori i komunës kryesisht ka relief fushor, kodrinor dhe malor, është pjesë përbërëse e maleve të Kopaonikut dhe Çyqavicës. Sa i përket rrejtit të lumit, Sitnica (2912 km<sup>2</sup>) dhe degët e saj, si dhe një pjesë e lumit Llap kalon nëpër territor, duke përfshirë edhe dy lumenj më të vegjël (Trstena dhe Studimja). Vushtrria ka klimë të butë, përkatësisht kontinentale-mesdhetare dhe Evropiane-kontinentale dhe qyteti ndodhet në zemër të rrafshit të Kosovës. Nga njëra anë ka qasje të lehtë në rrugët dhe autostradat kufitare, dhe nga ana tjetër drejt kryeqytetit, e ndajnë vetëm 29 kilometra. Kjo i jep Vushtrrisë një avantazh të jashtëzakonshëm ekonomik. Ekonomia e Vushtrrisë karakterizohet në masën më të madhe me veprimtari tregtare. Nga rreth 5000 biznese<sup>5</sup> që janë të regjistruara si aktive në Vushtrri, vetëm rreth 5% janë biznese prodhuese. Megjithatë, Vushtrria është shtëpia e disa prej kompanive më të rëndësishme prodhuese në mobilie, bujqësi dhe ushqim, si dhe në prodhimin e metaleve. Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, mbi 15.000 ha janë tokë pjellore e punueshme, nga të cilat 6000 ha janë nën sistemin e ujitjes.<sup>6</sup> Edhe pse këto të dhëna parashikohen në Planin e Zhvillimor Komunal, sipërfaqja bujqësore e punueshme e llogaritur, sipas Agjencisë së Statistikave, është 17,505 ha, nga të cilat 1,691 ha janë nën sistemin e ujitjes.<sup>7</sup> Dinamika e zhvillimit të qytetit dhe rritja e subvencioneve bujqësore mund të jetë faktor për këtë variacion të të dhënave.

Vushtrria është e pasur edhe me minerale që paraqesin potencial ekonomik, si zona e Dubovcit me magnez dhe porcelan, zonat e Bivolakut, Zhilivodës, Beçukut, Strovcit dhe Gllavotinit me thëngjill, pastaj Pasoma, Tërllabuqi, Smrekonica dhe Shalja me gurë. Gumnishta dhe Bozhani është i pasur me plumb dhe zink, si dhe Banjska, Gejbishta dhe Gojbula me ujë mineral. Qyteti i Vushtrrisë konsiderohet si më i vjetri në Kosovë dhe ka monumentet më të vjetra kulturore në Kosovë, si Kalaja e qytetit, Ura e Gurit dhe Hamami i Mesjetës, të cilat paraqesin një potencial të jashtëzakonshëm turistik.

<sup>3</sup> Komuna e Vushtrrisë, (2017), Plani Zhvillimor Komunal i Vushtrrisë 2016-2024, f. 41-42, Vushtrri: Kuvendi i Vushtrrisë

<sup>4</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, (2021), Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel komunash 2017 – 2021, Prishtina: ASK

<sup>5</sup> Open Data Kosovo, (2022), Platforma e Bizneseve të Hapura, e disponueshme në <https://biznesetehapura.com/sq>, Prishtina: ODK

<sup>6</sup> Komuna e Vushtrrisë, (2017), Plani Zhvillimor Komunal i Vushtrrisë 2016-2024, Vushtrri: Kuvendi i Vushtrrisë

















<sup>7</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, (2014), Regjistrimi i Bujqësisë, Prishtina: ASK

## 1.2. NDËRLIDHJA E OZHQ-VE ME PRIORITETET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT

Strategjitë dhe programet lokale të Komunës së Vushtrrisë rregullojnë, planifikojnë dhe promovojnë prioritetet dhe objektivat zhvillimore për të gjithë sektorët komunal. Këto strategji dhe programe lokale fokusohen në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe nevojat themelore të tyre, duke ofruar shërbime cilësore dhe përgjithësisht duke u fokusuar në rritjen e mirëqenies dhe zhvillimit të komunës në sektorë të ndryshëm p.sh., strehim, planifikim, mjedis, bujqësi, ekonomi, çështjet sociale etj. Me konsideratë të kujdesshme, të gjithë elementët e paraqitur në këto strategji mund të përkthehen ose të lidhen me OZHQ-të dhe treguesit përkatës, që do të thotë se Komuna e Vushtrrisë vazhdimisht adreson çështjet që kanë të bëjnë me dimensionet sociale, ekonomike dhe mjedisore përmes strukturave dhe masave të nivelit lokal.

Duke pasur parasysh këtë, dokumentet kryesore strategjike të Vushtrrisë, duke përfshirë dokumentet nga niveli qendror që përfshijnë zhvillimin e zonës së Vushtrrisë, janë analizuar tërësisht brenda kornizës së zhvillimit të qëndrueshëm. Të gjitha aktivitetet e parapara brenda fushëveprimit të përmendur janë identifikuar dhe ndërlidhur me secilën OZHQ përkatëse në mënyrë që të kemi një pasqyrë të përgjithshme të progresit të OZHQ-ve në kontekstin e Vushtrrisë. Më saktësisht, korniza e treguesve të OZHQ-ve e zhvilluar në kontekstin e Vushtrrisë është përdorur për të identifikuar lidhjen në mes të OZHQ-ve dhe strategjive dhe planeve të veprimit të parapara në çdo dokument komunal p.sh. PZHK, HZK, VSM, PPQ, etj.

Tabela 1. Ndërlidhjet e OZHQ-ve dhe programeve/strategjive lokale të komunës së Vushtrisë dhe kombëtare

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshme																	
Plani i Veprimit i Planit Zhvillimor Komunal, inc. Vizioni i PZHK-së dhe prioritetet strategjike	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	—	●	●	●
Plani për Rimëkëmbjen Ekonomike të Komunës së Vushtrisë në përgjigje të pandemisë COVID-19	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	—	●	●	—
Draft Harta Zonale Komunale e Vushtrisë dhe Plani i Veprimit 2022 - 2030	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	—	●	—	●
Draft-Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të MZM Vushtrri 2022 – 2030	—	—	—	—	—	●	●	●	●	—	●	●	●	—	●	—	—
Plani Qytetar Pjesëmarrës i Vushtrisë	●	—	—	—	●	●	—	—	●	●	—	●	—	—	—	●	—
Draft-Strategjia Zhvillimore Kombëtare e Kosovës (SKZH) 2030	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	●	—	●	—	—	●	●

PZHK dhe HZK janë dokumente të planifikimit të nivelit lokal të përcaktuar me ligji për një periudhë të caktuar kohore. Kjo e fundit, gjegjësisht HZK Vushtrri është hartuar në bazë të PZHK-së si burim primar (elementi bazë: harta e shfrytëzimit të tokës), dhe duke marrë parasysh si dhe sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të planifikimit në nivel qendror dhe lokal (proces në vazhdim). Kjo do të thotë që të dy dokumentet duhet të jenë plotësuese me njëra-tjetrën në planin dhe vizionimin dhe prioritetet strategjike. Bazuar në këtë, VSM-ja, që është një dokument tjetër i përcaktuar ligjërisht, vlerëson jo vetëm HZK-në, por pjesërisht edhe PZHK-në. Kështu që përfrimi i OZHQ-ve korrespondon me të dy dokumentet, pasi që të gjitha duhet të harmonizohen/ndërlidhen. Për më tepër, HZK dhe Plani i Veprimtë të HZK-së së Vushtrisë duhet të përfshijë më shumë aktivitete në kuadër të OZHQ-së 10 dhe OZHQ-së 16. Gjithashtu, aktivitetet dhe programet apo strategjitë e planifikuara që mund të prezantohen në të ardhmen, duhet të jenë konkrete dhe të demonstrojnë qartë qasjen për uljen e pabarazisë, forcimi i qeverisjes së institucioneve vendore duke nxitur paqen dhe promovuar drejtësinë në të gjitha fushat.

Një dokument tjetër i rëndësishëm në nivel kombëtar është Strategjia Kombëtare për Zhvillim - 2030.<sup>8</sup> Ky dokument i adreson katër (4) shtylla kryesore: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, zhvillimin e barabartë njerëzor, sigurinë dhe sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë. Ndërlidhja e OZHQ-ve, në këtë rast, është kryer duke përdorur informacionin aktual të qasshëm nga faqja zyrtare e ZKM-së, e cila rendit shtyllat dhe objektivat kryesore të kësaj strategjie të re. Duhet të merret parasysh se procesi i hartimit të SKZH është në vazhdim, kështu që ndryshime mund të bëhen ende deri në miratimin e përgjithshëm.<sup>9</sup>

Më tej, është analizuar Plani Komunal për Pjesëmarrje Qytetare i cili shërben si një mjet që të ndihmojë dhe udhëheqë administratën komunale në procesin e përfshirjes strukturore të qytetarëve në vendimmarrje, ky dokument shërben si mjet për zbatimin praktik të teknikave për pjesëmarrjen e qytetarëve, dhe me anë të këtij dokumenti zbatohet OZHQ 9, 10 dhe 16. Posaçërisht, ndikon në arritjen e treguesit 9. C, 10.4 etj., ku fuqizohet dhe promovohet përfshirja sociale, ekonomike dhe politike për të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë dhe aftësive të kufizuara, racës, përkatësisë etnike, origjinës, përkatësisë fetare, gjendjes ekonomike ose ndonjë gjendje tjetër.

Siç vërehet, analiza tregon se komuna e Vushtrisë po bën progres në arritjen e OZHQ-ve dhe po përpiqet për përsosmëri të mëtejshme në qëndrueshmëri. Të gjitha dokumentet kyçe që lidhen me zhvillimin social, mjedisor dhe ekonomik të komunës janë në përputhje me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, ka ende shumë punë për të bërë për të avancuar ose zgjeruar progresin e OZHQ në të gjitha fushat.

### 1.3. NDIKIMI I PANDEMISË SË COVID-19 DHE PLANI I RIMËKËMBJES SË QËNDRUESHME

Pandemia e Covid-19 ka ndikuar rrënjësisht në sektorin shëndetësor, social dhe ekonomik në Kosovë, duke prekur industrinë dhe tregtinë, si dhe shëndetin e popullsisë. Në të gjithë Kosovën është vërejtur rritje e varfërisë, papunësisë, humbje e të ardhurave, pasiguri në punë dhe pabarazi në arsim, si dhe janë shënuar rastet më të larta të pabarazisë gjinore. Në komunën e Vushtrisë janë shënuar 4820 persona dhe kanë vdekur 141 që nga rasti i parë me COVID-19 në mars të vitit 2020. Në përgjigje të koordinimit dhe menaxhimit të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, në përputhje me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Shëndetit Publik, komuna ka themeluar Qendrën Operative Emergjente, dhe ishte komuna e parë në Kosovë që përgatiti planin e rimëkëmbjes. Plani i Rimëkëmbjes Ekonomike nga COVID-19 shpreh qëllimin dhe objektivat e organeve përkatëse të komunës për rimëkëmbjen ekonomike

<sup>8</sup> <https://kryeministri.rks-gov.net/strategjia-kombetare-per-zhvillim-2030/>

<sup>9</sup>Po aty, aksesuar për herë të fundit në korrik 2022.

në dhe pas pandemisë, duke përfshirë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik (komunal) për një periudhë 5-vjeçare. Plani është ndarë në dy objektiva kryesore për rimëkëmbjen ekonomike:

Objektivi i parë është zbutja e ndikimit të pandemisë dhe nxitja e rimëkëmbjes përmes masës së zgjatur deri në vitin 2025. Veprimet kryesore lidhen me masat emergjente si: ndryshime buxhetore, lehtësim taksash, grante për bizneset vendase dhe subvencione në pagat e punëtorëve.

Objektivi i dytë përcaktohet nga projekte dhe programe të pafundme që do të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe projekte zbatimi i të cilave do të mundësonin qëndrueshmëri dhe zhvillim ekonomik. Programet kanë për qëllim menaxhimin publiko-privat dhe funksional; qendra e biznesit, këshilli për zhvillim ekonomik komunal, ofrimi i shërbimeve online, aktivizimi dhe ngritja e kapaciteteve.<sup>10</sup>

Aktivitetet e përfshira në Planin e rimëkëmbjes ekonomike nga COVID-19, komuna fokusohet në projekte/aktivitete të mëdha investive të cilat ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Këto projekte do të sigurojnë ndërtimin e një infrastrukture të nevojshme për zhvillim ekonomik dhe do të gjenerojnë vende të reja të punës për qytetarët Vushtrrias. Plani i rimëkëmbjes ekonomike ndërlidhet me objektivin 8 dhe 9 të Agjendës 2030, për nxitje ekonomike të pandërprerë dhe të qëndrueshme, që mundëson rritje ekonomike përmes modernizimit të teknologjisë dhe inovacionit, dhe ndërtimit të një infrastrukture rezistuese të industrializimit të qëndrueshëm. Vushtria, sipas këtij plani, do të mbështes bizneset vendore dhe ndërkombëtare të lokalizuar në komunë, duke krijuar hapësira përcjellëse, si zona ekonomike në Banjskë, parku rekreativ "Taraxha", etj.

Ndërsa sipas të dhënave të marra nga raporti "Ndikimet socio-ekonomike të Covid-19 në komunat dhe bizneset e Kosovës" i zhvilluar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe UN-Habitat Kosova tregojnë se sfida kryesore në Vushtri ishte përqësimi i situatës ekonomike dhe sociale, rezultat i mbylljes së shumicës së ndërmarrjeve, veçanërisht në sektorin e hotelarisë dhe të ndërtimit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur aktivitetet kryesore të Planit të Rimëkëmbjes Ekonomike nga COVID-19 duke i ndërlidhur me vizionin e Planit Zhvillimor Komunal dhe OZHQ-të përkatëse. Mund të vërehet që OZHQ-të 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 theksohen.

## SFIDAT PËR QASJE NË TREGUN E PUNËS NGA TË RINJTË E VUSHTRRISË

Në Vushtri, mësimi online ka qenë sfidë e madhe për të rinjtë, edhe pse nga komuna janë ofruar iniciativa dhe aktivitete të ndryshme duke realizuar fushata për ngritjen e vetëdijes për përdorimin e shërbimeve online. Gjatë periudhës së pandemisë, shumë aktivitete për të zhvilluar ide për tregun e punës u zhvilluan me prezencë fizike, që e ka minimizuar praninë dhe qasjen e komunitetit dhe për të gjitha këto, qeveria dhe komuna duhet të ofrojnë shërbime publike për të arritur edhe grupe specifike dhe të marginalizuara. Pandemia e COVID-19 ndikoi në përjashtimin digjital të këtyre grupeve specifike, por komuna e Vushtrrisë është duke filluar me një program të aktiviteteve të përdorimit digjital, i cili mundësoj që qyteti t'i përmirësojë shërbimet e tij.

## MASAT LEHTËSUESE PËR TAKSAT KOMUNALE NË NDIHMË TË BIZNESEVE

Pandemia ka ndikuar në grumbullimin e borxheve komunale nga qytetarët e Vushtrrisë. Sipas administratës së qytetit, të ardhurat totale në vitin 2021 nga taksa e pronës dhe të ardhurat nga toka me vlerë arritën në rreth 895 mijë. Por, për vitin 2022, pas periudhës së pandemisë, janë inkasuar 96.63% e tatimit në pronë, që tregon se ka pasur një rritje prej 9% në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Megjithatë, për të lehtësuar gjendjen e rënduar ekonomike të bizneseve dhe të fermerëve Vushtrrias, të shkaktuar nga pandemia Covid-19, komuna propozon heqjen e taksave komunale dhe pagesës së qirasë për pronat e dhëna në shfrytëzim

---

<sup>10</sup> Komuna e Vushtrrisë (2020), Plani i rimëkëmbjes ekonomike dhe plani i aktiviteteve 2020-2025, Vushtri: Asambleja Komunale



dhe shfrytëzimin e hapësirave publike në qytet. Ndikimi i kësaj mase në buxhetin komunal arrin në 100 mijë Euro në të hyra personale, të cilat do të mbesin në buxhetin e bizneseve dhe fermerëve të Vushtrisë.

Tabela 2. Aktivitet kryesore të Planit të rimëkëmbjes ekonomike nga Covid-19 dhe ndërlidhja me PZHK-në dhe OZHQ-të

Tema		Plani Zhvillimor Komunal i Vushtrisë				
		Vushtrria, qyteti antik me trashëgimi të pasur kulturore	Një vend me shumë toka bujqësore, tërheqës dhe dinamik për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit	Një vend me turizëm malor-rekreativ dhe kulturor, në një mjedis të pastër ekologjik	Një vend me potencial të madh të rinjsh të kualifikuar	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (OZHQ)
Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	Hartimi i Planit të ri Zhvillimor Komunal	●	●	●	●	1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15
	Ngrohja e qytetit (gaz, biomasë, diellore) që ndikon në efikasitetin e energjisë me rreth 40% për qytetarët dhe bizneset			●		7, 11
	Impianti i ujërave të zeza që përmirëson lumin Silnica, ruan mjedisin, shëndetin, ul koston e trajtimeve mjekësore si rezultat i ujit të ndotur, nxit zhvillimin e turizmit përgjatë Silnicës.		●	●		6, 11, 13
	Kredi të buta për projekte të mëdha ekonomike/infrastrukturore		●		●	8, 9
	Zhvillimi i turizmit që përfshin Parkun Rekreativ "Taraxha", turizmin malor në zonën e Shalës, subvencionimi i krijimit të hapësirave akomoduese dhe hoteliere;	●		●		6, 11, 13
	Zhvillimi i liqenit akumulator në Sllakoc		●	●		6, 13
	Hartimi i planit për shfrytëzimin e resurseve minerare në Komunën e Vushtrisë		●	●		6, 13


	Instalimi i kapaciteteve të termocentraleve dhe instalimeve të tjera që përdorin burime të rinovueshme të energjisë për të prodhuar energji elektrike			●		6, 11, 13
Rritja e pagave të bizneseve dhe punëdhënësve	Injektimi i 30 milionë eurove në ekonominë vendase në 4 vitet e ardhshme përmes projektit të mbulimit të normës së interesit të kredive.		●		●	8, 9
	Ulje 25% e taksës së pronës për një periudhë 4 vjeçare për qytetarët dhe biznesin vendas si pjesë e lehtësimit të barrës tatimore		●	●	●	8, 9
	Masat e punësimit, në të cilat 2000 të rinj do të trajnohen për t'u bashkuar me tregun e punës në pesë vitet e ardhshme krahas rritjes së punësimit.				●	8,
	Rritja e prodhimit bujqësor vendas me qëllim rritjen e punësimit në zonat rurale duke reduktuar kështu importin e produkteve bujqësore		●		●	8, 9,
	Sigurimi i mbështetjes financiare për punësimin e të rinjve; mbështesin organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera joformale			●	●	8,
	Ofrimi i mbështetjes financiare për projekte dhe iniciativa për përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi				●	5, 8,
	Mbështetja e diasporës përmes aktiviteteve të ndryshme promovuese			●	●	8,
	Racionalizimi i të paktën 30% të shpenzimeve nga kategoria "mallra dhe shërbime" me qëllim të përcaktimit të mbështetjes financiare indirekte për ndërmarjet në nevojë.		●	●	●	8,

#### 1.4. PROCESI I VWL-SË DHE LINJA KOHORE



## 2. METODOLOGJIA

Pavarësisht progresit drejt mbledhjes dhe disponueshmërisë së të dhënave në nivel kombëtar dhe lokal, ende kishte të dhëna të papërpunuara dhe jo të ndara sipas faktorëve socio-demografikë dhe ekonomikë. Në bazë të analizave të bëra, kemi vërejtur se mungesa e të dhënave është veçanërisht e pranishme në nivel lokal. Përballë një problemi të tillë, aplikimi i qasjes së nevojshme për analizën e të dhënave nuk është i mundur, p.sh. analizës së trendeve ku kërkohen seritë kohore të të dhënave, krahasimet e grupeve sipas faktorëve socio-demografikë. Për të analizuar progresin drejt OZHQ-ve në nivel lokal, janë aplikuar qasje të ndryshme metodologjike. Së pari, u zhvillua një kornizë e treguesve për të shërbyer si mjet hulumtimi për disponueshmërinë e të dhënave dytësore në nivelin lokal. Diagrami i mëposhtëm paraqet fazat e zbatuara gjatë hartës së të dhënave nga burimet dytësore, mbledhjes së të dhënave parësore dhe analizës.



Diagrami 1. Procesi i mbledhjes, vërtetimit dhe analizës së të dhënave

Përpara fillimit të punës në grupe, është zhvilluar një kornizë e treguesve për të shërbyer si një mjet që ndihmon palët dhe pjesëmarrësit e punëtorisë të kuptojnë më mirë OZHQ-të dhe të ofrojnë kontribut dhe debat të vlefshëm në mbështetje të OZHQ-ve. Roli kryesor i kornizës së treguesve është të shërbejë si kartë raporti që mat progresin drejt OZHQ-ve në nivel lokal. Për më tepër, ai ndihmon komunitetin lokal që të zbatojë më mirë strategjitë e zhvillimit dhe të ndajë burimet e pakta sipas prioriteteve të tyre. Qëllimi i kornizës së treguesve është gjithashtu të sigurojë llogaridhënien e autoriteteve përgjegjëse për progresin dhe arritjen e OZHQ-ve. Korniza e zhvilluar e treguesve përbëhet nga 16 OZHQ, duke përfshirë OZHQ 14 (Jeta nën ujë). 16 OZHQ-të u grupuan më tej në tre shtylla të qëndrueshmërisë 1) ekonomike 2) mjedisore, 3) sociale.



Diagrami 2. Shtyllat e qëndrueshmërisë

Korniza e rishikuar e OZHQ-ve u miratua nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së në sesionin e saj të 48 -të më 10 mars 2017 dhe përfshin 232 tregues unikë. Korniza e treguesve e zhvilluar së fundi përbëhet nga 128 tregues të cilët janë përshtatur më tej duke marrë parasysh rrethanat e nivelit lokal. Këta tregues u ndanë sipas të ardhurave, gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike, cilado qoftë e zbatueshme dhe e mundshme për shkak të të dhënave jo të plota. Tabelat e mëposhtme (3, 4 dhe 5) paraqesin tregues të 16 qëllimeve sipas shtyllave ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Tabela 3: Qëllimet dhe treguesit që përbëjnë shtyllën ekonomike

Qëllimi /Treguesi	Objektivi 1: Pa varfëri	Objektivi 2: Zero uri	Objektivi 3: Shëndeti dhe mirëqenia e mirë	Objektivi 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike	Objektivi 9: Industria, inovacioni dhe infrastruktura
1	Njerëzit në rrezik të varfërisë së të ardhurave pas transferave sociale	Të rriturit mbipeshë (obezë)	Vdekshmëria foshnjore	Shkalla e papunësisë	Udhëtimet për në punë me transport publik
2	Njerëzit që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët të punës	Ushqim organik i blerë në shkolla mbi totalin e ushqimeve	Shkalla e lindjeve tek adoleshentët	Aksidentet në punë	Ndërmarrjet në industri, ndërtim dhe shërbime
3	Familjet private me prind të vetëm	Kuzhina supë për njerëzit që nuk mund të përballojnë ushqimin	Vdekje në aksidente rrugore	Perceptimi për tregun lokal të punës	Numri i start-up-ëve lokale në raport me madhësinë e popullsisë
4	Familjet në banesa sociale		Duhanpirës të përditshëm në vitin e parë dhe të dytë të shkollës së mesme	Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë	Performanca e transportit të qytetit
5	Njerëz të pastrehë		Vende të kontaminuara	Produktiviteti i punës	
6	Njerëzit në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social				

Tabela 4: Qëllimet dhe treguesit që përbëjnë shtyllën mjedisore

Qëllimi /Treguesi	Objektivi 6: Uji i pastër dhe kanalizimi	Objektivi 7: Energji e përballueshme dhe e pastër	Objektivi 12: Konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm	Objektivi 13: Veprimi klimatik	Objektivi 15: Jeta në tokë
1	Ujërat e zeza të trajtohen në mënyrë të sigurt	Ndërtesa të reja	Norma lokale e riciklimit	Njerëzit e prekur nga fatkeqësitë	Gjelbërimi urban
2	Konsumi i ujit të pijshëm	Potenciali teknik fotovoltaik	Mbetjet Urbane për frymë	Emetimet e gazit të gjelbër	Braktisja e tokës
3	Uji i ricikluar i përdorur për hapësira të hapura (për pastrimin e rrugëve të qytetit, zonën publike urbane)	Konsumi i energjisë – kWh në vit për frymë	Ndotësit e çliruar nga objektet industriale	Rreziku nga përmbytjet urbane	Dendësia e mbulesës së pemës
4	Indeksi i qytetit blu	Indeksi i Konsumit të Energjisë	Intensiteti i turizmit lokal	Cenueshmëria nga nxehtësia	
5			Gjurma e konsumatorit	Strategjitë lokale për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë	



Tabela 5: Qëllimet dhe treguesit që përbëjnë shtyllën sociale

Objektivi/Treguesi	Objektivi 10: Pabarazitë e reduktuara	Objektivi 4: Arsimit cilësor	Objektivi 5: Barazia Gjinore	Objektivi 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme	Objektivi 16: Paqja, drejtësia dhe institucione të forta	Objektivi 17: Partneritetet për qëllimet
1	Indeksi GINI	Fëmijët në kujdesin ditor	Hendeku gjinor i punësimit	Norma e kostos së banesave	Vrasje dhe vdekje të dhunshme	Remitancat si përqindje e PBB-së
2	Personat e papunë me aftësi të kufizuara	Të rriturit me arsim më të ulët se fillor dhe të mesëm të ulët	Kënaqshmëria mesatare me jetën sipas identitetit seksual për fëmijët 15 vjeç	Trafiku i biçikletave	Niveli i besimit ndaj njerëzve të tjerë	Treguesit VLR nga statistikat zyrtare
3	Të diplomuar sipas fushës dhe gjinisë	Studentët në arsimin e lartë sipas gjinisë	Ankesa formale për episode të dhunës ndaj grave	Qasja në transportin publik	Niveli i kënaqësisë në lidhje me shërbimet administrative në qytet	
4	Popullsia me prejardhje migrante	Studentë që nuk flasin amtare	Shtrimi në spital i një gruaje për sulm	Sipërfaqja e ndërtuar për frymë	Transparenca e administratës publike	
5	Diskriminimi dhe urrejtja		Vendet e mbajtura nga gratë në pushtetin komunal – të dhëna administrative	Popullsia pa sipërfaqe të gjelbra në lagjet e tyre	Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet komunale	
				Popullsia e ekspozuar ndaj përqendrimit të NO2 Indeksi C3	Buxheti me pjesëmarrje komunale	

## 2.1. MBLEDHJA E TË DHËNAVE PARËSORE DHE DYTËSORE

Burime kryesore të të dhënave dytësore ishin kryesisht Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe komuna e Vushtrisë. Shumica e të dhënave të disponueshme nga ASK-ja janë të grumbulluara në nivel kombëtar, ndërsa disponueshmëria e të dhënave nga komuna është më e ultë.

Përveç të dhënave të mbledhura nga ASK-ja dhe komuna e Vushtrisë, diskutimi në fokus grupe gjatë punëtorisë së parë ishin një burim tjetër i të dhënave të nevojshme për vlerësimin e progresit të OZHQ-ve. Pas prezantimit të kornizës së treguesve, pjesëmarrësit u ndanë në dy (2) grupe dhe iu kërkua të kryenin detyrat përmes diskutimeve në grup. Të dy grupet ishin të përziera në varësi të ndërlidhjes së të dhënave të nevojshme për secilin objekt. Grupeve iu kërkua të ndajnë të dhëna mbi kornizën e treguesve dhe të diskutojnë tendencat, sfidat dhe boshllëqet së të dhënat të nevojshme për proceset e vlerësimit lokal, projektimin dhe angazhimin e palëve të interesuara, mësimet e nxjerra në proceset e vlerësimit dhe nevojat për mbështetje të mëtejshme.

Secilit pjesëmarrës iu kërkua të vlerësonte treguesit në një shkallë LIKERT nga 1 deri në 5, ku 1 tregonte nëse pjesëmarrësi e konsideronte se një tregues ishte '*aspak të rëndësishëm*' për kushtet në nivelin lokal dhe 5 tregonte në '*shumë të rëndësishëm*'. Përveç kësaj, pjesëmarrësve iu kërkua të jepin shifra sa herë që është e mundur për të gjithë treguesit e përfshirë në kornizë dhe nga këndvështrimi i tyre të shprehin tendencën për secilin tregues si pozitiv, negativ ose të ndenjtur. Përzgjedhja e OZHQ-ve për të punuar më tej, u bazua në rezultatet e dhëna nga antarët e grupeve të punës. Gjithsej 17 pyetësorë u plotësuan në nivel të kënaqshëm dhe u përfshinë në analizën statistikore. Së pari, një funksion linear pikëzimit është përdorur për të llogaritur pikët për secilin tregues të 16 OZHQ-ve dhe së dyti, analiza e komponentit kryesor (PCA) është përdorur si metodë për të marrë faktorët e ngarkimit për secilin tregues i cili bazohet në pragjet (1-5) të vendosura në pyetësor. Së fundi, vlerat e fituara nëpërmjet funksionit të pikëzimit linear dhe faktorëve të ngarkimit nga PCA u integruan në Indeksin OZHQ-ve. OZHQ-të që kishin vlerë më të madhe të indeksit prej 0.6 u mbajtën për monitorim të mëtejshëm të progresit të VWL-së.

Në përgjithësi, OZHQ-të e përfshira në shtyllën ekonomike vlerësohen shumë nga pjesëmarrësit, me përjashtim të OZHQ 3 (shëndeti i mirë dhe mirëqenie) dhe OZHQ 9 (industri, inovacion dhe infrastrukturë). Vlera mesatare e indekseve për OZHQ 1, OZHQ 2 dhe OZHQ 8 ishte më e lartë se 0.70<sup>11</sup>. Vlera mesatare e indekseve për OZHQ 3 dhe OZHQ 9 u vërtetua të jetë statistikisht e ndryshme nga vlera mesatare e indekseve për OZHQ 1, OZHQ 2 dhe OZHQ 8. Nga OZHQ 5 që përbëjnë shtyllën mjedisore, pas vlerësimit dhe priorizimit nga fokus grupi, OZHQ 4 (OZHQ 6, OZHQ 7, OZHQ 12, OZHQ 15) mbetën në listë për analiza të mëtejshme. Qasje e ngjashme është përdorur për vlerësimin dhe përzgjedhjen e OZHQ-ve që përpilojnë shtyllën mjedisore. Në këtë shtyllë OZHQ 4, OZHQ dhe OZHQ 11 kishin vlerën më të lartë të indeksit të vlerësuar dhe për këtë arsye u mbajtën në grupin e të dhënave për vlerësim dhe analizë të mëtejshme.

Pas hartëzimit të të dhënave nga burime dytësore, u duk qartë se për shumë tregues të kornizës së ndërtuar nuk kishte të dhëna të disponueshme. Për të vlerësuar progresin në këta tregues dhe për të pasur një vlerësim më gjithëpërfshirës të OZHQ-ve të përzgjedhura, është zhvilluar një instrument hulumtimi dhe janë zhvilluar intervista me banorët e komunës së Vushtrisë. Instrumenti i strukturuar (pyetësori) përmbante 41 pyetje, duke mbuluar të gjitha të dhënat që mungonin nga burimet dytësore. Madhësia e llogaritit e mostrës që siguroi përfaqësim të mirë të njerëzve që jetojnë në Vushtri, u caktua në 420 intervista hulumtuese. Madhësia e

---

<sup>11</sup>Një indeks mund të marrë vlerën nga minimumi 0 deri në maksimum 1. OZHQ-të me një indeks afër 1 tregojnë se ai është konsideruar shumë i rëndësishëm nga këndvështrimi i pjesëmarrësve.

përgjithshme e mostrës prej 420 është shtresuar në përputhje në 42 nga 65 vendbanimet e Vushtrisë të listuara nga ASK-ja. Hulumtimi në terren është zbatuar nga nxënësit e shkollës së mesme së ultë “Bahri Haxha” të cilët më parë janë trajnuar nga eksperti i të dhënave për mënyrën e realizimit të intervistës dhe sigurimin e cilësisë së mirë të të dhënave. Gjithsej 10 studentë u përfshinë në hulumtimin intervistues në terren dhe periudha kohore e zbatimit të anketës ishte prill-maj 2022. Të dhënat e mbledhura janë future, vërtetuar dhe analizuar duke përdorur Softuerin Statistikor për Shkenca Sociale (SPSS). Shpërndarjet e frekuencës, statistikave përshkruese dhe testet për varësinë dhe dallimet p.sh. T-testet dhe testi Chi-sqaure u përdorën për të parë nëse ka dallime statistikisht domethënëse për treguesit e OZHQ-ve midis grupeve të ndryshme socio-demografike. Të dhënat e mbledhura nga hulumtimi u diskutuan dhe u konfirmuan më tej nga fokus grupet pjesëmarrëse në punëtorinë e dytë. Të gjitha shënimet dhe komentet e marra nga pjesëmarrësit në punëtorinë e dytë u analizuan më tej dhe të dhënat u përshtatën sipas sugjerimeve të fokus grupeve. Në fazën përfundimtare, grupi i të dhënave për disa prej treguesve u plotësua nga të dhëna shtesë nga Sistemi i Menaxhimit të Performancës (PMS) i komunës së Vushtrrisë.

## 3. LOKALIZIMI I OZHQ-VE NË KONTEKSTIN E VUSHTRRIË

### 3.1. DIMENSIONI EKONOMIK

#### OBJEKTIVI 1 - PA VARFËRI

---

**OZHQ 1 – PA VARFËRI** synon t'i japë fund varfërisë në të gjitha format e saj deri në vitin 2030. Caqet e përcaktuara në këtë objektivë përfshijnë garantimin për qasje në nevojat bazë si ushqimi dhe strehimi për të gjithë njerëzit, si dhe përfshijnë masa më gjithëpërfshirëse si promovimi i përfshirjes financiare dhe sigurimi i mbrojtjes sociale. Ndonëse ka pasur përparim viteve të fundit në uljen e nivelit të varfërisë globale, ende ka shumë punë për të bërë. Sa i përket Objektivit 1 të Zhvillimit të Qëndrueshëm për t'i dhënë fund varfërisë kudo, është e qartë se komunat luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e tij. Një mënyrë përmes së cilës komunat mund të ndihmojnë është investimi në rrjetet e sigurimeve shoqërore. Këto rrjete sigurie mund të parandalojnë grupet më të cenuara nga rënia në varfëri siç janë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e vetëm. Për më tepër, komunat mund të punojnë në krijimin ose përmirësimin e qasjes në shërbimet thelbësore si arsimi, shëndetësia dhe ndihmat ushqimore. Duke vepruar kështu, komunat mund të ndihmojnë në nivelimin e fushës së lojës dhe t'u japin të gjithëve mundësi të barabarta për të arritur potencialin e tyre të plotë. Në fund, komunat mund të avokojnë për politika në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar që mbështesin zhdukjen e varfërisë. Pra, ka mënyra të shumta përmes së cilave komunat mund të ndihmojnë në arritjen e OZHQ 1. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij objektiv, është thelbësore që komunat të pamundurën për të mbështetur zbatimin e tij.

#### OZHQ 1 NË KONTEKSTIN LOKAL

Komuna e Vushtrisë ka punuar në luftimin e varfërisë duke ofruar skema mbështetëse për grupet e cenueshme, duke financuar programin e banimit dhe duke promovuar solidaritetin mes banorëve të saj. Komuna e Vushtrisë ka kohë që është e përkushtuar për luftimin e varfërisë brenda kufijve të saj. Nismat për mbështetjen e këtyre grupeve dhe zbatimin e skemave kanë ardhur si nga ana e komunës ashtu edhe nga niveli qendror. Këto nisma kanë pasur ndikim të rëndësishëm në nivelet e varfërisë në Vushtri, duke e renditur atë mes komunave lidere në luftën kundër varfërisë në Kosovë. Megjithatë, ka ende shumë punë për të bërë. Komuna po vazhdon të investojë në skema mbështetëse për grupet e cenueshme, si dhe po punon për të rritur ndërgjegjësimin rreth çështjeve që lidhen me varfërinë. Me përkushtim të vazhdueshëm për luftimin e varfërisë, Komuna e Vushtrisë synon të bëjë ndryshimin tek të gjithë personat apo familjet në nevojë.

Komuna e Vushtrisë është një nga komunat me shtrirjen më të gjerë të asistencës sociale për familjet në nevojë. Komuna e ka përcaktuar luftën kundër niveleve të larta të varfërisë në Planin Zhvillimor Komunal të tanishëm dhe në përkufizimin e vizionit të saj për një komunë "me potencial të madh të popullsisë së re dhe të kualifikuar"<sup>12</sup>. Sipas këtij vizioni, Komuna është duke punuar me nivelin qendror por edhe me donatorë të jashtëm në përmbushjen e Objektivit 1 të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

---

<sup>12</sup> Plani Zhvillimor Komunal 2016 – 2024, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, 04.05.2017

Sipas të gjeturave të pyetësorit, 12% e të anketuarve janë përgjigjur se në familjen e tyre kanë të paktën një anëtar me intensitet shumë të ulët pune, që punojnë më pak se tetë orë në javë. Intensiteti i ulët i punës mund të ketë një sërë pasojash negative për familjet, përfshirë rritjen e stresit financiar dhe uljen e lëvizshmërisë sociale. Gjithashtu, mund të ndikojë në rezultate të dobëta shëndetësore, pasi që anëtarët e familjeve me intensitet të ulët të punës kanë më shumë gjasa të përjetojnë stres kronik dhe probleme të shëndetit mendor. Për më tepër, oraret e punës me intensitet të ulët e vështirësojnë për prindërit balancimin e përgjegjësive të punës dhe të rritjes së fëmijëve. Testi statistikor ka vërtetuar se numri i anëtarëve të familjes me intensitet shumë të ulët të punës është dukshëm më i lartë në zonat urbane (70%) krahasuar me ato rurale. Megjithatë, nuk është vënë re asnjë dallim domethënës midis meshkujve dhe femrave apo nivelit arsimor të tyre sa i përket intensitetit të punës.

Për periudhën kohore 2017-2022, komuna ka ndihmuar 25 familje në qytet prej të cilave 8 banojnë në banesa sociale dhe 17 prej tyre me qira private, me qira të paguar nga skema e mbështetjes sociale. Ky është një grup i cenushtëm i njerëzve që janë në rrezik të mbeten të pastrehë ose që nuk mund të përballojnë qiranë e tyre. Komuna po i ndihmon këto familje me asistencë financiare ndërkohë që kërkon mënyra për t'i nxjerrë këto familje nga ky status. Ndër tjerash, komuna po ofron mbështetje edhe për ata që kërkojnë punësim dhe trajnim, në mënyrë që të gjejnë punë dhe të bëhen të vetë-mjaftueshëm/pavarur. Kjo ndihmë është jetike për këto familje dhe po ndihmon në uljen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në qytet.

Të gjeturat nga pyetësori tregojnë se 12% e të anketuarve kanë deklaruar se jetojnë në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social, në raport me 88% të familjeve që nuk përbëjnë të njëjtin rrezik. Hulumtimi po ashtu tregon se trendi i familjeve me asistencë sociale ka shënuar rënie të lehtë gjatë periudhës 2017-2020, por me një rritje pas vitit 2020, gjë që është ndikuar nga pandemia Covid-19. Rritja e numrit të kërkesave për asistencë sociale mund të lidhet edhe me faktin se më shumë familje marrin pjesë në fuqinë punëtore dhe se gjatë pandemisë është ulur aktiviteti ekonomik.


Rezultatet e pyetësorit, ndër tjerash, vërtetojnë varësi statistikore të konsiderueshme midis arsimit dhe të ardhurave. Me këtë mund të themi se familjet me edukim më të lartë priren të kenë të ardhura më të larta dhe kanë më pak gjasa të ekspozohen ndaj rrezikut të varfërisë dhe përjashtimit social. Përveç kësaj, komuna ka zbatuar politika të ndryshme për t'i ndihmuar familjet t'i shpëtojnë varfërisë dhe përjashtimit social. Këto politika përfshijnë vendimin e Kuvendit Komunal nr. 47/20 për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur<sup>13</sup>, Vendimin për subvencionimin e interesit për kreditë bujqësore, më pas vendimin për subvencionimin e trajnimeve të rinjve dhe mbështetjen e startup-eve. etj.

Më tej, të gjeturat e pyetësorit tregojnë se 37% e të anketuarve (të punësuar) janë deklaruar se kanë të ardhura prej 300 euro ose më pak në muaj. Kjo shumë rezulton e ulët në raport me shpenzimet mesatare mujore të familjes në nivel kombëtar që sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës ishin afër 650 euro.<sup>14</sup> Banorët e Vushtrrisë, megjithatë, kanë një shumë të konsiderueshme të të hyrave nga remitancat dhe aktivitetet bujqësore që i shtohen buxhetit familjar. Ndonëse kjo mund të duket si një shumë relativisht e vogël parash, është e rëndësishme të theksohet se një numër i konsiderueshëm i banorëve punojnë edhe në bujqësi, janë të vetëpunësuar ose janë të angazhuar në biznese familjare dhe marrin remitanca nga jashtë. Nga vlerësimi i të dhënave të pyetësorit të realizuar në terren del se rreth 40% e të anketuarve kanë një anëtar të familjes që jeton dhe punon jashtë vendit. Përqindja e familjeve që kanë një anëtar të familjes jashtë vendit duket të jetë


<sup>13</sup> <https://kk.rks-gov.net/vushtri/wp-content/uploads/sites/33/2020/09/vendimi-per-femijet-e-porsalindur.pdf>

<sup>14</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022), Statistikat e Mirëqenies Sociale, Prishtinë

më e lartë në zonat rurale, ndërsa frekuenca më e lartë e shumës vjetore të remitancave për familje është vlerësuar të jetë 1200 euro. Si rezultat, edhe pse mund të mos kenë shumë të ardhura të disponueshme, ata janë ende në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre themelore.



Diagrami 3. Numri i familjeve me asistencë sociale, Komuna e Vushtrisë



Diagrami 4. Numri i anëtarëve të familjes që përfitojnë nga skema e ndihmës sociale në Vushtri. Burimi: Agjencia e statistikave të Kosovës.

Derisa përqindja e njerëzve që fitojnë 300 euro ose më pak ofron një pasqyrë të vlefshme për situatën ekonomike të familjeve me të ardhura të ulëta në komunë, është e rëndësishme të merren parasysh kufizimet e pyetësorit. Sipas gjetjeve të pyetësorit, mund të vërehet se 37% e të anketuarve dhe anëtarët e familjes së tyre kanë në dispozicion 2 Euro/ditë (300 Euro/5 anëtarë të familjes = 60 Euro/anëtar të familjes; 60 Euro/30 ditë = 2 Euro). Lidhur me këtë, të gjeturat e pyetësorit nuk japin informacione mbi burime të tjera të ardhurash siç janë përfitimet e qeverisë ose donacionet nga anëtarët e familjes apo rrethi i ngushtë, përveç disa

informacioneve të përafërta të hyrjeve të remitancave. Si rezultat, situata e vërtetë ekonomike e këtyre familjeve ka gjasa të jetë më komplekse sesa sugjerojnë këto të gjeturave. Megjithatë, gjetjet e pyetësorit nxjerrin në pah nevojën për politika dhe programe që mund të ndihmojnë në adresimin e sfidave ekonomike me të cilat përballen familjet me të ardhura të ulëta në komunë. Një ndërlidhje e politikave të tatimit në pronë, programeve komunale në fushën e bujqësisë, promovimit të aktiviteteve ekonomike lokale është e nevojshme që puna dhe punësimi t'i japin fund varfërisë në Komunën e Vushtrrisë.

Vlerësohet se 12% e njerëzve në Vushtrri mbulohen nga politikat e mbrojtjes sociale. Kjo përlogaritje bazohet në raportin e gjithsej familjeve në komunë në vitin 2011<sup>15</sup>, i cili ishte 11,866. Nga ato familje, 1,464 apo 12.3% kanë qenë të mbuluara me politika të mbrojtjes sociale në vitin 2022. Komuna po punon uljen e këtij numri dhe në ngritjen e nivelit të jetesës së këtyre familjeve duke zbatuar politika dhe programe të reja si programi për pagesat për të sapolindurit, për subvencionimin e interesave të kredisë për fermerët, vendimin për lirim nga pagesat komunale për familjet në nevojë, etj. që të sigurojë mbrojtje sociale për më shumë banorë.

Komuna ka marrë iniciativën në rritjen e qasjes në mbrojtje sociale për banorët e saj. Ndër, komuna ka bashkëpunuar edhe me fondacione humanitare për të luftuar varfërinë, më saktësisht ka nënshkruar marrëveshje për .<sup>16</sup> sigurimin e banimit apo shtëpive të reja për familjet në nevojë. Falë kësaj, dhjetëra familje u zhvendosën në shtëpi të reja, dhe përvec se kjo tregon progres në luftën kundër varfërisë, kjo poashtu përkon me përpjekjet e komunës për të mbështetur politikat në sektorë të tjerë si arsimit, shëndetësia etj.

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 1 – PA VARFËRI

Në mënyrë që Komuna e Vushtrrisë t'i nxjerrë banorët e saj nga varfëria dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, komuna do të:

- Angazhohet për ndërlidhjen e politikave të brendshme vendore me të ardhurat familjare, duke inkurajuar veçanërisht familjet me intensitet të ulët pune.
- Ofrojë një skemë dinamike të mbrojtjes sociale përmes programeve që mundësojnë dhe rrisin punësimin e personave me të ardhura të ulëta.
- Alokojë një kuotë vjetore për programin e ndërtimit të shtëpive për familjet në nevojë.
- Vushtrria është e përkushtuar në rritjen e bashkëpunimit me nivelin qendror, donatorët, shoqërinë civile dhe akterët tjerë për të luftuar varfërinë, duke mbështetur familjet me të ardhura të ulëta dhe intensitet të ulët të punësimit. Komuna është e vendosur të përdorë skemat e mbrojtjes sociale dhe politikat fiskale lokale për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

---

15 ASK (2011), Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës, gjinisë dhe komunës 2011, e disponueshme në [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_Census%20population\\_Census%202011\\_3%20By%20Municipalities/tab%2005%2016.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Census%20population_Census%202011_3%20By%20Municipalities/tab%2005%2016.px/table/tableViewLayout1/)

<sup>16</sup>Faqja zyrtare e Komunës së Vushtrrisë, e disponueshme në <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/news/jave-e-mbare-per-vushtrrine/>

## OBJEKTIVI 2 – ZERO URI

---

**OZHQ 2 – ZERO URI** ofron kornizën për luftimin e urisë në nivel ndërkombëtar, përkatësisht, përcakton caqet dhe treguesit për t'i dhënë fund urisë, për arritjen e sigurisë ushqimore dhe përmirësimin e të ushqyerit, si dhe për promovimin e bujqësisë së qëndrueshme; ndërlidhja e këtyre çështjeve bën që kjo objektive të jetë gjithëpërfshirëse dhe ambicioze për t'u realizuar. Kjo objektive po ashtu trajton shkaqet rrënjësore të urisë dhe kequshqyerjes, përfshirë varfërinë, konfliktin, ndryshimet klimatike dhe pabarazitë. Për t'i dhënë fund urisë dhe për të arritur siguri ushqimore deri në vitin 2030, OZHQ 2 bën thirrje për rritjen e investimeve në prodhuesit e ushqimeve në shkallë të vogël, në gratë fermere dhe në zhvillimin rural. Ndër tjerash, OZHQ 2 shpalos nevojën për modele të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, duke përfshirë zvogëlimin e mbetjeve ushqimore. OZHQ 2 vlerësohet si një plan për luftimin e urisë në nivel global dhe synon qasjen në ushqim të sigurtë dhe të mjaftueshëm për të gjithë, duke mos lënë askënd prapa.

### OZHQ 2 NË KONTEKSTIN LOKAL

Ashtu si në komunat tjera, Vushtrria ka një nivel të pakënaqshëm të të dhënave sa i përket obezitetit, sigurisë ushqimore etj., dhe ka më shumë informacion sa i përket të dhënave nga sektori i bujqësisë. Të dhënat në përgjithësi, si dhe ato të disagreguara sipas gjinisë, vendndodhjes, arsimit, janë problemet kryesore që duhet të adresohen nga komuna për të vlerësuar më mirë gjendjen reale dhe nevojat e popullsisë së Vushtrrisë. Komuna duhet të punojë për mbledhjen e të dhënave më të besueshme dhe më të plota që do të ndihmojnë në krijimin e një pasqyre më të hollësishme dhe më të saktë të gjendjes ushqimore dhe shëndetësore të banorëve, si dhe llojin e dietës së tyre. Gjithashtu, komuna duhet të përpiqet të rrisë vetëdijen e banorëve rreth ushqimit apo konsumit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, përfshirë mënyrën e jetesës së shëndetshme, në mënyrë që të parandalohet obeziteti dhe problemet e tjera shëndetësore.

Sipas të gjeturave të pyetësorit, 33% e të anketuarve janë përgjigjur që obeziteti (mbipësia) është prezent në familjet e tyre. Këto të gjetura nuk tregojnë ndryshime të konsiderueshme të nivelit të mbipeshës midis zonës rurale dhe urbane, midis meshkujve dhe femrave, apo edhe midis niveleve të ndryshme të arsimit Megjithatë, niveli i mbipeshës është provuar statistikisht të jetë i varur nga të ardhurat e familjes. Lidhur me këtë, rezultatet e pyetësorit treguan se familjet që i përkasin kategorisë së të ardhurave deri në 300 dhe 301-600 euro në muaj kishin numër më të madh të anëtarëve të familjes mbipeshë. Të ardhurat dhe niveli i mbipeshës kanë korrelacion negativ, duke treguar se me rritjen e të ardhurave, numri i mbipeshës së anëtarëve të familjes zvogëlohet. Kjo do të thotë se njerëzit me të ardhura më të ulëta janë më të prekshëm ndaj mbipeshës pasi kushtet materiale përcaktojnë qasjen e tyre në ushqim të shëndetshëm, sjelljen shëndetësore si mënyrën e të ushqyerit dhe aktivitetin fizik, duke përfshirë kontrollin mbi jetën, stresin dhe pasiguritë. Përveç kësaj, mund të ketë shpjegime të tjera për këtë trend, ndër to supozimi se mesatarja e të rriturve në Vushtrri tani konsumon më shumë kalori sesa 10 vjet më parë. Kjo ka të ngjarë për shkak të rritjes së disponueshmërisë të ushqimeve të përpunuara dhe të shpejta. Për më tepër, mënyrat e jetesës joaktive po bëhen më të zakonshme, pasi punët e përditshme janë përgjithësisht të bazuara në zyrë, duke përdorur pajisje elektronike për komunikim dhe punë. Si përfundim, shkalla e obezitetit është rritur në nivel global gjatë viteve të fundit dhe sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë është trefishuar që nga viti 1975; rrjedhimisht, as Vushtrria nuk bën përjashtim.



Një gjetje tjetër nga pyetëtori tregon se 12% e të anketuarve kanë raportuar pasiguri të rëndë ushqimore. Kjo shifër është informacion mjaft i ri që vjen nga analiza e pyetësorit, por mund të jetë një fillim i mirë për të përditësuar këtë çështje dhe për të identifikuar njerëzit që po përjetojnë pasiguri ushqimore. Për më tepër, kjo do të shërbejë si një bazë e mirë informacioni për të marrë në konsideratë politikat publike që promovojnë prodhim të qëndrueshëm vendor dhe politika që synojnë mbrojtjen e shëndetit të popullsisë duke arritur vlerat e nevojshme ushqyese. Kjo çështje është me prioritet të lartë për t'u trajtuar dhe kërkon veprime më të shpejta për të ulur nivelin e pasigurisë ushqimore në Vushtri. Arsyet kryesore për gjendjen e krijuar janë rritja çmimeve ushqimore për shkak të inflacionit, si dhe rritja e nivelit të papunësisë për shkak të COVID-19; kjo do të thotë se shumë familje nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të blerë ushqime. Një tjetër faktor që vlerësohet të ketë pasur ndikim në sigurinë ushqimore të konsumatorëve është konflikti i fundit mes Rusisë dhe Ukrainës duke marrë parasysh faktin se të dy vendet konsiderohen fuqi të prodhimit bujqësor.

Sipas të gjeturave të pyetësorit, rreth 70% e të anketuarve janë përgjigjur se posedojnë sipërfaqe bujqësore nën prodhim, ndërsa të ardhurat mesatare vjetore bruto të prodhuesve bujqësorë janë 13,000 euro në vit.<sup>17</sup> Në nivel lokal, prodhimi bujqësor mesatar është 25 ton/ha. Kjo shifër përfshin si fermerët në shkallë të vogël ashtu edhe operacionet tregtare në shkallë të gjerë. Është e rëndësishme të theksohet se ky numër ndryshon ndjeshëm brenda mostrave të anketuara në varësi të madhësisë së fermës, vendndodhjes dhe mjeteve të prodhimit.<sup>18</sup>

Spektori i blegtorisë është një nga sektorët më tradicionalë të prodhimit në Vushtri. Të dhënat e vitit 2020 tregojnë se 78 fermerë kanë 838 lopë dhe kanë prodhuar mbi 1.3 milionë litra qumësht.<sup>19</sup> Niveli vendor i prodhimit luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, andaj edhe qeveria ofron subvencione dhe programe të ndryshme për të mbështetur këtë sektor. Sektori është shumë i rëndësishëm për komunitetin lokal dhe ofron punësim për shumë njerëz, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë. Për më tepër, vitet e fundit ka pasur rritje të interesit nga kompanitë private për investime në këtë sektor. Ndër produktet më të rëndësishme të këtij sektori në Vushtri cilësohen prodhimi i qumështit dhe patatja (mbi 22 ton në vit).<sup>20</sup> Në kuadër të prodhimit bimor, po ashtu kultivohen kultura të tjera siguri, misri, perimet dhe kulturat foragjere. Vlen të përmendet se Vushtria, traditën e saj të gjatë në prodhimin e patates e ka shoqëruar me farëra të cilësisë së lartë të importuara kryesisht nga Holanda, me infrastrukturë të përshtatshme duke përfshirë teknologjinë dhe furnizimin me ujë nga kompania Iber-Lepenc<sup>21</sup>. Si rezultat, fermerët në Vushtri janë në gjendje të kenë rendimente të larta (20 ton/ha<sup>22</sup>) të patates të cilat janë të krahasueshme me nivelin mesatar Evropian. Patatja është një nga kulturat e pakta ku plotësohet vetë-mjaftueshmëria në nivel kombëtar (103.2%).

Qeveria po punon për zhvillimin e infrastrukturës dhe ofron programe të ndryshme për të mbështetur sektorin e bujqësisë. Krahas skemave mbështetëse (pagesat direkte dhe grantet e zhvillimit rural) të zbatuara nga niveli qendror për nivelin lokal, komuna në periudhën 2018-2020 ka mbështetur fermerët vendas me 235 sera, 88 makina mjelëse, 30 mulliri, dhe një shumëllojshmëri pajisjesh të tjera.<sup>23</sup> Kjo mund të ketë pasur ndikim pozitiv në prodhimin vendor të ushqimit, si dhe në ekonominë vendase. Komuna gjithashtu ka mbështetur fermerët

<sup>17</sup>Intervistat e thelluara të nga Ekspertja e të Dhënave me fermerë në Vushtri.

<sup>18</sup>Figurë e marrë nga hulumtimi në terren.

<sup>19</sup>Të dhënat e marra nga Drejtoria e Bujqësisë në Vushtri.

<sup>20</sup>Figurë e marrë nga hulumtimi në terren.

<sup>21</sup>Nga Iber-Lepenci i Vushtrisë ujiten 487 ha patate, lakër, misër. Burimi: Raporti i Gjellbër i Kosovës 2020.

<sup>22</sup>Raporti i Gjellbër i Kosovës, 2020.

<sup>23</sup>Të dhënat e pranuar nga Drejtoria e Bujqësisë në Vushtri.

vendas me bimë medicinale, patate, makina misri dhe pajisje të tjera.<sup>24</sup> Gjithashtu, komuna ka ofruar trajnime për fermerët vendas në përdorimin e këtyre pajisjeve të reja. Rrjedhimisht, kjo mund të ketë pasur ndikim në rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit të sektorit bujqësor vendor në Vushtrri.

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 2 – ZERO URI

Për të tejkaluar keqshqyerjen dhe për të adresuar sfidat që ndërlidhen me prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit, Komuna e Vushtrrisë në veçanti do të:

- Rregullojë politikatat e taksës së pronës që nxisin produktivitetin e tokës dhe parandalojnë thatësitat.
- Mbështesë programet speciale të trajnimit për bujqësi organike dhe prodhim të qëndrueshëm vendor, veçanërisht iniciativat nga shkolla e mesme bujqësore në Vushtrri.
- Marrë masa për forcimin e shërbimeve këshilluese për bujqësi të ofruara nga komuna e Vushtrrisë.
- Monitorojë në baza vjetore mesataren e prodhimit bujqësor dhe, në bashkëpunim me nivelin qendror, do të mbledh dhe përditësojë të dhëna(t) për cilësinë e tokës dhe të produkteve bujqësore.
- Nxisë krijimin e platformave të veçanta të ndërgjegjësimit në shkollat fillore dhe të mesme të Vushtrrisë mbi parandalimin e obezitetit dhe mënyrat e të jetuarit shëndetshëm për të gjithë.

## OBJEKTIVI 8 – PUNË DINJITOE DHE RITJE EKONOMIKE

**OZHQ 8 – PUNË DINJITOE DHE RITJE EKONOMIKE** ka për qëllim të promovojë një rritje ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë. Arritja e këtij objekti varet nga një varg nën-objektivash të përcaktuara mirë si: arritja e niveleve më të larta të produktivitetit ekonomik nëpërmjet transformimeve strukturore; promovimi i punësimit produktiv dhe punës së denjë për të gjithë (gra, burra, të rinjë, personat me aftësi të kufizuara); zvogëlimi i papunësisë; ratifikimi dhe zbatimi në mënyrë efektive i standardeve kryesore ndërkombëtare të punës; ndërmarrja e hapave të menjëhershëm dhe efektivë për të çrrënjësuar dhe eliminuar punën e detyruar, skllavërinë moderne, trafikimin e qenieve njerëzore dhe punën e fëmijëve; mbrojtja e punëtorëve nga pasiguria në punë; si dhe promovimi i sistemeve të mbrojtjes sociale që i përgjigjen nevojave në ndryshim. Çdo objektivë përmban edhe disa tregues që ndihmojnë në vlerësimin e progresit drejt arritjes së qëllimeve.


Ka një sërë mënyrash përmes të cilave komunat mund të punojnë për të arritur zbatimin e OZHQ 8. Një fush tejet e rëndësishme që meriton fokus të veçantë është sigurimi i qasjes në arsim cilësor dhe mundësi trajnimi për të gjithë anëtarët e komunitetit, pa dallim. Kjo do t'i lejojë individët të fitojnë aftësitë e nevojshme për të siguruar punë të mira dhe për të marrë pjesë plotësisht në ekonomi. Përveç kësaj, komunat mund të punojnë për të krijuar një mjedis të favorshëm për bizneset duke ofruar qasje në kapital, infrastrukturë dhe tregje e përmes kësaj të ndihmojnë në krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen e rritjes ekonomike. Së fundi, komunat mund të promovojnë përfshirjen sociale duke siguruar që të gjithë të kenë qasje në shërbimet bazë si kujdesi shëndetësor, banimi dhe ushqimi.

<sup>24</sup>Të dhënat e pranuar nga Drejtoria e Bujqësisë në Vushtrri.

## OZHQ 8 NË KONTEKSTIN LOKAL

Shkalla e papunësisë në komunën e Vushtrrisë vlerësohet të jetë 29%.<sup>25</sup> Të gjeturat e pyetësorit në terren tregojnë se shkalla e papunësisë është në mënyrë të konsiderueshme më e lartë në zonat rurale. Parë nga aspekti gjinor, numri i femrave të papunësuar figuron më i lartë në krahasim me meshkujt. Sa i përket aspektit arsimor, papunësia vërehet më shumë mes individëve me shkollë të mesme të ulët (9-vjeçare) dhe të mesme të lartë (12-vjeçare). Mjedisi i punës është gjithashtu një nga fushat ku duhet bërë më shumë përpjekje. Siç është dëshmuar, niveli i papunësisë prek në mënyrë disproporcionale më shumë gratë, personat me nevoja të veçanta dhe grupet sociale të cenueshme. Kjo është për shkak të një sërë faktorësh, duke përfshirë mbizotërimin e vendeve të punës me paga të ulëta, mungesën e kujdesit të përballueshëm për fëmijë/të moshuar, si dhe vështirësia e qasjes në arsim dhe trajnime. Ndikimi i papunësisë mund të jetë i gjerë, duke çuar në varfëri, shëndet të dobët dhe izolim social. Për të adresuar këtë çështje, është thelbësore të ofrohet mbështetje me cak personat më të preku nga ky fenomen.

12% e të anketuarve kanë raportuar aksidente në punë në dhjetë vitet e fundit. Përqindja e aksidenteve të raportuara në punë është shumë më e lartë në zonat urbane, dhe me e lartë tek meshkujt. Sipas rezultateve të pyetësorit numri i aksidenteve të raportuara në punë priret të jetë më i lartë tek të anketuarit më pak të arsimuar, përkatësisht punëtorët. Kjo mund të jetë nxitur shumë nga rritja e aktivitetit të industrisë së ndërtimit në vitet e fundit dhe mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të komunës për të adresuar nevojat për monitorim dhe rritjen e sigurisë në punë. Komuna e Vushtrrisë po mundohet ta adresojë këtë çështje duke fuqizuar kapacitetet inspektuese dhe duke rritur bashkëpunimin me nivelin qendror.



Diagrami 5. Të ardhurat mesatare sipas përgjigjeve të të intervistuarve nga hulumtimi në terren

37% e të intervistuarit nga hulumtimi në terren u përgjigjën që i përkasin kategorisë së të ardhurave deri në 300 euro/muaj dhe 33% e tyre u përgjigjën që i përkasin kategorisë së të ardhurave ndërmjet 301-600 euro në muaj, ndërsa përqindja e mbetur u përgjigjën që i takojnë kategorisë së të ardhurave më shumë 601

<sup>25</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (2021), Numri i të punësuarve dhe shkalla e papunësisë – Anketa e Fuqisë Punëtore

euro/muaj. Pra, ka një ndryshim domethënës për sa i përket nivelit të të ardhurave midis zonave urbane dhe rurale. Më saktësisht, zona rurale ka më pak të ardhura, dhe ndërmjet niveleve arsimore, të ardhura më të larta për ata me arsim të lartë, kryesisht universitar. Megjithatë, nuk është vënë re asnjë ndryshim midis burrave dhe grave për sa i përket nivelit të të ardhurave. Për shkak të shkallës së papunësisë të prindërve dhe të vështirësive sociale, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve punojnë që të mund të mbështesin familjen e tyre. Shkalla e punësimit të fëmijëve nga 5 deri në 17 vjeç është 7.5%.<sup>26</sup> Puna e fëmijëve është dukshëm më e lartë në zonat urbane, por faktorë të tjerë, p.sh. arsimi dhe të ardhurat nuk u vërtetuan se ishin faktorë përcaktues të shfrytëzimit të punës së fëmijëve. Komuna e Vushtrrisë është duke punuar në nivel të drejtorive komunale për të adresuar punësimin e fëmijëve, e në nivel qendror t përmes Strategjisë për Parandalimin e Punës së Fëmijëve. Përveç kësaj, perceptimi i përgjithshëm i tregut të punës është mesatarisht i mirë me 38.5% të të anketuarve që deklarojnë se kanë një perceptim mesatar dhe 20.4% me një vlerësim të lartë. Gjithashtu, numri i anëtarëve të familjes me llogari bankare ishte 2.31 në zonat urbane dhe 2.10 në mesin e të anketuarve në zonat rurale. Vushtrria ka prioritet rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse dhe është në mesin e 15 komunave që kanë funksionalizuar zyrën mobile për ndihmë juridike për personat me aftësi të kufizuara.<sup>27</sup> Ndër tjerash, komuna ka miratuar planin tre-vjeçar për banim social, si dhe rregulloren për mbrojtjen e të miturve, dhe publikon dokumentet në të gjitha gjuhët zyrtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave.

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 8 – PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE

Në mënyrë që Komuna e Vushtrrisë të rrisë mundësitë e punësimit dhe të promovojë punën e denjë dhe rritjen ekonomike, komuna do të angazhohet në:

- Uljen e shkallës së papunësisë, veçanërisht zvogëlimin e hendekut gjinor të punësueshmërisë dhe grupeve të cenueshme të shoqërisë, përmes politikave nxitëse për bizneset që punësojnë gra, të rinjtë dhe persona me nevoja të veçanta.
- Miratimin e një strategjie për monitorimin dhe inspektimin e punishteve, si dhe uljen e aksidenteve në punë duke angazhuar Drejtorinë për Inspektime, në bashkëpunim me Inspektoratin e Tregut në nivel qendror.
- Në bazë të kompetencave nga Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve, do të hartojë një strategji komunale për parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve brenda territorit të komunës deri në vitin 2030.

---

<sup>26</sup> Të dhënat nga hulumtimi i realizuar në terren në komunën e Vushtrrisë.

<sup>27</sup> <https://anjf.rks.gov.net/desk/inc/media/914A6E85-4D17-4045-84E8-85926D85DFB1.pdf>

## 3.2. DIMENSIONI MJEDISOR

### OBJEKTIVI 6 – UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

---

**OZHQ 6 - UJË I PASTËR DHE KANALIZIME** ka për qëllim sigurimin e ujit dhe kanalizimeve për të gjithë, , përfshirë menaxhimin e tyre të qëndrueshëm. Kjo objektivë synon që të arrijë zbatimin e caqeve të përcaktuara, përkatësisht garantimin e qasjes në ujë të sigurt dhe objekte të përshtatshme sanitare për të gjithë, përmirësimin e cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e ekosistemeve ujore. Arritja e OZHQ 6 kërkon përpjekje të bashkërenduara nga të gjitha sektorët e shoqërisë, duke përfshirë qeveritë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe qytetarët. Po ashtu, për të arritur progres në këtë fushë është thelbësore të miratohet një qasje shumë-sektoriale që merr parasysh nevojat dhe perspektivat e ndryshme të të gjitha palëve të interesuara. Përveç kësaj, është e nevojshme të krijohet një mjedis i favorshëm që mbështet inovacionin dhe investimet kapitale në sektorin e ujit dhe kanalizimeve. Me këto masa në fuqi, nivelet lokale mund të ndihmojnë në sigurimin e qasjes në ujë të pastër dhe kanalizime deri në vitin 2030.

Arritja e OZHQ 6 deri në vitin 2030 mund të jetë sfiduese por niveli lokal mund të eksplorojë mundësi të ndryshme inovative që qojnë drejt përmirësimit të saj. Për shembull, strukturat përgjegjëse në nivel lokal mund të ofrojnë infrastrukturë dhe mbështetje për objektet e menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve. Gjithashtu, komunat mund të krijojnë iniciativa për bizneset që ato të miratojnë praktika të qëndrueshme që ndërlidhen me ruajtjen e ujit. Për më tepër, niveli lokal duhet të punojë më tepër për rritjen e vetëdijesimit tek banorët për rëndësinë e ujit të pastër dhe kanalizimeve, si dhe të ndërmarrin iniciativa gjithëpërfshirëse që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së ujit lokal.

#### OZHQ 6 NË KONTEKSTIN LOKAL

Sa i përket shërbimeve komunale për ofrimin e ujit të pastër dhe kanalizimit, komuna e Vushtrisë është e angazhuar drejtpërdrejt në shtrirjen e rrjetit të ujit të pijshëm për qytetarët e Vushtrisë. Bazuar në të gjeturat e pyetësorit në terren, , rreth 75.2% e familjeve të anketuara deklaruan se kanë qasje në ujë të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurt. Poashtu, shtrirja dhe kyçja në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit në Komunën e Vushtrisë është realizuar në 70% të vendbanimeve, përfshirë zonën urbane.<sup>28</sup> Jo shumë vite më parë, kjo përqindje ishte përgjysmë më e vogël për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit të vjetërsuar të shpërndarjes. Me ndërtimin e fabrikës së ujit në Balincë<sup>29</sup> ,komuna pati mundësinë të investonte në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në vendbanimet ku mungonte rrjeti Në vitin 2017, sipas një hulumtimi të realizuar në terren, vendbanimet që ende nuk kishin ujësjellës ishin Balincë, Banjskë, Beçiq, Beçuk, Bivolak, Ceceli, Dobrëlluk, Dalak, Dumnicë e Poshtme, Studime e Poshtëm, Stanoc i Poshtëm, Svaraçak i Poshtëm, Druar, Duboc, dhe Galicë dhe të tjera.<sup>30</sup> Gradualisht, komuna e ka zgjeruar rrjetin në shumicën prej këtyre vendbanimeve, dhe kapaciteti i furnizimit pritet të rritet më tej.

---

<sup>28</sup> Plani Zhvillimor Komunal 2016 - 2024

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Instituti GAP, Komuna e Vushtrisë (2017), Problemet kryesore dhe trendët buxhetore

Në anën tjetër, niveli i trajtimit të ujërave të zeza në Vushtri, dhe përgjithësisht në rajonin verior, nuk është në nivelin e duhur. Rrjedhimisht, BE dhe donatorë të tjerë, do të bashkë-financojnë ndërtimin e një impianti të ri rajonal për trajtimin e ujërave të zeza.<sup>31</sup> Projekti do të realizohet në bashkëpunim me Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit Mitrovica, duke synuar përmirësimin e standardeve sanitare për 123,000 konsumatorë, si dhe uljen e ndotjes nga ujërat e zeza në Mitrovicë të Jugut, Vushtri dhe zonat përreth. Si rezultat, ky investim në infrastrukturë të gjelbër do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe në mbrojtjen e lumenjve të këtij rajoni nga ndotja. Po ashtu, me ndërtimin e fabrikës do të mundësohet hapja e vendeve të reja të punës duke nxitur kështu zhvillimin e ekonomisë lokale.

Mbi 75% e banorëve të Vushtrisë kanë qasje në sistemin e ujit të menaxhuar në mënyrë të sigurtë.

Vlen të përmendet se Komuna e Vushtrisë, në bashkëpunim me kompaninë publike "KRU Mitrovica" ka punuar në eliminimin pothuajse të plotë të asbestit nga rrjeti i shpërndarjes së ujit dhe rritjen e efikasitetit të tij duke reduktuar humbjet teknike.

Të gjeturat e pyetësorit në terren sugjerojnë se 75% e të anketuarve kanë qasje në një sistem uji të menaxhuar në mënyrë të sigurt. Përkundër kësaj, 42% e të anketuarve janë deklaruar se ende blejnë ujë të pijshëm, me një kosto mujore prej afërsisht 13 euro, gjë që tregon se duhen ndërmarrë masa për përmirësim të gjendjes në disa zona. Si rrjedhojë, autoritetet e kontrollit të cilësisë së ujit duhet të bëjnë inspektime të rregullta si dhe të punojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira dhe më të besueshme për banorët e Vushtrisë..

Si përfundim, Komuna e Vushtrisë në bashkëpunim me Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit, po punojnë drejt rritjes së nivelit të shërbimeve për të gjithë banorët e komunës, pa dallim.

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 6 – UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

Për të siguruar disponueshmërinë e ujit të pijshëm i cili menaxhohet në mënyrë të sigurtë, është i përbalueshëm dhe i qasshëm për të gjithë, si dhe për të garantuar qasje në kanalizime adekuate, Komuna e Vushtrisë do të punojë në:

- Ngritjen e standardeve sanitare dhe trajtimin e ujërave të zeza deri në vitin 2030 përmes bashkëpunimit me akterët e përfshirë në ndërtimin e impiantit rajonal, qasjes në të dhëna dhe lehtësimit të punës në terren.
- Zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe garantimin e qasjes në ujë të pijshëm, përfshirë investimet për të zvogëluar humbjet dhe për të ngritur sigurinë në rrjet. E gjithë kjo pritet të bëhet në bashkëpunim të plotë me kompaninë publike të ujësjellësit, duke synuar 100% mbulueshmëri në tërë komunën deri më 2030..
- Përshtatjen e masave dhe standardeve për mbrojtjen e konsumatorëve për cilësinë e shërbimeve të ujit dhe parandalimin e mungesës së ujit, po ashtu në bashkëpunim me KRU.
- Vushtrria do të angazhohet edhe në trajtimin e ujërave të zeza përmes projektit rajonal të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë që do të rrisë cilësinë e tokës dhe ujit të komunës.

<sup>31</sup> <https://www.ebrd.com/news/2021/ebd-eib-and-eu-to-finance-new-wastewater-plant-in-kosovo-.html>

**OZHQ 7 – ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR** synon të sigurojë qasje në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë deri në vitin 2030. Kjo objektivë po ashtu kërkon të rrisë përqindjen e energjisë së ripërtëritshme në sasinë globale të energjisë si dhe të dyfishojë shkallën e përmirësimit të energjisë eficiente në nivel global. Arritja e OZHQ 7 kërkon rritje të konsiderueshme të investimeve në energjinë e ripërtëritshme dhe energjinë eficiente, përfshirë rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar mes vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim për zgjerimin dhe avancimin e infrastrukturës së energjisë si dhe ndarjen e praktikave për teknologji të kësaj fushe. Për më tepër, të gjitha vendet do të duhet të miratojnë politika dhe masa për të nxitur investimet e sektorit privat në energjinë e ripërtëritshme dhe energjinë eficiente.

### OZHQ 7 NË KONTEKSTIN LOKAL

Skema e përkrahjes së prodhues-konsumatorëve (prosumatorëve) në Kosovë u mundëson qytetarëve që investojnë në gjeneratorët e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) të përfitojnë kompensim neto matës përmes një marrëveshjeje për kyçje me operatorët e rrjetit energjetik në vend.<sup>32</sup> Më saktësisht, kjo skemë ofron kompensim për qytetarët që gjenerojnë energji përmes paneleve diellore, dhe i lidhin ato në rrjet. Kjo inkurajon më shumë njerëz që të kalojnë në energjinë e ripërtëritshme dhe ndihmon në reduktimin e varësisë së Kosovës në karburantet fosile të importuara. Përveç kësaj, skema nxit krijimin e vendeve të punës në sektorin e energjisë së ripërtëritshme.

Komuna e Vushtrisë është një konsumator në rritje i energjisë, kërkesat e të cilës janë të ndikuara nga ndërtimet e reja dhe industria në rritje. Për të kuptuar më mirë gjendjen në terren janë analizuar të gjeturat e pyetësorit që ndërlidhen me këtë kategori. Sipas këtyre të gjeturave, rreth 59% e familjeve të anketuara kanë deklaruar se kanë shtëpi/banesë të re që është ndërtuar pas vitit 2000 ndërsa madhësia mesatare e ndërtesave të reja për familje ishte 67 m<sup>2</sup>.<sup>33</sup> Kjo përqindje e ndërtimeve pas vitit 2000 është relativisht e njejtë në të gjitha vendbanimet, përkatësisht në zonë urbane dhe zonat rurale.

Komuna e Vushtrisë po punon vazhdimisht në ngritjen e kapaciteteve dhe efikasitetin e energjisë, përkatësisht gjenerimin e energjisë përmes paneleve solare dhe erës nga projekte individuale apo projekte më madhore. Fillimisht, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe administrata në përgjithësi, kanë mekanizma për mbështetjen e qytetarëve që investojnë në panele diellore përmes skemës për mbështetje të konsumatorëve. Kjo skemë parasheh që Furnizuesit të marrin të gjithë energjinë elektrike të prodhuar dhe të dërgojnë të gjithë energjinë elektrike të konsumuar nga konsumatorët produktivë brenda një periudhe faturimi dhe të llogarisin bilancin e klientëve produktivë të periudhës së faturimit, në bazë të së cilës përgatitet fatura mujore.<sup>34</sup> Përmes kësaj skeme, komuna e Vushtrisë jep pëlqimet e nevojshme për qytetarët për ndërtimin e

<sup>32</sup> <http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Skemen%20Mbeshtetese%20per%20Gjeneratoret%20e%20Burimeve%20te%20Ripertitshme%20te%20Energjise.pdf>

<sup>33</sup> Të dhënat nga hulumtimi i realizuar në terren në komunën e Vushtrisë.

<sup>34</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregulla për Skemën Mbështetëse për Energjinë e Rinovueshme, e disponueshme në <http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Skemen%20Mbeshtetese%20per%20Gjeneratoret%20e%20Burimeve%20te%20Ripertitshme%20te%20Energjise.pdf>

këtyre kapaciteteve që ndihmojnë në uljen e nevojës për energji, në kursimin e buxhetit familjar duke rritur mirëqenien e qytetarëve, si dhe në menaxhim më të mirë të burimeve energjetike.

Tutje, Komuna e Vushtrrisë ka bashkëpunuar ngushtë me Komunën e Mitrovicës së Jugut në realizimin e një prej parqeve më të mëdha të erës në Kosovë (Bajgora). Ky park, i financuar nga BERZH, ka një kapacitet të instaluar prej 105 MË që është e barabartë me rreth 10% të kërkesës për energji në Kosovë.<sup>35</sup> Përveç kësaj, Komuna e Vushtrrisë ka miratuar edhe projektin e radhës për prodhimin e energjisë nga era, Çiçavica Wind Farm, me kapacitet 100MW.<sup>36</sup>

Komuna e Vushtrrisë po ashtu është duke punuar ngushtë me Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë për të investuar në renovimin e objekteve publike me qëllim të reduktimit të konsumit dhe uljes së faturave të energjisë. Vushtrria deri më tani ka nënshkruar marrëveshje me FKEE për renovimin e plotë të Palestrës Sportive "Jeton Terstena", Kopshtit Publik "Foleja" dhe SHFMU "Enver Hadri" në Smrekonicë dhe 5 objekte të tjera publike.<sup>37</sup> Ndër tjerash, parashihen aktivitete të tjera me fokus ngritjen e kapaciteteve për energji eficiente si subvencionimi i projekteve në zonën historike dhe zonat turistike (termoizolim, ndriçim eficient, panele fotovoltaike etj.), aplikimi i masave me EE, kampanja publike etj.<sup>38</sup>

Analiza e të dhënave nga pyetësi në terren tregon se kostoja mesatare e harxhimeve të energjisë elektrike është rreth 57 EUR në muaj (për familje). Andaj, është e rëndësishme të bëhen përpjekje të vazhdueshme të mbështeten investimet në BRE apo energji eficiente në mënyrë që kostot të jenë më të përballueshme dhe më të qëndrueshme për të gjithë banorët e Vushtrrisë.

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 7 - ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR

Në mënyrë që Vushtrria të zvogëlojë konsumin e energjisë, të përmirësojë efikasitetin e energjisë si dhe të rrisë prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, komuna duhet të angazhohet për:

- Hartimin dhe miratimin e Planit të ri Komunal të Energjisë dhe Klimës (PKKK) në përputhje me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe strategjitë e energjisë dhe klimës.
- Të krijojë mekanizmat e nevojshëm për financimin e projekteve për energji të përballueshme dhe të pastër.
- Mbështetjen e konsumatorëve përmes dixhitalizimit të shërbimit për marrjen e pëlqimeve për investime në panele diellore apo gjeneratorë të BRE.
- Investimet në eficiencë të energjisë në bashkëpunim me FKEE për të gjitha objektet publike në pronësi të komunës.
- Të promovojë krijimin e mekanizmave për energji eficiente tek sektori privat dhe të nxisë investimet e gjelbra me bazë BRE.
- Të aplikojë masa të reja për energji eficiente për tërë komunën dhe të organizojë kampanja vetëdijësuese në lidhje me rëndësinë e kursimit të energjisë.

<sup>35</sup>Parku i erës Bajgora në Kosovë\* i lidhur me rrjetin me linjë ajrore 20 kilometra, e disponueshme në <https://balkangreenenergynews.com/bajgora-wind-park-in-kosovo-linked-to-grid-with-20-kilometer-overhead- linjë>

<sup>36</sup> <https://zeri.info/ekonomia/263221/100-millione-euro-investime-ne-energji-ne-vushtri/>

<sup>37</sup>Faqja Zyrtare e Komunës së Vushtrrisë, 2021.

<sup>38</sup> Draft-Plani i Veprimit i Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë 2022-2030, Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (2019 – 2021) e disponueshme në <https://kk.rks-gov.net/vushtri/wp-content/uploads/sites/33/2019/07/Plani-i-Efi%C3%83%C2%A7ienc%C3%83%C2%ABs.pdf>



- Vushtrria njih rëndësinë e politikave të tranzicionit energjetik dhe përkrahjes së qytetarëve për investime në burimet e ripërtëritshme. Për këtë, Vushtrria do të marrë një rol udhëheqës në lehtësimin e procedurës së aprovimit për investimet në BRE. Përveç kësaj, komuna do të zgjerojë investimet në efikasitet të energjisë në të gjitha objektet publike në përgjegjësi të komunës.

## OBJEKTIVI 12 – KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM

Komunat janë institucionet kyçe në zbatimin e **OZHQ 12 PËR KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM**. Ato kanë legjitimitetin dhe mandatin për të angazhuar qytetarët në sjellje pro-mjedisore dhe të tregohen shembull në udhëheqjen e prokurimeve publike, duke promovuar gjithashtu ekonominë qarkore dhe eko-inovacionin. Në veçanti, komunat mund të luajnë një rol udhëheqës në: (i) reduktimin e mbetjeve dhe humbjeve të ushqimit; (ii) promovimin e dietave të qëndrueshme; (iii) minimizimin e gjenerimit të mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit; (iv) **maksimizimi** i efikasitetit të burimeve nëpërmjet promovimit të modeleve të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit; dhe (v) mobilizimi i financimit për zhvillim të qëndrueshëm. Me pozicionin e tyre institucional, komunat janë të vendosura në mënyrë unike për të përshpejtuar progresin drejt OZHQ 12.

### OZHQ 12 NË KONTEKSTIN LOKAL

Konsumi dhe prodhimi i qëndrueshëm është një nga shtyllat që kërkon përpjekje dhe bashkëpunim ndërsektorial të komunës me nivelin qendror dhe akterët e tjerë socialë. Duke qenë një komunë e pasur me zona malore, Vushtrria ka potencialin për të kombinuar konceptin e ushqimit të ngadaltë me zhvillimin e turizmit rural dhe me konceptin e konsumit dhe prodhimit të përgjegjshëm. Të gjeturat nga hulumtimi në terren tregojnë se rreth 4.4% e të anketuarve janë deklaruar se ofrojnë shërbime turistike. Po ashtu, vite më parë, BE në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë kanë aktivizuar 6 bujtina në Rajonin e Shalës me qëllim përshpejtimin e turizmit në atë zonë dhe promovimin e produkteve ushqimore vendase.<sup>39</sup> Kjo do të thotë se Komuna e Vushtrrisë ka potencial për krijimin e mekanizmave për zhvillimin e agroturizmit dhe të promovojë prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm lokal.

Zhvillimi i turizmit dhe prodhimi dhe konsumi i produkteve lokale mund të jenë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin lokal të Vushtrrisë. Megjithatë, duhet të mirë-mendohen mekanizma të qëndrueshëm që të mos ketë implikime mjedisore siç mund të jetë ndotja nga gjenerimi i mbetjeve. Komuna e Vushtrrisë punon vazhdimisht në menaxhimin dhe reduktimin e mbeturinave përmes programeve të ndryshme me donatorë dhe synon të ketë 100% mbulueshmëri në tërë komunën. Deri tani, komuna ka miratuar këto masa lidhur me trajtimin e mbeturinave: Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, Rregulloren e Menaxhimit të Mbetjeve Komunale, Planin Lokal të Veprimit për Mjedisin, Projekt Pilot Grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme në qendër të qytetit, etj.

<sup>39</sup> <https://kk.rks-gov.net/vushtri/news/be-komuna-e-vushtrrise-dhe-mitrovices-promovojne-turizmin-rural-ne-rajonin-e-shales/>

Vlen të theksohet edhe kontributi i Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës<sup>40</sup> të cilët operojnë në Vushtrri, dhe në gjithë vendin. Ky institucion kontribuon në arritjen e progresit të OZHQ 12 përmes praktikave të duhura bujqësore dhe konsumit të përgjegjshëm të burimeve. Një shembull konkret të cilin IADK e ka vërejtur tek fermerët me të cilët zhvillon aktivitete është menaxhimi më i mirë i mbetjeve të fermave dhe përdorimit të kimikateve.<sup>41</sup>

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 12 – KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM

Për të siguruar modele të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, Komuna e Vushtrrisë do të punojë veçanërisht në:

- Hartimin e politikave lokale mjedisore më bazë iniciativën 3R (reduktimi, ripërdorimi, riciklimi) si dhe integrimin e tyre në dokumentet zhvillimore të komunës.
- Mbledhjen e të dhënave për mbetjet urbane për kokë banori dhe një kuotë komunale në PZHK-në e ardhshme për reduktimin e të paktën gjysmës së nivelit të mbetjeve për kokë banori.
- Identifikimin e mbetjeve të rrezikshme komunale dhe trajtimin e tyre.
- Promovimin e agroturizmit nëpërmjet programeve të ndryshme me fokus zhvillimin rural, duke përfshirë mekanizma të qëndrueshëm për konsum dhe prodhim të përgjegjshëm bujqësor.
- Krijimin e mekanizmave për hulumtim dhe zhvillim të modeleve të qëndrueshme për konsum dhe prodhim të përgjegjshëm në bashkëpunim me IADK, sektorin publik dhe privat.
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese dhe edukative për konsum dhe prodhim të përgjegjshëm përmes metodave për menaxhim të qëndrueshëm dhe përdorim efikas të burimeve natyrore.

## OBJEKTIVI 15 – JETA NË TOKË

OZHQ 15 – JETA NË TOKË synon mbrojtjen, rimëkëmbjen dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, të menaxhojë pyjet në mënyrë të qëndrueshme, të luftojë shkretëtirëzimin, dhe të ndalojë dhe të ndryshojë degradimin e tokës dhe të ndalojë humbjen e biodiversitetit.

### OZHQ 15 NË KONTEKSTIN LOKAL

Komuna e Vushtrrisë shtrihet mes maleve të Shalës dhe Çyçavicës, gjë që e karakterizon si vend me trashëgimi të pasur natyrore dhe biodiversitet të gjerë të florës dhe faunës. Sipërfaqja e përgjithshme pyjore në komunën e Vushtrrisë është 13043 ha ndërsa sipërfaqet e degraduara në malet e Çyçavicës figurojnë të jenë rreth 1200 ha.<sup>42</sup> Kjo lë të nënkuptohet se gjendja është krijuar gjendje alarmante sa i përket humbjes së tokës dhe pyjeve. Një tjetër aspekt shqetësues si në nivel global ashtu edhe lokal është braktisja e tokës. Sipas gjetjeve nga hulumtimi në terren niveli i braktisjes së tokës në Vushtrri është 30%. Kjo do të thotë se sipërfaqe të mëdha toke nuk po përdoren më për qëllime bujqësore apo qëllime të tjera ekonomike. Në vend të kësaj, ato po i lihen natyrës. Shkaqet e braktisjes së tokës janë të ndryshme, por ato shpesh përfshijnë faktorë ekonomikë si

<sup>40</sup> <https://www.iadk.org/f/18/Raportet-vjetore>

<sup>41</sup> IADK, Reporti vjetor 2021

<sup>42</sup> Plani Zhvillimor Komuna i Vushtrrisë 2016 - 2024

rënia e fitimeve dhe rritja e kostove, migrimi i brendshëm nga zonat rurale në ato urbane etj. Në disa raste, toka braktiset për shkak të degradimit të mjedisit ose humbjes së shërbimeve kyçe të ekosistemit.<sup>43</sup>

Braktisja e tokës është një çështje komplekse me efekte pozitive dhe negative në biodiversitet. Nga njëra anë, braktisja mund të çojë në zvogëlimin e numrit të specieve. Në anën tjetër, mund të krijojë mundësi që speciet që janë zhdukur ose persekutuar nga njerëzit të kthehen. Për këtë arsye, në vitet në vijim është e rëndësishme që Vushtrria të identifikojë dhe të mbrojë zonat specifike të pasura me biodiversitet në të cilat braktisja e tokës luan një rol.

Në Vushtrri jetojnë 11 deri në 30 lloje endemike. Pyjet janë kryesisht gjetherënëse, termofile dhe mezofile dhe përbëjnë një numër të madh llojesh, si dushku, ahu dhe bredhi i kultivuar etj., me rritje të ulët dhe mesatare. Disa nga llojet e kafshëve janë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi etj..

### REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 15 – JETA NË TOKË

Në mënyrë që Vushtrria të mbrojë trashëgiminë natyrore dhe biodiversitetin në territorin e saj, komuna do të angazhohet për:

- Hartimin e Planit Lokal për Biodiversitet dhe Menaxhim të Pyjeve, përfshirë integrimin e politikave që lidhen me këtë objektiv në strategjitë komunale dhe në koordinim me nivelin qendror.
- Dyfishimin e sipërfaqeve të gjelbra brenda qytetit nga 4.22%<sup>44</sup> në të paktën 8.5% deri në vitin 2030, si dhe ripyllëzimi i zonave të degraduara
- Një rol sa më proaktiv në forcimin e zbatimit të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe veçanërisht të dispozitave të Kapitullit III të Ligjit për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga Ndryshimi i Destinacionit.
- Krijimin e një inventari lokal të specieve brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë së bashku me nivelin qendror dhe të merret parasysh shkalla e rrezikshmërisë së tyre gjatë planifikimit të investimeve.
- Vushtrria do ta vendosë zhvillimin mjedisor në qendër të planifikimit të politikave, veçanërisht për mbrojtjen e burimeve ujore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, ruajtjen e biodiversitetit dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra.
- Vushtrria është e përkushtuar për promovimin e turizmit lokal dhe zhvillimit rural me qëllim të ngritjes së vetëdijes për asetet e biodiversitetit dhe mbrojtjen e lokaliteteve të pasura me specie. Duke përdorur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Vushtrria është plotësisht e përkushtuar në promovimin e objektivave që theksojnë dimensionin social të zhvillimit komunal.

---

<sup>43</sup> Naoki Sugimoto, Keita Fukasawa, Akio Asahara, Minoru Kasada, Misako Matsuba dhe Tadashi Miyashita, (2022), në dispozicion në <https://royalsocietypublishing.org/doi/10.1098/rspb.2021.2222>

<sup>44</sup> Raporti për Matjen e Performancës së Komunës së Vushtrrisë, MAPL, Mars 2022

### 3.3. DIMENSIONI SHOQËROR

#### OBJEKTIVI 4 - ARSIM CILËSOR

---

**OZHQ 4 – ARSIM CILËSOR** synon sigurimin e arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë si dhe promovimin e mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë. Kjo objektivë është kritike pasi synon sigurimin e arsimit bazë pa pagesë në nivel universal, barazinë gjinore në arsim, reduktimin e pabarazive arsimore dhe rritjen e shkallës së shkrim-leximit të të rriturve dhe të rinjëve. Kjo do t'u lejojë njerëzve të të gjitha moshave të kenë mundësi të zgjeruara për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë e tyre, gjë që është thelbësore për njerëzit që të përmirësojnë jetën e tyre. Për më tepër, sigurimi i qasjes së barabartë në arsim cilësor krijon mundësi për njerëzit të pajisen me mjetet e nevojshme për të dalë nga varfëria dhe për t'u bërë qytetarë produktivë. Duke rritur progresin në arsimore në nivel global, krijohen mundësi reale për arritjen e objektivave të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm.

Komunat kanë një sërë kompetencash që përkojnë me OZHQ 4, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: politikëbërjen, planifikimin dhe buxhetimin, ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve arsimore, trajnimin e mësuesve dhe monitorimin dhe vlerësimin. Për të shfrytëzuar plotësisht këtë potencial, komunat duhet të integrojnë këtë objektivë në politikat dhe proceset e tyre të planifikimit. Për më tepër, komunat duhet të zhvillojnë kapacitete institucionale dhe njerëzore për të zbatuar në mënyrë efektive aktivitetet e lidhura me OZHQ 4.

#### OZHQ 4 NË KONTEKSTIN LOKAL

Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë ofron bazë ligjore që komunat të kenë kompetenca për "ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit".<sup>45</sup> Vushtrria, si dhe komunat tjera, ka kompetenca të zgjeruara sa i përket planifikimit, sigurimit dhe përmirësimit të kushteve për arsimin e ulët dhe të mesëm.


Komuna e Vushtrrisë është e përkushtuar që të ofrojë arsim cilësor për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Në funksion të kësaj, Komuna e Vushtrrisë ka ndërtuar një rrjet modern të infrastrukturës shkollore dhe synon të zgjerojë investimet në avancimin e kësaj infrastrukture përmes renovimeve të hapësirave shkollore, furnizimit me pajisje dhe materiale, ngritjen e kapaciteteve të mësuesve etj. Poashtu, komuna përmes Drejtorisë së Arsimit, ofron transportin për nxënësit dhe fëmijët nga zonat rurale, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta. Vlen të theksohet se Drejtoria e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë ka vënë në funksion ekipin për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë si dhe ekipin për vlerësim të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara që aktivizohen sipas nevojës.<sup>46</sup> Qytetarët e Vushtrrisë janë të përkushtuar ndaj arsimit dhe shkollat fillore dhe të mesme janë një përgatitje e mirë për të vazhduar studimet universitare. Numri i nxënësve në arsimin fillor publik dhe të mesëm të ulët për vitin shkollor

---

<sup>45</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

<sup>46</sup> <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/20244521.pdf>

2020/2021 ishte 9546 nxënës të ndarë në 494 paralele me mesatare 19.32 nxënës për klasë.<sup>47</sup> Numri i nxënësve për klasë rritet në arsimin e mesëm të lartë. Në arsimin e mesëm të lartë, në Vushtrri janë 2679 nxënës të grupuar në 120 paralele me një mesatare prej 22.33 nxënës për klasë.



Diagrami 6 . Numri i nxënësve në arsimin publik. Burimi: ASK 2015-2021


Është e rëndësishme të theksohet numri në rritje i fëmijëve të regjistruar në programin e arsimit parashkollor dhe parafillor në Vushtrri. Nga viti 2016 deri në vitin 2020, numri pothuajse është trefishuar nga 49 në 123. Kjo është një rritje e konsiderueshme që tregon një trend drejt rëndësisë së arsimit të hershëm në fëmijëri në Vushtrri. Ndër arsyt kryesore që qojnë në rritjen e këtij trendi janë rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme, si dhe fakti që më shumë familje dhe prindër në Vushtrri janë duke punuar gjë që nxit nevojën por edhe kushtet financiare për t'i dërguar fëmijët e tyre në programin paraarsimor.

Sipas të gjeturave të hulumtimit në terren, 12% e familjeve të anketuara deklaruan se kanë fëmijë në çerdhe. Numri i fëmijëve në çerdhe është pak më i lartë në zonat urbane. Analiza e hulumtimit tregon se rritja e numrit të fëmijëve në kujdesin parashkollor është ndikuar kryesisht nga niveli i arsimimit dhe niveli i punësimit me kohë të plotë të prindërve. Sa i përket shpërndarjes së numrit të fëmijëve në çerdhe, analiza tregon se 8.5% kanë një fëmijë në çerdhe dhe 3.5% kanë 2-3 fëmijë në çerdhe. Kostoja mesatare mujore për fëmijë është 50 Euro.<sup>48</sup> Komuna ka paraparë ndërtimin e çerdheve të reja në zonë urbane dhe rurale me qëllim përmirësimin e kushteve në kopshtet publike dhe për qasje më gjithëpërfshirëse.<sup>49</sup>

<sup>47</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës, Raporti i studentëve për paralele në arsimin fillor publik dhe të mesëm të ulët, 2020/2021.

<sup>48</sup>Të dhënat nga hulumtimi në terren i realizuar në komunën e Vushtrrisë.

<sup>49</sup> Draft-Plani i Veprimtari i Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë 2022 - 2030



Diagrami 7. Fëmijët Numri i fëmijëve në çerdhe, intervistat të hulumtimit në terren në zonën urbane dhe rurale

Hulumtimi në terren nxjerr në pah figura lidhur me arsimin e gjeneratave të reja por edhe të të rriturve. Sipas gjetjeve, gjeneratat e reja të Vushtrrisë qëndrojnë relativisht mirë me arsim të lartë ku 53% e familjeve të anketuara kanë deklaruar të paktën një student në arsimin e lartë.<sup>50</sup> Nga kjo përqindje, numri i studenteve femra ishte mesatarisht më i lartë në krahasim me studentët meshkuj; ndërsa, në raport me zonën rurale, numri i studenteve femra ishte më i lartë në zonën urbane. Veç kësaj, 9% e këtyre familjeve të anketuara deklaruan se studentët në familjet e tyre kanë marrë bursë në shumë mesatare prej 400 euro në vit. Megjithatë, duhet cekur se numri i këtyre bursave dhe shuma totale e parave në dispozicion ndryshon nga viti në vit. Për shembull, nga 32 bursa të dhëna në vitin 2019, komuna e rriti këtë numër në 55 në vitin 2020 dhe 2021 dhe në 70 në vitin 2022.<sup>51</sup>

Sa i përket resurseve njerëzore për zhvillimin e arsimit, Komuna e Vushtrrisë ka gjithsej 840 arsimtarë në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të lartë. Prej tyre 386 janë meshkuj dhe 454 janë femra, gjë që tregon disbalancim të vogël gjinor mes pedagogëve në këtë komunë por lehtësisht mund të përmirësohet.

Shkollat në Vushtrri organizojnë poashtu aktivitete shtesë siç janë sportet, klubet mjedisore, grupet e garave mësimore apo tjera aktivitete jashtë programit. Shumica e këtyre aktiviteteve përqendrohen në hapësirat përreth shkollës dhe në afërsi të nxënësve. Viteve të fundit ka pasur rritje të kërkesave që shkollat në Vushtrri të zgjerojnë kompetencat e tyre dhe të përfshihen në një gamë të gjerë të projekteve vendore dhe ndërkombëtare. Kjo është jashtëzakonisht pozitive pasi zgjeron horizontet e studentëve dhe i inkurajon ata të mendojnë përtej komunitetit të tyre.

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 4 – ARSIM CILËSOR

Në vitet e ardhshme, komuna do të sigurojë që:

- Identifikimin e vendbanimeve në nevojë për arsim parashkollor me qëllim qasjen në edukim të hershëm për të gjithë fëmijët pa dallim.

<sup>50</sup>Të dhënat nga anketa e realizuar në komunën e Vushtrrisë.

<sup>51</sup>Faqja zyrtare e Komunës së Vushtrrisë, e disponueshme në <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/nees/rritet-numri-i-bursave-per-vitin-akademik-2021-2022/>

- Krijimin e programeve gjithëpërfshirëse dhe jo diskriminuese arsimore që mundësojnë qasje të barabartë në arsim dhe trajnime profesionale të të gjitha niveleve, me fokus integrimin e personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve pakicë dhe grupeve tjera të cenueshme.
- Rregullimin e infrastrukturës shkollore, furnizimin me pajisje teknologjike dhe laboratorike si dhe krijimin e librarive në shkollat e Vushtrisë me qëllim optimizmin e degëve mësimore dhe ofrimin e kushteve adekuate në hap me vendet e përparuara.
- Organizimin dhe financimin e kurseve apo trajnimeve para-përgatitore për nxënësit e shkollave të mesme që kanë synim arsimin e lartë apo arsimin profesional, përfshirë këtu ngritjen e kapaciteteve të qendrës për orientim në karrierë.
- Rritjen e numrit të bursave për studim brenda dhe jashtë vendit në fushat e hulumtimit dhe zhvillimit, inxhinierisë, shkencës dhe teknologjisë dhe krijimin e mundësive për praktikë dhe punësim pas rikthimit në Vushtri.
- Vushtrria do të rishikojë politikat në fushën e arsimit në mënyrë që zhvillimi i saj të reflektojë rritjen e cilësisë dhe promovimin e zhvillimit të shkollave. Komuna do të mbështesë klubet sportive në shkolla dhe do të risë stimujt për shkollat për të promovuar aktivitetet jashtëshkollore.

## OBJEKTIVI 5 - BARAZI GJINORE

**OZHQ 5 – BARAZI GJINORE** është një angazhim ndërkombëtar që synon arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave deri në vitin 2030. Më saktë, përmes kësaj objektiviteti synohet Objektiva e OZHQ 5 përfshin sigurimi i qasjes në arsim cilësor për të gjitha vajzat, eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave në të gjitha sferat, si dhe sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe mundësive të barabarta për gratë në sferën politike, ekonomike dhe sociale. OZHQ 5 gjithashtu njeh nevojën për të trajtuar shkaqet strukturore të pabarazisë midis burrave dhe grave, siç janë marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe pabarazitë socio-ekonomike.

### OZHQ 5 NË KONTEKSTIN LOKAL

Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore<sup>52</sup> në Kosovë garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive si vlerë themelore për zhvillimin e shoqërisë. Rrjedhimisht, Komuna e Vushtrisë është e përkushtuar të punojë për arritjen e barazisë gjinore, duke filluar nga forcimi i rolit të gruas në vendimmarrje e deri te rritja e mundësive për gratë ndërmarrëse si dhe përkrahja e tyre me politika fuqizuese sociale.

Komuna e Vushtrisë ka pasur iniciativa vite me radhë për balancimin e pjesëmarrjes gjinore në strukturat dhe proceset komunale të saj. Megjithatë, arritja e plotë e barazisë gjinore në nivel komunal mbetet r ende sfida më vete

Përgjithësisht, gratë kanë më shumë gjasa se burrat të jenë të papunësuar, të nënpunësuar ose të punojnë në sektorin joformal. Këtë e tregon edhe analiza nga hulumtimi në terren ku 40% e të anketuarve të papunë ishin gra ndërsa 19% meshkuj. Këtij hendeku i atribuohen një sërë faktorësh si pabarazia sistematike gjinore

<sup>52</sup> Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, e disponueshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

brenda fuqisë punëtore dhe së fundi edhe pandemia COVID-19. Pandemia ka prekur në mënyrë joproporcionale sektorët që dominohen nga gratë, siç është kujdesi për fëmijët. Për më tepër, shumë gra janë detyruar të largohen nga fuqia punëtore për të marrë përsipër përgjegjësitë e kujdesit për fëmijët e tyre pasi shkollat dhe çerdhet mbeten të mbyllura. Në raste të tjera, shpesh punësimi i grave është bërë me kohë të pjeshme ose të përkohshme duke mos krijuar stabilitet të punës për to. Si rezultat, pabarazia gjinore është ende prezente dhe vazhdon të ketë rol në nivelin e lartë të papunësisë tek gratë.

Duke marrë parasysh pabarazitë sistematike të vazhdueshme, ishte e nevojshme të vëzhgohet në mënyrë krahasuese edhe shkalla e kënaqshmërisë me kualitetin e jetës tek të dyja gjinitë. Çuditërisht, gjetjet nga hulumtimi në terren tregojnë se 30% e të anketuarve burra dhe 34% e të anketuarve gra kanë deklaruar se janë shumë të kënaqur me kushtet e tyre të jetës. Ndërsa, në analizën krahasimore rreth pakënaqësisë me jetën, përqindja më e madhe është tek burrat. Megjithëse arsyet e këtyre dallimeve nuk janë plotësisht të qarta, ato mund të lidhen me pritshmëri dhe norma të ndryshme socio-kulturore që lidhen me lumturinë dhe kënaqësinë.



Diagrami 8. Kënaqësia e përgjithshme me kualitetin e jetës

Sa i përket përfaqësimit gjinor në strukturat komunale, Komuna e Vushtrrisë është në rrugë të drejtë për përmirësim në këtë aspekt. Aktualisht 4 nga 12 drejtori komunale drejtohen nga gra; ndërsa, sa i përket përfaqësimit në kuvend komunal, gratë kanë 11 ulëse nga gjithsej 35, përfshirë pozitën kryesuese të kuvendit.

<sup>53</sup>

Po ashtu, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Komuna e Vushtrrisë ka emëruar edhe një zyrtare për barazi gjinore. Përgjegjësitë kryesore të kësaj pozite përfshijnë koordinimin e zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore; përfshirjen e integritimit gjinor dhe buxhetimit në hartimin dhe zbatimin e politikave; bashkëpunimin me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe akterët tjerë përkatës në fushën e barazisë gjinore; përgatitjen e raporteve një vjeçare për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe raportet tjera që i dorëzohen Agjencisë; zbatimin e masave të parapara me këtë ligj. Për ngritjen e pjesëmarrjes gjinore dhe fuqizimin e grave në procese të ndryshme ka pasur mbështetje edhe nga donatorë dhe organizata ndërkombëtare. Një shembull konkret iniciuar nga Komuna e Vushtrrisë, UN-Habitat dhe Qeveria e Suedisë është pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit të dokumenteve hapësinore dhe

<sup>53</sup>Faqja zyrtare e Komunës së Vushtrrisë, e disponueshme në <https://kk.rks-gov.net>




projekteve kapitale që nxisin zhvillimin dhe rregullimin e komunës në përgjithësi. Gjatë këtij procesi, vlen të theksohen tre faza kryesore:

1. Mbledhja, digjitalizimi dhe migrimi i të dhënave hapësinore për 65 vendbanime të Komunës së Vushtrrisë (nga gjithsej 17 asistentë dhe vullnetarë, 11 kanë qenë vajza/studente të reja);
2. Takimet me Ekipin Komunal të Planifikimit (EKP) dhe grupet punuese sektoriale për konsultime dhe mbledhje të të dhënave komunale për çdo sektor (pjesëmarrje më e lartë e grave që tregojnë se ka rritje të përfaqësimit në sektorë të ndryshme komunale siç janë shërbimet publike, urbanizmi dhe mbrojtja e mjedisit, shëndeti dhe mirëqenia sociale, ekonomia, agrikultura, pylltaria dhe zhvillimi rural, trashëgimia kulturore, çështjet gjinore dhe buxheti dhe financat;
3. Takimet publike në zonë urbane dhe rurale lidhur me zhvillimin e vendbanimeve (pjesëmarrje më e ulët e grave, sidomos në zonën rurale për shkak të mungesës së mekanizmave fuqizues për pjesëmarrje dhe mundësive për punësim dhe aftësim që do të fuqizonin rolin dhe pozitën e tyre në shoqëri, duke shmangur përjashtimin social).

Pjesëmarrja e grave në zhvillimin e jetës sociale, kulturore e politike sjell një perspektivë ndryshe dhe kjo mund të ndihmojë në krijimin e një shoqërie më të ekuilibruar dhe të barabartë.

Një sektor tjetër që ka pasur rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së grave është arsimi. Derisa në vitin shkollor 2015/2016, 54% e mësimitdhënësve ishin meshkuj, në vitin shkollor 2020/2021, saktësisht 54% e mësuesve ishin gra.<sup>54</sup> Ky ndryshim ka të gjasa të ketë ardhur për shkak të një sërë faktorësh, duke përfshirë një rritje në përqindjen e grave që ndjekin karrierën e mësuesisë dhe ndryshimet në normat shoqërore në lidhje me rolet gjinore. Ky ndryshim është i rëndësishëm sepse përmbys një trend që ka ekzistuar për shumë dekada e që tradicionalisht është dominuar nga burrat.



Diagrami 6. Numri i mësuesve sipas gjinisë (ASK)

## REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 4 – BARAZI GJINORE

Me qëllim balancimin e pjesëmarrjes gjinore dhe mundësimin e qasjes së plotë dhe efektive të grave dhe vajzave në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore, Komuna e Vushtrrisë do të angazhohet për

<sup>54</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës, Numri i mësimitdhënësve sipas gjinisë, sipas komunës.

- Hartimin dhe integrimin e politikave të reja për përfaqësim të barabartë gjinor në çdo sektor të komunës si dhe krijimin e programeve mbështetëse dhe strukturave komunale që i japin fund diskriminimit gjinor.
- Krijimin apo mbështetjen e programeve për të rinjtë dhe grupet e shoqërisë civile që kanë fokus barazinë gjinore, aftësimin dhe avancimin profesional të vajzave dhe grave si dhe rritjen e punësueshmërisë së tyre.
- Fuqizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të zyrës për barazi gjinore në komunë me fokus në hulumtimin, zhvillimin dhe integrimin e politikave për barazi gjinore mbledhjen dhe identifikimin e të dhënave dhe projekteve, si dhe koordinimin e akterëve të fushës.
- Krijimi i nje profili apo baze e të dhënave për grupet e cënueshme të grave dhe vajzave nga të gjitha komunitetet përmes të cilës mund të monitorohet gjendja e tyre sociale, kushtet e jetesës, niveli i arsimimit, qasja në edukim dhe punësim etj.
- Fushata ndërgjegjëse për rëndësinë e pjesëmarrjes dhe rolin e grave dhe vajzave në shoqëri, përfshirë avancimin dhe aftësimin për tregun e punës.

## OBJEKTIVI 11 – QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

**OZHQ 11 – QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME** synon t'i bëjë qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme. Arritja e këtij objekti kërkon përpjekje të vazhdueshme për të reduktuar rrezikun nga fatkeqësitë, për të përmirësuar planifikimin dhe zhvillimin urban, si dhe për të ofruar strehim adekuat dhe shërbime bazë për të gjithë. Kjo objektivë po ashtu promovon sisteme të qëndrueshme të transportit dhe hapësira publike të gjelbra, në mënyrë që qytetet të jenë sa më të jetueshme. Adresimi i nevojave të një bote që urbanizohet me shpejtësi është thelbësore për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Sot, rreth 56% e popullsisë së botës jeton në qytete dhe deri në vitin 2050 projektohet të arrijë në 68%<sup>55</sup>. Wshtë e qartë se e ardhmja është urbane dhe duhet punuar dhe vepruar më shpejtë që të shmangen krizat dhe emergjencat që mund të shkaktojë urbanizimi, përfshirë integrimin e aspekteve sociale, ekonomike dhe mjedisore.

### OZHQ 11 NË KONTEKSITIN LOKAL

Komuna është përgjegjëse për sigurimin e qasjes në banim dhe kushteve cilësore të jetesës, në shërbime bazike, në sigurimin e transportit publik dhe ndërtimin e rrugëve lokale, në mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore e shumë funksione të reja komunale.<sup>56</sup>

Megjithatë zhvillimet e fundit dhe dyndjet e popullsisë nga zona rurale në zonë urbane, Vushtrria është shndërruar në një qytet me kërkesa të larta të shërbimeve, ndërtimit dhe me nevojë për qarkullim më të shpeshtë nga vendbanimet përreth e më larg për shkak të punës apo shkollimit. Rrjedhimisht, komuna e

<sup>55</sup> World Cities Report 2022, UN-Habitat, e disponueshme në [https://unhabitat.org/sites/default/files/2022/06/ëcr\\_2022.pdf](https://unhabitat.org/sites/default/files/2022/06/ëcr_2022.pdf)

<sup>56</sup> Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>

Vushtrrisë duhet përballet me sfida për përmbushjen e kërkesave të banorëve të saj, sidomos në banim (qoftë social apo të përbalueshëm), lëvizshmërinë e qëndrueshëm urbane dhe transportin, qasje në shërbime bazike të qëndrueshme etj.

Duke u ndërlidhur me treguesit e OZHQ 11, është parë e nevojshme të bëhet një vëzhgim i gjendjes në terren, përfshirë verifikimin e të dhënave të mbledhura me palët përkatëse në komunën e Vushtrrisë. Në aspektin e banimit, gjetjet nga hulumtimi tregojnë se kostoja mesatare e jetesës për familje në Vushtri del të jetë ndërmjet 250 dhe 300 euro. Vlera është vlerësuar për normën e koston së banesave që përfshin interesin e qirasë ose të hipotekës (nëse zotërohet nga pagesat në pritje). Megjithatë, kjo nuk përfshin kostot e rekreacionit dhe argëtimit. Pandemia COVID-19 ka shkaktuar ulje të të ardhurave për shumë familje duke rritur koston e jetesës; pasojat kanë qenë veçanërisht të rënda për familjet me të ardhura të ulëta, të cilat veçse po luftonin për të përbaluar jetesën. Një tjetër rezultat i bazuar në hulumtimin në terren tregon se shkalla e koston së banimit është më e lartë për familjet në zonat rurale krahasuar me shkallën në zonat urbane. Arsyt kryesore për këtë ndryshim përfshijnë faktin se familjet në zonat rurale duhet të shpenzojnë më shumë për transportin dhe shpenzimet e udhëtimit, si dhe faktin që shpesh duhet të paguajnë çmime më të larta për mallra dhe shërbime. Një arsye tjetër mund të lidhet me madhësinë e shtëpive të banimit, të cilat janë më të mëdha në zonat rurale, duke e bërë koston e ngrohjes më të lartë. Përveç kësaj, familjet në zonat rurale shpesh duhet të përballen me kosto më të larta për kujdesin ndaj fëmijëve.

Sa i përket lëvizshmërisë, komuna e Vushtrrisë ka investuar për të zgjeruar nivelin e shtigjeve për biçikleta dhe të trotuareve për këmbësorë. Rreth 4 kilometra është gjatësia e shtigjeve për biçikleta që aktualisht janë funksionale në qytet dhe sipas të gjeturave nga hulumtimi në terren rreth 66,8% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë një biçikletë funksionale që e shfrytëzojnë. Për më tepër, numri mesatar i biçikletave për familje ishte 1,3 por vlen të theksohet se disa familje, edhe pse në numër të vogël, posedonin në 6 biçikleta. Hendeku mes zonës urbane dhe rurale për përdorim të biçikletave nuk ishte edhe shume i lartë, përkatësisht 10% më shumë në zonë urbane dhe kjo për faktin se banorët në këtë zonë kanë infrastrukturë dhe shtigje më të përshtatshme, gjë që e bën më të lehtë përdorimin e biçikletave. Për më tepër, banorët urbanë janë përgjithësisht më të dendur se ata që jetojnë në zonat rurale, që do të thotë se ata shpesh kanë udhëtime më të shkurtra dhe mund të lëvizin më lehtë me biçikletë. Si rezultat, shkalla pak më e lartë e pronësisë së biçikletave në zonat urbane ka kuptim kur merret parasysh në këtë kontekst.

Sa i përket qasjes në transport, 40.5% e të anketuarve nga hulumtimi në terren e kanë vlerësuar gjendjen të jetë mesatarisht mirë, përkundër faktit që komuna ende nuk posedon transport publik të vetin dhe stacione apo vendprirje të përshtatshme..

Sidoqoftë, Komuna e Vushtrrisë po punon rreth zgjidhjes së këtyre çështjeve, përkatësisht për përmirësimin e infrastrukturës për lëvizshmëri të lehtë të banorëve me mjete alternative të transportit, si dhe për ndërtimin apo zgjerimin e shtigjeve për biçikleta, vendkalimeve për këmbësorë, ndalesat e autobusëve si dhe rregullimin e parkingjeve. Po ashtu parashihet edhe analiza e lokacionit për ndërtimin e stacionit të autobusëve në qytet. Të gjitha këto dhe më shumë aspekte të mobilitetit të qëndrueshëm do të trajtohen edhe me Planin e ri të Mobilitetit të Qëndrueshëm që Komuna e Vushtrrisë synon ta hartojë në një periudhë të afërt bashkë me donatorë dhe me akterë të tjerë të fushës.

Komuna, ndër tjerash, është e përkushtuar të bashkëpunojë me nivelin qendror në përmirësimin e infrastrukturës së transportit rajonal dhe ndër-rajonal në mënyrë që siguria në trafik të jetë në nivel dhe të trajtohet mbingarkesa e trafikut me të cilën qyteti po përballet.

Për më tepër, komuna do të integrojë në dokumentet dhe politikat e saj zhvillimore komunale të gjitha aspektet që kërkohen për arritjen e Objektivës 11, duke respektuar dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor dhe promovuar vlerat e kërkuara në të.

#### REKOMANDIME PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË OZHQ 11 – QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

Me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit dhe komuniteteve brenda Vushtrrisë, Komuna do të angazhohet në:

- Ofrimin e kushteve më të mira për banim përmes identifikimit, regjistrimit dhe trajtimit të nevojave për banim, përfshirë banimin social dhe të përballueshëm.
- Zbatimin e ligjeve përkatëse të banimit, ndërtimit dhe planifikimit, si dhe në hartimin e programeve adekuate komunale për trajtimin e banimit në çdo kontekst;
- Hartimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm në bashkëpunim me të gjithë akterët lokalë, dhe nën mbështetjen e donatorëve dhe ekspertizës ndërkombëtare.
- Ndërtimi dhe zgjerimi i shtigjeve të biçikletave, vendkalimeve dhe trotuareve për këmbësorë si dhe përcaktimi dhe ndërtimi i ndalesave të reja për transport komunal dhe ndër-komunal.
- Përcaktimi dhe zbatimi i politikave për sigurinë në komunikacion, përfshirë pajisjen me sinjalizim në rrugët lokale.

### 3. REKOMANDIME DHE VEPRIME PAS VLERËSIMIT VULLNETAR LOKAL

Duke u bazuar në gjetjet dhe rezultatet e këtij Vlerësimit i të parë Vullnetar Lokal në Kosovë dhe për Komunën e Vushtrrisë, respektivisht, rekomandohen veprimet e mëposhtme për të forcuar zbatimin dhe progresin e Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve.

- Komuna e Vushtrrisë, së bashku me Ekipin Komunal të emëruar të VLR-së, mund të hartojnë një plan veprimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendës 2030 në nivel lokal, duke integruar edhe të gjeturat e Raportit të VLR-së për Vushtrrinë.
- Komuna e Vushtrrisë mund të organizojë punëtori dhe trajnime në kontekstin e OZHQ-ve me të gjitha palët e interesuara (lokale dhe qendrore, OSHC, studentë, akademi, komunitet, etj.) për të promovuar zbatimin e OZHQ-ve në nivel lokal dhe për të inicuar veprime.
- Rekomandohet që të ndërtohet një platformë digjitale për të gjurmuar dhe matur progresin e SDG-së dhe për të përcjellë Agjendën 2030 në Komunën e Vushtrrisë. Platforma mund të ndërtohet duke aktivizuar aktorë të ndryshëm (bashkia, niveli qendror, OJQ-të, qendrat e teknologjisë, studentët dhe akademia) përmes një sërë seminaresh, takimesh me stuhi idesh, trajnime etj. Hakatonët për të rinjtë mund të konsiderohen për zgjidhje inovative platformash, vizualizim të të dhënave, kërkime dhe analiza. Komuniteti i donatorëve dhe pushteti vendor mund të drejtohen për mbështetje në këtë fushë.
- Roli dhe përgjegjësitë e Ekipit Komunal të VLR-së mund të zgjerohen në raportimin dhe monitorimin e progresit të SDG dhe Agjendën 2030 për Komunën e Vushtrrisë. Për më tepër, mundësitë e trajnimit në lidhje me fushën e SDG mund të ofrohen për ta, në nivel lokal dhe/ose ndërkombëtar.
- Komuna e Vushtrrisë mund të bashkojë forcat me Komisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kuvendin e Kosovës për të krijuar një platformë të orientuar drejt veprimit dhe për të vazhduar përpjekjet për promovimin e OZHQ-ve në mbarë Kosovën .. lokalizimi i SDG-ve dhe kontributi në Agjendën 2030. Një mënyrë tjetër për Vushtrrinë për të promovuar dhe kontribuar në zgjerimin e përvojës së VLR-së mund të jetë përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës.
- Komuna e Vushtrrisë, me mbështetjen e strukturave të tjera (komuniteti i donatorëve, qeveria, OSHC-të etj.) mund të fillojë promovimin e zotimeve vullnetare për të stimuluar angazhimin qytetar, iniciativat me ndikim dhe partneritetet e palëve të interesuara për zbatimin e OZHQ-ve në nivel lokal dhe në mbarë Kosovën.
- Zbatimi i OZHQ-ve dhe Agjenda 2030 duhet të jetë koherent dhe i mirë-integruar brenda strategjive lokale (PZHK, planet sektoriale etj.) dhe të përafrohet plotësisht me politikat e nivelit kombëtar. Në këto procese inkurajohen dialogu i përbashkët dhe mekanizmat me shumë palë.
- Për rezultate më efektive, të dhënat që lidhen me të gjithë sektorët duhet të mblidhen, mirëmbahen dhe përpunohen shpesh brenda strukturave përkatëse komunale.
- Vushtrria do të përdorë kornizën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për të projektuar zhvillimin gjatë dhjetë viteve të ardhshme. Hartimi i planit të ardhshëm zhvillimor komunal do të udhëhiqet nga parimet e OZHQ-ve dhe korniza e objektivave për planifikimin e arritjeve,

matjen e progresit dhe monitorimin. Komuna do të zgjerojë bashkëpunimin me nivelin qendror në mënyrë që skema e ndihmës sociale të jetë më dinamike, më gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt aktivizimit ekonomik të familjeve të mbuluara.

- Duke përfituar nga OZHQ- të, komuna do të vendosë dimensionin mjedisor në qendër të zhvillimit në dekadën e ardhshme duke harmonizuar kuadrin strategjik me atë të OZHQ -ve .
- Komuna është e përkushtuar për një qytet dhe komunitet të qëndrueshëm përmes rritjes së lëvizshmërisë, qasjes në shërbime dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve publike. Duke bërë këtë, Vushtrria bashkëpunon me nivelin qendror dhe donatorët për të promovuar barazinë gjinore dhe kohezionin social.

#### 4. SHTOJCAT (Do të bashkangjiten në dorëzimin final)

SHTOJCA A – RAPORTET TEMATIKE/DIMENSIONI MJEDISOR, SOCIAL DHE EKONOMIK.

SHTOJCA B – RAPORTI I AUDITIMIT TË TË DHËNAVE

SHTOJCA C – RAPORTET E PUNËTORISË

SHTOJCA D – MATRICA E PALËVE TË INTERESIT

---





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës



**Datë:** 10.06. 2022

**Për:** KPF –në dhe Kuvendin Komunal

**Propozues:** Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi 

**Hartues:** Koordinatorin për sistemin e menaxhimit të performancës, Islam Latifi 

**Për shqyrtim:** Raporti i sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2021

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe me partnerët e MAPL-së, ka publikuar raportin e performancës për vitin 2021, i cili raport përmban 19 fusha dhe 104 tregues nga 119 sa janë gjithësej dhe Grantin e Performancës i cili bazohet në 28 tregues ndërsa Komunën e Vushtrrisë e ka renditur mesatarishtë, me një përqindje prej 54.39%.

Raporti përfshin periudhën janar-dhjetor 2021 dhe është tërësisht i bazuar në metodologjinë standarde dhe dokumentin kryesor të sistemit të performancës komunale, dokumente këto të diskutuara dhe të formuluar gjatë viteve të fundit, si dhe Rregulloren e Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr. 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemës së Grantit për Performancë Komunale.

## Hyrja

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre për herë të dytë u realizua përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Në këtë sistem kishin qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sikurse herën e parë sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjijtes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synonte të pasqyronte dy aspekte kryesore të punës së komunave:

- 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Raporti i performancës komunale prezanton rezultatet e komunave nëpërmjet 19 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre. Vitet e kaluara, Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale kaloi nëpër një proces të rishikimit të plotë, ashtu siç ishte paraparë në planin vjetor të punës së ministrisë. Objektivi i zhvillimit të sistemit ishte përfshirja e sa më shumë fushave të kompetencave komunale dhe treguesve që synonin së pari të pasqyronin gjendjen reale të ofrimit të shërbimeve publike, dhe së dyti rezultatet e fituara të shërbenin si burime të rëndësishme të të dhënave për përmirësim të qeverisjes në sektorët në nevojë.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe për të reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Për vitin 2021 kanë raportuar 37 komuna të Republikës së Kosovës<sup>1</sup>

Sistemi është i ndërtuar mbi tetë parime themelore:

- Parimin e ligjshmërisë;
- Parimin e transparencës;
- Parimin e subsidiaritetit;
- Parimin e meritës;
- Parimin e efikasitetit dhe efektivitetit;
- Parimin e vlefshmërisë;
- Parimin e barazisë; dhe
- Parimin e zbatueshmërisë.

---

<sup>1</sup> Të dhënat nuk janë raportuar nga Komuna e Skenderajt

## Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve në komuna brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.

Edhe në këtë cikël të matjes dhe vlerësimit të punës së komunave, shtrirja e të dhënave reflekton të arriturat e komunave në kuadër të treguesëve, rezultateve (nëobjektivave) dhe *fushave* sipas kompetencave vetanake përkatëse.

Sipas këtij raporti Komuna e Vushtrrisë nuk ka arritur të plotësojë kriteret minimale për të përfituar fonde nga Granti i Performancës përmes skemës së bashkëfinancuar ndërmjet donatorëve SDC/DEMOS dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

## Trendet e performancës së Komunës së Vushtrrisë ndër vite

Matja e performancës së komunave rezulton me të dhëna që pasqyrojnë shkallën e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ana e komunave. Ndër vite kanë ndryshuar elementet e matjes së performancës ngase numri i treguesve ka ardhur gjithnjë duke u rritur. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale.

### Informatat e përgjithshme për Komunën e Vushtrrisë

Komuna	Territori në km <sup>2</sup>	Numri i banorëve	Performanca %
Vushtrri	345	69870	54.39 %

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se Komuna e Vushtrrisë ka arritur performancë të shkallës mesatare (54.39%).




Fig.1. Performanca e Komunës së Vushtrrisë sipas viteve 2017-2021

## Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2021 nxjerr të gjetura të shumta për 19 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

## Arritjet më të larta

Komuna qëndron lart me performancë në fushat si vijon: fusha e shërbimeve administrative, transparencë, infrastruktura publike, mbrojtja e mjedisit lokal, në menaxhimin e mbeturinave,. Ndërsa në nivel të mesëm të ofrimit të shërbimeve, Komuna e Vushtrrisë i ka këto shërbime: mirëqenia sociale dhe familjare, kultura rinia dhe sporti, fusha e transportit publik, parkingjet publike, uji i pijshëm, kanalizimi, dhe fusha për planifikim urban.

## Arritjet më të ulëta sipas treguesve

Komuna ka shënuar performancë të ulët sipas treguesve në vijim: % e të punësuarve me aftësi të kufizuar në institucionet komunale, sipas përkatësisë gjinore, sipërfaqja e shesheve publike në m<sup>2</sup> për kokë banori, sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m<sup>2</sup> për kokë banori, % e të punësuarve nga komunitetet joshumicë sipas përkatësisë gjinore, % e vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza, % e popullatës e cila përfiton nga skema sociale, hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë m<sup>2</sup>/kokë banori, etj.

## Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike, si dhe gjetjeve nga ky hulumtim, Komunës së Vushtrrisë i rekomandohet që të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrej tonline
- Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët
- Sa më shumë përfshirje të punësuarve me aftësi të kufizuar, si dhe sipas përkatësisë gjinore, në institucionet komunale;
- Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal
- Ligjshmëria e kontratave për shërbime të veçanta;
- Rritjen e sipërfaqeve, shesheve publike në m<sup>2</sup> për kokë banori;
- Rritjen e sipërfaqeve të hapësirave të gjelbra publike në m<sup>2</sup> për kokë banori;
- Përfshirje të punësuarve nga komunitetet joshumicë sipas përkatësisë gjinore;
- Rritja e % së vendbanimeve për furnizim me ujë të pijshëm;
- Vlerësimi vjetor i punëtorëve - shërbyesve civil, në bazë të udhëzimit për vlerësim;
- Rritjen e % të vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza;
- Rregullimi i numrit të popullatës e cila përfiton nga skema sociale.
- Hartimi i Planit Lokal për Veprim në Mjedis,
- Diskutimi në kuvend i Raportit të auditorit të brendshëm,
- Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal,
- Përmbushja e standardeve minimale të konsultimeve publike,
- Miratimi me kohë i buxhetit vjetor,
- Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit,
- Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme),
- Konstituimi i Këshillave të vendbanimeve-fshatrave,

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur vlerësimi i kushteve minimale për vitin 2021:

Nga vlerësimi shihet se Komuna e Vushtrrisë nga katër kushtet minimale, e ka përmbushur vetëm një, përderisa tre kushtet tjera; Raporti i auditorit duke qenë i kualifikuar, shpenzimi i buxhetit për investime kapitale për vitin 2021 në vlerën më pak se 75 % dhe rishikimi i akteve komunale të vlerësuara si të kundërligjshme, nuk janë përmbushur dhe rrjedhimisht Komuna e Vushtrrisë nuk është pjesë e Grantit të Performancës për vitin 2021.

Përmbledhje e rezultateve për performancën e vitit 2021 për grantin e performancës komunale 2023- Komuna Vushtrri  
Pregled rezultata učinka za 2021. godinu za opštinski grant učinka 2023. - Vučitrn

#	Kushti minimal Minimalni uslov	Vlerësimi Procena
1	Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar	Po
	Podaci učinka opština izvestavani u SUUO prema predviđenim rokovima	Da
2	Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës	Jo
	Opštine su se trebale pridržavati zakonske obaveze kako bi razmotrili opštinske akte koje je nadzorni organ procenio kao nezakonite	Ne
3	Opinionit vjetor i auditimit së paku i 'Pamodifikuar me theksim të çështjes'	Jo
	Izveštaj o reviziji sa najmanje 'Ne-modifikovano mišljenje sa isticanjem pitanja'	Ne
4	Së paku 75% e buxhetit final për investime kapitale është shpenzuar	Jo
	Najmanje 75% finalnog budžeta za kapitalne investicije je potrošeno	Ne
<b>Komuna nuk kualifikohet për grant të performancës komunale / Opština se ne kvalifikuje za opštinskog granta učinka</b>		
#	Fushat dhe nënfushat e treguesve të performancës Oblasti i pod oblasti pokazatelja učinka	Vlerësimi Procena
I	Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës	3
	Uloga Skupštine Opštine kao nadzorni organ	
II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	5
	Učešće, konsultacije i sveobuhvatnost građana	
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	4
	Transparentnost, pristup informacijama i integritet	
Vlerësimi për qeverisjen komunale Ocena za opštinsku vlast		12
IV	Menaxhimi financiar	2
	Finansijsko upravljanje	
V	Menaxhimi i kontratës	3
	Upravljanje ugovorom	
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	2
	Upravljanje ljudskim resursima	
Vlerësimi për menaxhimin komunal Ocena za opštinsko upravljanje		7
VII	Shërbimet administrative	6
	Administrativne službe	
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	3
	Prostorno planiranje, javni transport i životna sredina	
IX	Arsimi parauniversitar	2
	Preduniverzitetsko obrazovanje	
X	Kujdesi parësor shëndetësor	5
	Primarna zdravstvena zaštita	
Vlerësimi për ofrimin e shërbimeve Ocena za pružanje usluga		16
<b>Rezultati përfundimtar Konačni rezultat</b>		<b>35</b>





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Shërbime Publike

Datë/a:	08.11.2022
Për:	KPF, Kuvendin Komunal
Përmes:	Kryetari i Komunës Ferit Idrizi 
Nga:	Drejtori i Drejtorisë Benjamin Shala 
Tema:	Informatë lidhur me aktivitetet për implementim të reformës në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë

Të nderuar anëtar të kuvendit,

Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale. Pra ky ligj ka deleguar më shumë autoritet dhe përgjegjësi të qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, pat hartuar dhe miratuar në kuvend, Planin për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026 brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me ligjin për mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm.

Komuna e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të implementimit të Planit Lokal, si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave, përveç krijimit të mekanizmit institucional (emërimit të zyrtarit për menaxhim të mbetjeve dhe zyrës për inkasim) dhe mekanizmit financiar (planifikimin e taksës për mbeturina si e hyrë komunale), ka arritur që të bëjë:

- zbatimin e Planit të ri operativ që ka rezultuar me; vazhdimin e kontraktimit të shërbimit me Ndërmarrjen Regjionale „Uniteti” për tërë territorin e komunës, vazhdimin e mbledhjes së taksës për mbeturina si e hyrë komunale për vitin 2022, menaxhimi i softwerit pra sistemit të menaxhimit të të dhënave së bashku me listën e ekonomive familjare, profilizimin e klientëve, mënyrën e llogaritjes së kostos dhe nevojave financiare, shpërndarjen e faturës, mënyrën e pagesës, fushatën e vetëdijesimit publik, si dhe në ndërkohë verifikimin e fizibilitetit të projektit,
- zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohet në deponi përmes promovimit dhe praktikimit të ndarjes së mbeturinave që në burim, për zonën e përzgjedhur në qytet me 1500 ekonomi familjare,
- projekti për ndarjen e mbetjeve në burim në të gjitha institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë,



Tërë këto aktivitete kanë qenë të mbështetura nga konsulenca e vazhdueshme e GIZ-së përmes marrëveshjes së mirëkuptimit me ç'rast përfitimet e Komunës së Vushtrrisë kanë qenë shumë të mëdha. Përveç asistencës së vazhdueshme teknike përmes konsulentëve të angazhuar, është bërë hartimi i nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të tri komunave të regjionit duke përfshirë Komunën e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt, (planit operativ të ndërmarrjes, planit të zgjerimit të shërbimit, planit të riorganizimit të qendrës së qytetit).

Kur jemi te mbulueshmëria me shërbim dhe projekti i grumbullimit të mbetjeve të diferencuara, GIZ ka financuar Garën për Mjedis të Pastër të lansuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes së cilës Komuna e Vushtrrisë është furnizuar me dy kompaktorë njëri 8 m<sup>3</sup> dhe një kompaktorë 16m<sup>3</sup>, përderisa janë në dispozicion edhe 120 000 euro për blerjen e një cisterne për larjen e rrugëve.

Ndërsa sa i përket deponive ilegale, komuna së bashku me Ndërmarrjen UNITETI në kuadër të aktivitetit për eliminimin e deponive ilegale, ka bërë eliminimin e disa deponive ilegale, me çrast aktualisht kemi vetëm 5 deponi ilegale të mëdha sepse pas shtrirjes së shërbimit në tërë territorin e komunës është bërë eliminim i qëndrueshëm i tyre.

Pra tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim kanë pasur mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e deponive ilegale, rritjen e shkallës së inkasimit përmes mekanizmave kushtëzues që parasheh rregullorja për menaxhim të mbetjeve, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim dhe procesit të kompostimit.

Shtojcë e informatës:

- *Raporti vjetor i dërguar në AMM*

Të dhënat për vitin: |2|0|2|2|

**RVMM 1 - Raporti vjetor i menaxhimit të mbeturinave nga komunat****FORMULARI 1: Faqja hyrëse**

<b>1</b>	<b>Të dhëna për komunën:</b>	
1.1	Komuna:	Vushtrri
1.2	Adresa e Komunës:	rr. „Isa Boletini“ nr. 44
1.3	Ueb-Faqja e komunës:	<a href="https://kk.rks-gov.net/vushtrri/">https://kk.rks-gov.net/vushtrri/</a>
<b>2</b>	<b>Të dhëna për personin përgjegjës për raportin vjetor:</b>	
2.1	Emri e mblemri:	Ferit Idrizi
2.2	Funksioni:	Kryetar I Komunes
2.3	Telefoni:	044 509 633
2.4	E maili:	ferit.idrizi@rks-gov.net
<b>3</b>	<b>Të dhëna për personin përgjegjës për regjistrimin e të dhënave:</b>	
3.1	Emri e mblemri	Ilir Pllana
3.2	Funksioni	Zyrtar për menaxhim të mbeturinave
3.3	Telefoni:	044 332 330
3.4	E maili:	ilir.pllana@rks-gov.net
Personi përgjegjës për raportin vjetor:		Personi përgjegjës për regjistrim të të dhënave:
Emri dhe mblemri		Emri dhe mblemri
<u>Ferit Idrizi</u>		<u>Ilir Pllana</u>
nënshkrim		nënshkrim
_____		_____
Në _____		Data:  _ _  -  _ _  -  _ _ _ _
<p>Raporti dorëzohet në këtë mënyrë:</p> <p>1) përmes regjistrimit të të dhënave në formën digjitale (excel),</p> <p>2) përmes dorëzimit të raportit në formë të shtypur dhe nënshkruar nga personi përgjegjës për regjistrim të të dhënave dhe personi përgjegjës për saktësinë e të dhënave. 3) dokumentet tjera të bashkangjitura (rregullorja komunale për mbeturina, plani komunal për menaxhim të mbeturinave etj) dorëzohen vetëm në formë digjitale të skanuar dhe duhet të jenë të plota.</p>		

\*në udhëzues të shpjegohet që për qelulën 1-psh zyrtari për menaxhim të mbeturinave, dhe qelulën 2-kryetari I komunës

**FORMULARI 2 - RAPORT MBI PAJTUESHMERINË ME KORNIZËN LIGJORE DHE PLANIFIKUESE PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE**

1) A ka hartuar dhe miratuar me vendim, komuna juaj Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave (PKMM), bazuar në kërkesat në Ligjin për Mbeturina, i cili është ende valid ? Të deponohen në formë elektronike kopjet e skanuara të dokumenteve (dok 1: PKMM dhe dok2: vendimi i komunës për miratim të PKMM).

Po

Jo

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/20185917.pdf>

2) A ka hartuar dhe miratuar komuna juaj Rregulloren Komonale për Menaxhim të Mbeturinave (RrKMM)? Të deponohet në formë elektronike kopja e skanuar e RrKMM e kaluar në kuvendin komunal dhe e nënshkruar.

Po

Jo

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/20183728.pdf>  
<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/12/Rregullore-per-menaxhimin-e-mbeturinave-ne-Komunen-e-Vushtrise.pdf>

3) A ka komuna juaj zyrtar për menaxhim të mbeturinave me punësim të përhershëm, përshkrimi i punës i të cilit siguron që të paktën 50% e përgjegjësive janë në menaxhim të mbeturinave? Të deponohet në formë elektronike vendimi me përshkrim të punës të zyrtarit apo kontrata e punës apo (dok 1: vendimi i punës apo kontrata e punës).

Po

Jo

<p>4) A ka komuna juaj inspektor mjedisor, përshkrimi i punës i të cilit siguron përgjegjësi në fushën e menaxhimit të mbeturinave? Të deponohet në formë elektronike vendimi me përshkrim të punës të zyrtarit apo kontrata e punës apo (dok 1: vendimi i punës apo kontrata e punës).</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo</p>
<p>5) A ka përzgjedhur dhe kontraktuar komuna operatorët e licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale, duke zbatuar procedurat e prokurimit? Të deponohet në formë elektronike (dok 1: Kontrata apo marreveshja me operatorin).</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo</p>
<p>6) A ka përzgjedhur dhe kontraktuar komuna operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, duke zbatuar procedurat e prokurimit? Të deponohet në formë elektronike (dok 1: Kontrata me operatorin).</p> <p><input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo</p>
<p>7) A ka caktuar komuna tarifë e shërbimit duke kaluar procesin tariforë për grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale, përmes kalkulimit të kostove të shërbimit, profilizimin e klientëve dhe caktimin e tarifave të shërbimit? Të deponohet në formë elektronike rregullorja komunale për menaxhim të mbeturinave (ku pjesë përbërëse janë tarifat), si dhe tabelat që dëshmojnë procesin e kaluar në përcaktim të tarifës (dok 1: Rregullorja komunale për Menaxhim të mbeturinave dhe dok2: Procesi tarifor).</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo</p>
<p>8) A ka caktuar komuna, brenda territorit të vet, qendrën për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore? (dok 1: vendim për caktim të lokacionit).</p> <p><input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo</p>

Shpjegim: Të dhënat për këtë formular duhet të i referohen afatit përfundimtar mars 2022

9) A ekziston struktura organizative e cila pasqyron inspektoratin, në komunën e juaj? Të deponohet në formë elektronike (dok 1: Organogrami)

10) A ka raportuar komuna juaj për gjobat mandatore të shqiptuara gjatë vitit raportues? Të demonstronhet me raportin e nënshkruar nga.....(dok 1:)

\* nëse është bashkangjitur dokumenti në vitin paraprak dhe është ende i njejti valid, të mos bashkangjitet.



**FORMULARI 4 - REGJISTRI I OPERATORËVE TË LICENCUAR PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE NË KOMUNË**

OP1	Emri i plotë i operatorit:	KRM „UNITETI“-Njësia Punuese Vushtrri
	Adresa e operatorit:	Rr. „Hamit Hyseni“
	Numri i telefonit:	028 571 840
	Email adresa:	Krmuniteti@hotmail.com
	Veprimtaria primare:	
	Kodet e mbeturinave që trajtohen (KShM):	_ _ _ _ _ _ _
	Numri i regjistrimit të biznesit:	8 1 0 5 4 7 9 1 1
	Numri i licencës:	147/20
	Data e lëshimit të licencës:	28.10.2020
	Numri i kontratës:	
	Data e fillimit të kontratës:	Validiteti deri më:  _ _ .  _ _ .
	Numri i Lejes së punës:	
	Data e lëshimit të lejes së punës:	Validiteti deri më:  _ _ .  _ _ .
OP2	Emri i plotë i operatorit:	
	Adresa e operatorit:	
	Numri i telefonit:	
	Email adresa:	
	Veprimtaria primare:	
	Kodet e mbeturinave që trajtohen (KShM):	_ _ _ _ _ _ _
	Numri i regjistrimit të biznesit:	_ _ _ _ _ _ _
	Numri i licencës:	_ _ _ _ _ _ _
	Data e lëshimit të licencës:	Validiteti deri më:  _ _ .  _ _ .
	Numri i kontratës:	
	Data e fillimit të kontratës:	Validiteti deri më:  _ _ .  _ _ .
	Numri i Lejes së punës:	
	Data e lëshimit të lejes së punës:	Validiteti deri më:  _ _ .  _ _ .
	Emri i plotë i operatorit:	
	Adresa e operatorit:	
	Numri i telefonit:	
	Email adresa:	
	Veprimtaria primare:	

OP3	Kodet e mbeturinave që trajtohen (KShM):	_ _ _ _ _ _ _ _
	Numri i regjistrimit të biznesit:	_ _ _ _ _ _ _ _
	Numri i licencës:	_ _ _ _ _ _ _ _
	Data e lëshimit të licencës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.
	Numri i kontratës:	
	Data e fillimit të kontratës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.
	Numri i Lejes së punës:	
	Data e lëshimit të lejes së punës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.
	Emri i plotë i operatorit:	
	Adresa e operatorit:	
OP4	Numri i telefonit:	
	Email adresa:	
	Veprimtaria primare:	
	Kodet e mbeturinave që trajtohen (KShM):	_ _ _ _ _ _ _ _
	Numri i regjistrimit të biznesit:	_ _ _ _ _ _ _ _
	Numri i licencës:	_ _ _ _ _ _ _ _
	Data e lëshimit të licencës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.
	Numri i kontratës:	
	Data e fillimit të kontratës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.
	Numri i Lejes së punës:	
Data e lëshimit të lejes së punës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.	
OP5	Emri i plotë i operatorit:	
	Adresa e operatorit:	
	Numri i telefonit:	
	Email adresa:	
	Veprimtaria primare:	
	Kodet e mbeturinave që trajtohen (KShM):	_ _ _ _ _ _ _ _
	Numri i regjistrimit të biznesit:	_ _ _ _ _ _ _ _
	Numri i licencës:	_ _ _ _ _ _ _ _
	Data e lëshimit të licencës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.
	Numri i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.	
Numri i Lejes së punës:		
Data e lëshimit të lejes së punës: _____.____.	Validiteti deri më: _____.____.	



**FORMULARI 5 - MBULIMI ME SHËRBIM NË TERRITORIN E KOMUNËS**

Emri i operatorit	Numri i ekonomive familjare	Numri i EF që pranojnë shërbimin e mbeturinave	Numri i bizneseve aktive në komunë	Numri i bizneseve që pranojnë shërbimin e mbeturinave	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve që pranojnë shërbimin e mbeturinave
a	b	c	ç	dh	e	ê
Operatori No.1	11866	11866	884	884	164	164

Shpjegim (b dhe c): Numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbimin e mbeturinave nga operatorët e mandatuar. Numri përcaktohet nga numri I faturave të lëshuara për muajin dhjetor të vitit raportues

\*dy kolonat e para te jenë të plotësuara, nga viti paraprak (pasi nuk ka ndryshime)

\* nëse janë disa operator, të bëhet prezentim i ndarë sipas operatorëve





**FORMULARI 7. KOMPZOICIONI I MBETURINAVE TË Mbledhura Bazuar në Analiza**

Kodi	Lloji i mbeturinave	Quartali i parë	Quartali i dytë	Quartali i tretë	Quartali i katërt
a	b	c	ç	d	e
2 0	<b>Mbetrinat Komunale</b>	346 kg	458	342	326
2 0 0 1 0 1	Letër dhe karton	16 kg ose 4.62%	25kg ose 5.45 %	36 kg ose 10.5 %	29 kg ose 8.89 %
2 0 0 1 0 2	Qelq	30 kg ose 8.67%	98 kg ose 21.3 %	0 kg ose 0 %	0 kg ose 0 %
2 0 0 1 0 8	Mbetrina të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat	162 kg ose 46.8 %	223 kg ose 48.6 %	172 kg ose 50.2 %	112 kg ose 34 %
2 0 0 1 1 1	Tekstil	36 kg ose 10.40 %	31 kg ose 6.76 %	55 kg ose 16.08 %	55 kg ose 16.87 %
2 0 0 1 3 9	Plastikë	50 kg ose 14.45 %	50 kg ose 10.9 %	41 kg ose 11.98 %	69 kg ose 21.16 %
2 0 0 1 4 0	Metal	5kg ose 1.44 %	8 kg ose 1.74 %	3 kg ose 0.87 %	2 kg ose 0.61%
	Mbetrina tjera komunale	47 kg ose 13.58 %	23 kg ose 5.02 %	35 kg ose 10.23	59 kg ose 18.09 %

Shpjegim: Këtu mund të shpjegoni kur dhe në cilin vendbanim janë bërë analizat e kompozicionit të mbeturinave. Analizat e kompozicionit të mbeturinave janë bërë në fshatin Bukosh përmes Fondacionit Jeshil dhe Ndermarrjes „UNITETI” nga data 17.02.2018-21.04.2018, me qëllim të implementimit të projektit për kompostim shtëpiak.

**FORMULARI 9. FATURIMI DHE ARKËTIMI NGA SHËRBIMI I MENAGJIMIT TË MBETURINAVE**

Viti raportues 1 janar - 31 dhjetor 2021

Emri i operatorit	Kategoritë e klientëve të shërbyer	Faturimi (të hyrat)			Arkëtimi	
		Vlera €	Nr. i faturave të lëshuara	ç	Vlera €	Nr. i faturave të arkëtuara
a	b	c	ç	d	dh	
	Amvisëritë (I rregullon vetë vleren që l vendosë në amvisri i zbrit ne Instrukcione)	626,524.80	11866	470,916.79	21191	
Operatori 1	Bizneset	131,598.65	10,559	166,888.88	13,568.00	
	Institucionet	63,750.79	620	63,750.79	580	
	Shërbimet e kontraktuara					
	<b>TOTALI</b>	<b>821,874.24</b>		<b>701,556.46</b>		

Viti raportues 1 janar - 31 dhjetor 2020

Emri i operatorit	Kategoritë e klientëve të shërbyer	Faturimi (të hyrat)			Arkëtimi	
		Vlera €	Nr. i faturave të lëshuara	ç	Vlera €	Nr. i faturave të arkëtuara
a	b	c	ç	d	dh	
	Amvisëritë	626,524.80	11866	470,916.79	21191	
Operatori 1	Bizneset	131,486.89	10,548	124,349.51	10,100.00	
	Institucionet	93,190.93	600	92,259.83	570	
	Shërbimet e kontraktuara					
	<b>TOTALI</b>	<b>851,202.62</b>		<b>687,526.13</b>		

\* nëse janë disa operator, të bëhet prezentim i ndarë sipas operatorëve

FORMULARI 10. ASETET E KOMUNËS PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Lloji i asetit	Numri	Vjetërsia		
a	b	c		
<b>Kontejnerë</b>				
Kontejnerë 120 l	8715	2017-2018-2019		
Kontejnerë 240 l	850	2018-2019		
Kontejnerë 1.1 m3	232	2018-2019		
Kontejnerë 7.1 m3	12	2003		
Kontejnerë 15 m3 - Transfer				
Komposter 240 l	150	2018		
Kontejner 1.1 m3 per ndarje te mbeturinave	154	2016-2018		
Lloji i asetit	Tipi	Kapaciteti	Viti i prodhimit	Targat
a	b	c	ç	d
<b>Kamionët për grumbullim dhe transfer</b>				
Kamioni Nr. 1	IVECO Kompaktor	8 m3	2001	02-690-AB
Kamioni Nr. 2	IVEKO Kompaktor	8 m3	2001	02-708-AB
Kamioni Nr. 3	HYUNDAI minikomptaktor	5 m3	2009	02-502-BH
Kamioni Nr. 4	Mercedes Actros	11 m3	2008	02-625-EM
Kamioni Nr. 5	ISUZI minikomptaktor	4 m3	2014	02-330-CL
Kamioni Nr. 6	Scania vetngarkues	7 m3	1988	02-936-CG
Kamioni Nr. 7	IVECO vetngarkues	7 m3	2001	02-680-AB
Kamioni Nr. 8	MERCEDES transporter	5 m3	1981	02-619-CE
Kamioni Nr. 9	MAN sisterna	10 m3	1986	02-523-BO
Ngarkues	ULT 160 C ngarkues		1986	
Autofshise	Autofshis mini			

Kamioni nr. 11	IVECO K3 Kompaktor	8 m3	2001	02-520-DQ
Kamioni nr. 12	MERCEDES K3 kompaktor	8 m3	2000	02-667-DO
Kompaktor	IVECO kompaktor	8 m3	2001	02-520-DQ
MAZDA Automjet			2002	02-237-AI
Mercedes			1999	02-427-DO
Fiat itachi	Ngarkues - eskavator		2003	
KOMPAKTOR	VOLVO	5 m3	2008	02-815-EF
<b>Traktorë për grumbullim</b>				
Traktori Nr. 1			2001	
Traktori me lug Nr. 2			2001	
<b>Lloji I aseteve të (QPPRA) Qendrës për paketim të mbetjeve të riciklueshme</b>				
<b>Lloji I aseteve të (QPPRA) Qendrës për paketim të mbetjeve të riciklueshme</b>				
Kamioni Nr. 1	SUZI KOMPAKTOR	8.1 M3	2015	
Kamioneta Nr. 2	Citroen	2.1 Ccm		
Presa hidraulike 1	HMTO - 6040	5.5 kw	2015	
Presa hidraulike 1	HMTO - 6040	5.5 kw	2015	
Presa hidraulike 2	HMTO - 6040	5.5 kw	2015	
Presa hidraulike 3	HMTO - 6040	5.5 kw	2015	
Presa hidraulike 5	ASD - 250	5.5 kw	2015	
Vinci motorik	300	3000 kg	2015	
Vinci manual		1000 kg	2015	
Mulliri per bluarje te plastikes		7.5 kw	2017	

## FORMULARI 11 - Qasja në ndarjen në burim

Pikë grumbullimi të mbeturinave që ofron ndarje të mbeturinave të riciklueshme ( në vitin 2022)			
Prezentim hartografik (Ortofoto etj)	Emri i vendbanimit ku gjendet pika e grumbullimit dhe adresa	Numri i ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave në burim	foto e lokacionit
a	b	c	dh
	Analiza teknike e miratuar ne Kuvendin Komunal ka 34 PGM, prej te cilave 18 jane te perfunduara	4280	
Furnizim me komposter I familjeve (furnizimi gjate vitit 2018)			
a	b		
Emri i vendbanimit	Numri i ekonomive familjare		
Bukosh	150		
Qendër për grumbullim e mbeturinave të ndara.			
Prezentim hartografik (Ortofoto etj)	Emri i vendbanimit ku gjendet pika e grumbullimit dhe adresa	Numri i ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave në burim	foto e lokacionit
a	b	c	dh
	zona ish varrezat e qytetit  zona Mustafa Venhari  lagja Bekim Berisha Abeja  lagja Bahri Kuqi	600 ekonomi familjare të furnizuara me 600 shporta 240 dhe 120 litershe  600 ekonomi familjare të furnizuara me 600 shporta 240 litershe  100 ekonomi familjare të furnizuara me 100 shporta 240 litershe  150 ekonomi familjare të furnizuara me 150 shporta 240 litershe	



	200 copa 240 l, rreth 13 000 nxenes
36 institucione te arsimit	
TOTALI	4280

Shpjegim (dh): Te regjistrohesh numri i ekonomive familjare qe jane brenda rrezes 250 m nga një pikë grumbullimi të mbeturinave që ofron ndarje të mbeturinave të riciklueshme, plus numrin e ekonomive familjare që janë pajisë me komposter plus numrin e ekonomive familjare në rreze 5 km nga një qendër për grumbullim e mbeturinave të ndara.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

**Për:** Kuvendin e Komunës

**Propozues:** Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës

**Hartues:** Drejtoria për Administratë, Hava Mlinaku

**Tema:** Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: \_\_\_\_\_ 2022 merr këtë:

#### VENDIM

#### PËR PAGESËN E KOMISIONEVE TË THEMELUARA NGA KUVENDI

1. Me këtë vendim, lejohet kompensimi i anëtarëve të komisioneve të formuara nga kuvendi, që nga data 1.1.2022 deri në hartimin e rregullores për komitetet dhe komisionet e kuvendit.
2. Lartësia e kompensimit për çdo takim caktohet në shumën prej 30 € për anëtar të komisionit, në bazë të procesverbalit për mbajtjen e takimit.
3. Pagesa e anëtarëve të komisioneve mund të bëhet deri në gjashtë (6) takime, për çështjen për të cilën janë formuar. Përrjashtim bën Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokalë, i cili duhet të paguhet për së paku njëzet e pesë (25) takime.
4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 të këtij vendimi do të merren nga »kategoria paga dhe mëditje« dhe »kategoria e subvencioneve« në zyrën e Kryetarit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

## **Arsyetim**

Duke marrë për bazë punën e madhe që kryejnë komisionet e themeluara nga ana e Kuvendit të komunës, si dhe me qëllim të rritjes së performancës të këtyre trupave të Kuvendit, e cila ndikon në kualitetin e punëve edhe të vet Kuvendit të komunës, si dhe me qëllim të kompensimit të këtyre komisioneve, Drejtoria për Administratë ofron para Kuvendit propozim-vendimin për kompensimin e komisioneve të Kuvendit.

Andaj nga të cekurat më lart, i propozojmë Kuvendit të komunës që ta aprovojë këtë propozim-vendim si në dispozitiv të tij.

  
**Hava Mlinaku**  
**Drejtorja për Administratë**



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtorati/Njesia  
Kuvendi i Komunës

Data 10/11/2022

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

KHF Vushtrria

Numri personal

/

Adresa e vendbanimit

/

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

48245220

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese per mbeshtetje financiare

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-104/02-0056661/22

Afati i zgjedhjes

10/12/2022

Vendimi

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë KHF Vushtrria vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: berat.januzi



Për : Komitetin për Politika dhe Financa

Kuvendi Komunal

Vushtrri

Datë: 10/11/2022

Ju lutemi që të merrni parasysh këtë kërkesë dhe t'a bëni pjesë të rendit të ditës për shyrtime dhe aprovim në seacën e radhës të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.

Kërkesa ka të bëjë me mbështetje financiare për Klubin e Hendbollit "Vushtrria"- Femrat

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, Qeveri komunale i nderuar Kryetar i komunës ztr. Ferid Idrizi.

Kryesia e Klubit të Hendbollit "Vushtrria"- Femrat në Vushtrri po u drejtohet institucioneve komunale për mbështetje financiare klubit në shumë prej 15.000.00 euro, ku nga këto mjete 5.000.00 euro janë borxh ndaj këtij klubi nga institucionet komunale si shpërblimin në bazë të rregullores KKV NR.08/2020 pika 9 neni tre që parasheh dhënjen e shpërblimit për arritje në sportin kolektiv meqë Klubi ynë është shpallur Kampion i Kosovës për periudhën 2020/2021,

